Pastaj një ditë hyri në zyrë Sara Maliqi, e cila pa një poster me shkrimin cirilik "Neću rat" (*Shqip – Nuk dua luftë*) në alfabetin cirilik, e solla unë. Ajo hyri për të na ndihmuar për ca taksa, sepse kishim ngatërruar diçka, dhe pastaj u kthye dhe tha – unë duhet të punoj këtu. Dhe ashtu erdhë, ajo e mori komplet Nismën në Kosovë".

Zyra kryesore rajonale ishte e vendosur në Beograd, prej nga u themeluan zyra dhe organizata në vende të tjera të ish-Jugosllavisë. Ajo që ishte specifike që në fillim ishte "lidhja jonë dhe puna e përbashkët mes Beogradit dhe Prishtinës, e cila nuk kishte të bënte me projekte".

# NË EMËR TË SË ARDHMES

Në atë kohë nuk ka takime Zoom, koordinatorë projektesh, cooperation agreement-a.

"Kemi punuar bashkë në kuptimin e vërtetë të fjalës... sikur të kishim një zyrë. Planifikimi ynë ishte i përbashkët, team building-u ishte i përbashkët, gjithçka ishte e përbashkët. E gjithë kjo rezultoi në krijimin e një lidhjeje të fortë ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe se ndarja e vlerave nuk u vu kurrë në dyshim – ne organizuam organizimin në bazë të vlerave, kështu që nuk ishte e mundur që dikush të pyeste nëse ky njoftim ishte në rregull nga perspektiva e Serbisë, p.sh. Ne ndërtonim ishullin tonë të vogël ku parimet janë të rëndësishme, vlerat janë të rëndësishme dhe fakti që vijmë nga Kosova apo Serbia është një çështje dytësore".

Gjatë gjithë viteve të punës në Nismë, disa nisma ishin për mua shumë të rëndësishme. Para së gjithash, të gjitha fushatat, forumet, bisedat dhe vizitat në lidhje me Srebrenicën dhe gjenocidin e Srebrenicës, duke përfshirë udhëtimin e parë në Potoçare me dy autobusë të rinjsh nga Serbia më 11 korrik 2004 dhe fushatën me fotografitë e Tarik Samarach në billborde me mesazhet "Të shikosh, Të dish, Të mbash mend". Më pas programi i vizitave, apo visiting program, i cili u mundëson të rinjve të udhëtojnë nëpër rajon dhe të takojnë bashkëmoshatarët e tyre, të mësojnë për të kaluarën e përbashkët dhe të mësojnë të mos e mohojnë atë; *Ditët e Sarajevës* në Beograd dhe të gjitha përpjekjet dhe fushatat që në fund ndihmuani në krijimin e institucioneve të pavarura në Serbi.

Andrej formalisht qëndroi në Nismë deri në vitin 2009 dhe themelin e Heartefact-it. Ai thotë se ai dhe ekipi e kanë ndjerë se duhet të shkojnë atëherë kur erdhë pavarësia e Kosovës – aty ishin rreth 5, 6 vite, dhe tanë ishte koha që organizimin t'ia linin disa të rinjve të tjerë. Gjithsesi, lidhja mes tyre duket se është e pathyeshme edhe sot e kësaj dite, ndaj kur flet për personat që ka takuar në Nisma, e kujton veten për babain e tij, kur flet për APJ-në (serbisht: JNA).

"Por realisht, për mua, Nisma, në njëfarë kuptimi jugosllav, ishte një hapësirë që na formoi neve përsa i përket vlerës. Unë jam një fëmijë nga Prokuplja që besoja se shqiptarët prisin para kufirit me qeleshe dhe hanxharë për të më rrahur. Unë nuk jam dikush që i kam pasur këto vlera gjatë gjithë jetës sime. Në një masë të madhe, Nisma, krijimi i Nismës dhe krijimi i asaj hapësire më formësoi mua, bindjet dhe njohuritë, këndvështrimet dhe gjykimet e mia në përgjithësi".

Një nga vlerat themelore të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut është që gjithmonë duhet të flasësh në emrin tënd dhe në emër të atyre që heshtin dhe nuk mund të thonë atë që mendojnë.

"Mendoj se kjo është gjëja më e rëndësishme që ka mbetur në Nisma dhe që e mban të bashkuar. Është edhe çështje solidariteti, ndjeshmërie, raporti me të shkuan. Kur je pak më i fortë, ke detyrim dhe detyrë të flasësh në emër të më të dobëtit, në emër të atyre që heshtin".

I pyetur se si ishte njëzet vjet më parë dhe si është sot, Andrej thotë se sot ekziston Nisma, "dhe ky është një ndryshim kyç", ekziston një vend për të rinjtë që nuk duan t'i përkasin narrativave mejnstrim, që duan të formojnë veten në një mënyrë tjetër, ata duan të punojnë me veten dhe të përparojnë. Me ekzistencën e Nismës, ekziston edhe garancia se do të kujtojmë atë që ka ndodhur në të kaluarën dhe se do të luftojmë kundër mohimit dhe mosndëshkimit, gjithçka në emër të së ardhmes që ëndërrojmë, e cila është ta bëjmë shekullin e 21-të një shekull pa konflikte në Ballkan, që nuk e di nëse është e mundur apo e arritshme.

Për mua, Nisma është fillimi, fillimi i një rruge, tanë çfarë... është baza, është start up-i".

Andrej Nosov, drejtor rajonal 2003-2009, drejtor dhe themelues i Heartefact, regjisator teatri dhe aktivist për të drejtat e njeriut.

PETRIT SELIMI

# YIHR-A I DHA KUPTIM SHKURTESËS QË MBAN



**Ishte fillimi i viteve 2000, kur rajoni sapo kishte përmbyllur kapitullin e luftërave të përgjakshme, kur në Selanik të Greqisë, i riu kosovar Petrit Selimi ishte takuar me moshatarin e tij nga Serbia, Andrej Nosovin, një aktivist që atë kohë mbulonte rajonin e jugut të Serbisë, pjesë në afërsi të kufirit me Kosovën.**

"Aftësia e tij për rrjetëzim, shpjegimi i sfidave dhe identifikimi i mjeteve për zgjidhjet për një angazhim më të madh të të rinjve në promovimin e demokracisë dhe të drajtave të njeriut, ishin cilësítë kryesore që bënë bashkë grupin e të rinjve, së pari në Serbi e pastaj edhe në Kosovë, Bosnjë, Kroaci e Mal të Zi", thotë Selimi më shumë se dy dekada pasi u dha ideja për një organizatë rajonale të të rinjve, në luftim të barrierave që ishin vendosur.

Në një kalim kohe kaq të gjatë, Selimi thotë se roli i tij në organizatë ka qenë modest, ndërsa për organizatën thotë se e ka merituar plotësisht shkurtesën që mbani.

"Në Ballkanin Perëndimor ne jemi mësuar të shohim shkurtesa pafund të organizatave, donatorëve ndërkombe të agjencive qeveritare, por YIHR-a me të vërtetë është vënë në ballë të të rinjve, nismave dhe të drejtave të njeriut", thotë ai.

Sipas Selimit, YIHR-a është bërë organizatë unike sepse nuk është mjaftuar vetëm në organizimin e seminareve, bisedave, ligjeratave dhe trajnimeve, por është fokusuar kryesisht në aktivizëm, fushata derë më derë dhe angazhim në çështje të artit e kulturës, si mjete esenciale për ndryshim politik dhe angazhim.

"Unë kam luajtur një rol të vogël në fillim, diskutimet fillostante para se të themelojë organizata, themelimin dhe ngjarjet e konferencat e para, dhe natyrisht i kam ndjekur dhe mbështetur aksionet në vitet e mëpasme në kapacitetet e ndryshme që nga projektet në mbështetje të dialogut dhe promovimit të kulturës dhe artit të asaj që më vonë do të bëhej shteti i Kosovës, në Beograd, deri te mbrojtja e komunitetit LGBTQ+, fuqizimi i gruas dhe rinisë etj", thotë Selimi.

Ai kujton se bëhej fjalë përvitet pas luftës në Kosovë kur plagët, qoftë edhe të luftës dhe gjenocidit në Bosnjë, që kishte përfunduar vite më parë, ishin çdokund të pranishme në diskursin publik.

"Plagët ishin të freskëta, urrejtja ende ishte e thellë dhe mbetjet e regjimit të Milosheviqit ishin ende në gjendje të bënë kërdinë, siç e pamë me vrasjen e kryeministrit të Serbisë (Zoran Gjingiq) në vitin 2003, në periudhën kur YIHR-a sapo ishte themeluar", thotë Selimi.

"Te njerëzit si Andrej Nosovi dhe Sarah Maliqi, si dhe shumë kolegë të tjera, ekzistonte një ndjenjë e fuqishme që të mos lejonin që të arriturat të kthehenin mbrapa nga forcat e defetizmit, nacionalizmi ekstrem, e dajtuta ekstreme apo madje edhe nga grupet raciste të mbështetura nga grupet jashtë kontrollit në Serbi, që po synonin t'i përbysnin proceset historike të çlirimt të Kosovës, krijimin e sistemeve demokratike në rajon dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian", shton ai.

Ai nën vizon se në vitet e fundit, festivali "Mirëdita, Dobar Dan!" ka dëshmuar se është ura e vetme e mbetur në këmbë dhe mjeti i vetëm për të ekspozuar Kosovën në Serbi dhe anasjelltas.

"Kjo është arsyja pse ky festival shpesh sulmohet nga tabloidet dhe grupet nacionaliste serbe", thotë Selimi.

Por ai nën vizon se puna në monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe luftimi i saj është gjithashtu e rendësishme sepse "po luftohet diçka që e ka kapluar të Ballkanin".

Petrit Selimi është marrë me aktivizëm që në fillim të viteve 1990, duke filluar si 14 vjeçar kur në një samit të OKB-së për të rinxjtë kishte folur për rendësinë e angazhimit të të rinjve si mjet në luftën për demokraci si dhe liri kolektive e personale.

Ai thotë se YIHR-a e ka mbështetur rrugën e Kosovës atëherë kur ka qenë shumë e rezikshme përvitës.

"Ajo i mundësoi qindra gazetarëve, aktivistëve, studentëve të marrin pjesë në programin unik të shkëmbimit përvitës, parë perspektivat e njëri-tjetrit në kryeqytetet ballkanike, në një kohë kur në vend që të hapeshin kufijtë, tendencat e geverive dhe mediave që ato kontrollojnë u vunë qartë në shërbim të rritjes së ndarjeve dhe hegemonisë", thotë Selimi.

"Frikësohen se pak nga ai entuziazëm është humbur përvitës, shkak të kohës së paprecendent të kaluar nën proceset tranzicionale, mungesa e progresit në përbillyjen e çështjeve të hapura bilaterale dhe rritja e autoritarizmit dhe popullizmit. Tani jam më pesimist, dhe kjo tregon se sa shumë na duhet ende YIHR-a", përfundon ai.

**SONJA PROSTRAN**

# NISMA ËSHTË NJË LUFTË E VAZHDUESHME



**Sonja Prostran**

anëtare e Bordit Drejtues të Nismës së Rinje për të Drejtat e Njeriut në Serbi 2004/2005-2009, tanë drejtoreshë e Projektit të USAID-it për forcimin e sistemit gjyqësor në Uzbekistan dhe degës së EWMI në Uzbekistan.

**Historia e Sonjës me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut fillon në mars të vitit 2003. Ajo atëherë ishte sekretare e Gjykatës së Qarkut në Beograd dhe Andrej Nosov raportonte për gazetën "Danas" nga një nga gjyqet e para për krime të luftës para Gjykatës së Qarkut – gjyqi për rrëmbimin në Sjeverin. Në dhjetor të vitit 2003, kur u bë zëdhënëse e Departamentit special të Gjykatës së Qarkut në Beograd për krimet e luftës, filloi bashkëpunimi i saj më intensiv me Nismën në Serbi.**

Sot, 20 vite më vonë, Sonja thotë se Nisma la gjurmë serioze në jetën e saj personale dhe profesionale.

"Falë Nismës, pata mundësinë të bisedoja me njerëzit e thjeshtë se çfarë janë gjykimet për krimet e luftës, si zhvillohen ato në Serbi, cilat janë ngashmëritë dhe dallimet ndërmjet gjykimeve para gjykatave në Serbi dhe gjykimeve para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavisë në Hagë. Realisht, të udhëtoja me Nismën jo vetëm nëpër Serbi, por në gjithë rajonin e ish-Jugosllavisë, dhe në atë mënyrë të përhapja njohuri apo informacione se si funksionon sistemi juridik në Serbi.

Ishte një mundësi e pabesueshme."

Nga vitet 2004/2005 deri në vitin 2009, ishte në Bordin e Drejtoreve të YIHR-së në Serbi. Edhe pse kohë pas kohe kishte probleme për shkak të daljeve publike në ngjarjet e Nismës ku fliste për temën asnjëherë të popullarizuar të krimeve të luftës, Sonja thotë se askush nuk e "konsideronte kurrë të pazakontë, të çuditshme apo, Zoti na ruajt, të paligjshme që një bartës i një posti gjyqësor të jetë anëtar i Bordit drejtues të një organizate joqeveritarë." Në vitin 2005 Sonja u zgjodh gjyqtare e Gjykatës Komunale të Beogradit. Thotë se në atë kohë konsiderohej normale që gjyqtarët të merrnin pjesë në jetën shoqërore dhe publike, gjë që sot është bërë një gjë e rrallë:

"Ajo që ndodhi më pas dhe ajo që po ndodh sot e kësaj dite e ka rikthyer dukshëm profesionin tonë si bartës të pozitive gjyqësore dhe gjithashtu flet për nivelin e censurës që ekziston sot në Serbi".

Sonja thotë se është kënaqur në çdo kontakt dhe shoqërim me Nismën, si dhe se vitet që ka kaluar duke punuar ngushtë me aktivistët dhe aktivistet e saj kanë qenë të gjëzueshme, plot energji pozitive, entuziazëm, të qeshura dhe vullnet për të ndryshuar diçka.

"E mbaj mend atë periudhë si një nga më të gjëzuarat dhe më të lumturat në jetën time".

Të gjitha fushatat dhe veprimet në të cilat ajo mori pjesë janë gjurmë të thella tek ajo. Nëse do t'i duhej vërtet të veçonte disa, atëherë do të ishte hulumtimi mbi transparencën e gjyqeve për krimet e luftës para gjykatave në Serbi, Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë, të cilin ajo e bëri së bashku me gazetarin e atëhershëm të B92, Milosh Miliq. Falë këtij hulumtimi, në vjeshtën e vitit 2006, Sonja dhe Milosh udhëtuan në SHBA, ku prezantuan rezultatet e hulumtimit në universitetet në Nevada dhe Kaliforni.

Një projekt tjeter që ka mbetur në kujtesën e saj veçanërisht të dashur është praktika e studentëve nga Serbia në Tribunalin e Hagës:

"Gjatë dy cikleve të asaj praktike kam mbikëqyrur mënyrën se si realizohet projekti dhe ishte pafundësisht interesante, sidomos të ndiqja rrugën e zhvillimit të studentëve që merrnin pjesë atje. Unë jam ende në kontakt me shumë prej tyre edhe sot e kësaj dite".

Pas vitit 2009 dhe largimit të saj nga Bordi Drejtues i Nismës, Sonja nuk arriti të ndiqte rregullisht punën e organizatës. Karriera e saj mori një rrjedhë tjeter – pjesërisht falë Nismës, sepse ajo filloi të punojë për Institutin e Menaxhimit të Lindjes Perëndimore (EWMI), ku është aktive edhe sot, dhe me të cilin ishte lidhur pikërisht nga YIHR-ja.

"Në planin personal, Nisma më solli fillimisht njohje me njerëz që ende luftojnë për të drejtat e njeriut në Serbi dhe jashtë saj, kështu që tashmë mund të them se këto janë njohje profesionale. Më parë kanë qenë kryesisht studentë, ndaj jam veçanërisht e kënaqur që diku kam vëzhguar rrugën e tyre të zhvillimit dhe e ndjek deri më sot"

ALEKSANDRA MILENOV

# NISMA ËSHTË SHPRESË



Aleksandra Milenov

, koordinator e zyrës outreach të Tribunalit të Hagës në Beograd, 2003-2007.

**Pikërisht 20 vjet më parë, Alexandra erdhi nga Haga në Beograd për të drejtuar zyrën outreach të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe për të përfaqësuar Sekretariatin e Tribunalit në Serbi. Para kësaj, ajo punoi për Prokurorinë e Gjykatës së Hagës nga viti 1998 deri në 2003. Një nga sugjerimet e para që mori nga paraardhësi i saj me të mbërritur në Serbi ishte të takonte Andrej Nosov, një gazetar i ri, i cili, siç i tha, "Dikush që duhet ta njohe" dhe zëri i të cilat do të jetë i rëndësishëm në bisedën për krimet e luftës të kryera gjatë viteve të nëntëdhjeta në ish-Jugosllavi.**

Paraardhësi kishte të drejtë, thotë Aleksandra:

"Në takimin tonë të parë, Andrej më tha se do të themelonte Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut. Asokohe gjykata gjykoj ish-presidentin e Serbisë, Sllobodan Milosheviq dhe interesimi i mediave në Serbi ishte i madh. Ndjenjat nacionaliste ishin të forta dhe qëndrimet e njerëzve përfshirjen e forcave serbe në krimet e luftës përbëheshin nga forma të ndryshme mohimi.

Andrej, dhe të rinjtë që ai mblodhi në Nismën e të Rinjve, hynë me guxim në këtë diskutim kombëtar emocional, të vështirë e herë-herë armiqësor, me kreativitet e dhembshuri dhe me bindjen se çdo bisedë është e rëndësishme".

Gjatë katër viteve të ardhshme, sa ka qëndruar në Beograd, Aleksandra nuk ka refuzuar asnjë ftesë nga Nisma, e cila, siç thotë sot, ishte ndoshta edhe partneri më i rëndësishëm që kishte në Serbi. Përmendet veçanërisht programin "Ballafaqimi me të kaluarën", i cili mblodhi së bashku të rinj nga i gjithë vendi për të diskutuar për krimet e luftës dhe punën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Një nga ato mbledhje ende jeton në kujtesën e saj edhe sot:

"Në një ngjarje të tillë, një vajzë rrëth 16-vjeçare pyeti: "Po pse duan të më vrasin shqiptarët?" Këqinformimi pas kësaj dhe frika që i shkaktoi kësaj vajze tregon për rëndësinë absolutisht jetike të punës së YIHR-së. Është vërtet e pamundur të mbivlerësohet".

Një program tjetër që ajo e konsideroi veçanërisht të rëndësishëm është dërgimi i studentëve të drejtësisë nga Serbia në Tribunalin e Hagës për praktikë. Përveçse patën mundësinë të shihnin se si funksionon gjykata dhe si duken në të vërtetë gjyqet, ata patën një mundësi unike për të kaluar pak kohë duke jetuar dhe punuar në perëndim, thotë Aleksandra.

"Një pjesëmarrëse më falënderoi dhe tha se nuk mund ta dijë se sa kam bërë për ta në atë rast – në fakt, e kuptova plotësisht, dhe kjo është arsyja pse punova me YIHR-ën për ta realizuar atë program."

Gjatë kohës së saj në Beograd, Aleksandra ishte pjesëmarrëse e shpeshtë në konferencat e Nismës, në diskutime në grup me të rinjtë dhe në takime me aktivistë. Ajo thotë se i ka pëlqyer çdo lloj ndërveprimi me Nismën dhe se gjithmonë ka qenë e magjepsur nga njojuritë, aftësitë dhe profesionalizmi i aktivistëve dhe punonjësve të saj në organizimin e programeve dhe aktiviteteve. Kur u pyet se cili është programi i saj i preferuar i Nismës, Aleksandra thotë:

"Është e pamundur të zgjedhësh një të preferuar, ndaj do të përmend vetëm eventin e parë në të cilin kam marrë pjesë. YIHR ftoi dy gra nga Srebrenica për të folur në një debat publik në qytetin në Serbinë jugore. Ndërsa ecnim me makinë, ata shikuan nga dritarja dhe komentuan peizazhet e njoitura dhe nervozizmi i tyre u zhduk. Në këtë aktivitet ata folën për përvojat e tyre gjatë rrethimit dhe për humbjen e bashkëshortëve të tyre. Publiku i pranishëm nuk mund të ndalonte së shtruar pyetje. Në fund, kur disa kishin filluar të largoheshin, të tjerët mbetën, dhe gratë qëndruan dhe biseduan me to veçmas. Ishte një moment i fuqishëm i lidhjes njerëzore, i mundësuar nga YIHR".

Si koordinatore e zyrës së Tribunalit të Hagës në Beograd, Aleksandra më së shumti merrej me marrëdhënien me publikun, bashkëpunonte me media, fliste për punën e Tribunalit në ngjarje të ndryshme publike dhe bashkëpunonte me sektorin e OJQ-ve në Serbi. Ajo gjithashtu bashkëpunoj ngushtë me autoritetet gjyqësore lokale që punuan në hetime dhe gjyqe për krimet lufte. Ajo thotë se ka pasur marrëdhënien të shkëlqyera me të gjithë, por punën me Nismën ende e veçon:

"Pa dyshim, ndikimin më të madh e ka pasur edhe puna ime me YIHR. Të rinjtë janë më të hapur për të dëgjuar perspektiva të ndryshme dhe për të ndryshuar qëndrime, edhe kur bëhet fjalë për çështje sfiduese emocionale, si p.sh. pranimi se forcat që i përkasin grupit të tyre etnik kanë kryer krimet të tmerrshme.

Mirënjojha që mora nga disa prej të rinjve që morën pjesë në programet e YIHR-së është arritja ime më e madhe profesionale".

# NISMA ËSHTË GUXIM DHE LIDHJE



Edin Veloviq

studiuar, koordinator dhe menaxher projekti, drejtor financiar, 2003-2007, YIHR Serbi, tani udhëheqës i ekipit të Alexander Mann Solutions në Serbi.

**Në kohën kur Andrej Nosov filloi themelin e Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut në vitin 2003, Edini punonte në startup-e, duke mos menduar se së shpejti karriera e tij do të merrte një drejtim tjeter. Gjatë atij viti ai u takua me Andrejin për herë të parë me rekondimin e motrës së tij. Andreji atëherë, si gjithmonë, ishte bindës.**

"Gjatë gjithë jetës e imagjinova veten në një lloj aventure biznesi dhe doli që në Nismë u orientova më shumë se kurrë më parë në përputhje me vlerat e mia".

Në atë kohë, klima politike dhe sociale në Serbi ishte e dhimbshme, ndonjëherë edhe e errët, thotë Edini. Menjëherë pas ardhjes së tij në YIHR, u formua Qeveria e Vojislav Koshtunicës dhe Serbia u kthye djathtas. Më pas aktivistet dhe aktivistët që merren me ballafaqimin me të kaluarën në publik filluan të quhen "faktor shqetësues".

"Ne u pranuam më mirë në rajon sesa në Serbi."

Edini filloi në Nismë si studiuar në fund të vitit 2003. Ai e përshkruan punën e Nismës në një segment kaq të hershëm si entuziaste dhe ai entuziazëm ishte dhe mbetet komponenti i saj më i rëndësishëm motivues, thotë Edini.

Edini dhe Andreji jo vetëm që ndanë hapësirë me një organizatë tjeter, por edhe një kompjuter.

"Megjithatë, në asnjë moment nuk u ndjetë sikur ishit në vendin e gabuar – ai vizion ishte më "i prekshëm" sesa realiteti".

YIHR-a u bë një organizatë serioze "me shpejtësi rrufe" dhe tërroqi vëmendjen e njerëzve me vlera qytetare që trajton temë të njëjtë apo të ngashme, si Sërgja Popoviq dhe Dragolub Todoroviq.

"YIHR-a më ndihmoi të kuptoj se ekziston një planet krejtësisht i ri me njerëz të mirë, të ndershëm dhe të guximshëm me vlera qytetare.

Me ritjen e Nismës, në jetën time një nga një hyn koleg dhe person i mrekullueshëm".

Vetë Edini përparoi në Nismë me ritjen e organizatës. Gjatë viteve 2003 dhe 2004 ka punuar si koordinator

projekti, përkatesisht menaxher dhe në verën e vitit 2005 kaloi në pozitën e drejtorit financiar, ku qëndroi deri sa u largua nga Nisma – nëse iku ndonjëherë në të vertetë.

"Lu ktheva Nismës edhe kur i isha përkushtuar tashmë organizatave fitimprurëse".

Si disa nga projektet më të rëndësishme në të cilat ka punuar si pjesë e YIHR-së, ai veçon "Ditët e Sarajevës" në Beograd, si dhe programin "Gazetarët mund ta bëjnë atë". "Këtu është edhe projekti për nxitjen e punësimit, i cili tregoi se Nisma mund të bashkëpunojë edhe me institucionet vendore".

Edini u largua nga Nisma në vitin 2007 për t'i u përkushtuar studimeve master në menaxhimin e biznesit në Universitetin e Sheffield (Angli).

"Nuk mund të punoni në YIHR gjatë orarit të punës: ose jeni të përkushtuar për të ndryshuar shoqërinë gjatë gjithë kohës ose nuk jeni".

E vazhdoi karrierën në sektorin fitimprurës dhe korporata, dhe një kohë të caktuar ishte pedagog në Shkollën e Menaxhimit në Grenoble (Francë).

Edini thotë se puna në Nismë i dha mundësinë për të forcuar aftësitë që shënuan më vonë karrierën e tij: të punojë në ndërmjetësimin e grupeve ofrimin e asistencës për individët brenda kompanive/korporatave.

"Përvoja që fitova në YIHR më ndihmoi shumë për të kuptuar shumë gjëra që lidhen me kulturën organizative, metodat dhe mënyrat e komunikimit, qëndrueshmërisë".

Po të mos ishte Nisma, unë kurrë nuk do të kisha "dashuruar" profesionalist me temat e liderëshipit, motivimit dhe menaxhimit të ndryshimit".

SARAH MALIQI

# YIHR-A, ORGANIZATË E NDRYSHIMIT TË MENDËSISË



**Kur në vitin 2005 Andrej Nosovi kishte ardhur në Prishtinë për të hapur një organizatë për të drejta të njeriut, Sarah Maliqi kishte shkuar ta takojë.**

**Atëherë Sarah Maliqi punonte në Trustin Pensional të Kosovës, por sa iu ofrua pozita si Zyrtare e Programit në YIHR, nuk kishte hezituar që ta ndërronte vendin e punës.**

Muaj më pas, në shtator, asaj i ishte ofruar pozita e Ushtrueses së Detyrës së Drejtoreve së Zyrës në Kosovë, në një kohë kur në tavolinë kishte vetëm dy projekte të organizatës. Një vit më vonë, organizata veçse kishte marrë hov e ishte zgjeruar në tërë rajonin e Sarah Maliqi u bë Zëvendës Drejtore Rajonale.

"Ka qenë një kohë e jostabilitetit ekonomik e politik, por mbi të gjitha ka qenë një atmosferë e frikës dhe pasigurisë. Ishte koha kur pritej të fillonin negociatat për statusin dhe në atë mëdha politik më duket se kemi bërë shumë gjëra të mëdha", kujton Maliqi.

Ajo thotë se organizata në atë kohë kishte disa qëllime dhe një prej tyre ka qenë bashkëpunimi i të rinjve të Kosovës e Serbisë.

"Ishte një prej sfidave më të mëdha sepse askush nuk ka besuar se mund ta bëjmë këtë. Kjo është një gjë që e ka bërë YIHR-a dhe të tjerët vështirë se do ta bënin në atë mënyrë. Njerëzit që kanë ardhur nga Beograd në Kosovë, ose nga Kosova në Beograd, shpesh as prindërve nuk u kanë treguar se ku venë. Shfrytëzonim lejet për pjesëmarrje në gjykime për krime lufte për të lëvizur dhe dërguar të rinjtë", thotë Sarah Maliqi.

Kujton se kur kishin shpallur për herë të parë programin vizitues mes Prishtinës dhe Beogradit, atë e kishin bërë për të testuar interesimin e të rinjve.

Thyerja e akullit do të vinte tek më pas.

"Ata që vinin (në Prishtinë) kishin frikë të flisnin serbisht në rrugë. Ne donim që ata të flisnin dhe njerëzit të mësohen t'i dëgjojnë. Përpinqeshim të hapim çështjen e ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale. Jo vetëm të flasim por edhe t'i prekim gjërat", thotë Maliqi.

Sipas saj, planifikimi strategjik i gjërate ka qënë ajo që e ka dalluar YIHR-në nga organizatat e tjera, derisa përmend monitorimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, Konferencën për shoqëritë e dhunshme në tranzicion, punën me të rinjtë dhe punën me komunitetin LGBT si projektet më të rëndësishme në të cilat organizata ka punuar gjatë atyre viteve.

"Së bashku me stafin jemi përpjekur të shtyjmë disa nga çështjet thelbësore të të drejtave të njeriut. Jemi lidhur aq shumë për një qëllim të përbashkët dhe qëllimi ka qenë drejtësia, përtej çdo kufiri nacional e politik", thotë Sarah Maliqi.

"Ka pasur një lloj solidariteti për punët e ndjeshme me të cilat merreshim. Nuk kam pasur frikë nëse tre serbë vinin nga Beogradhi dhe t'i dërgoja te "Kafet e vogla". Shpesh njerëzit më shpotitnin "Dobar Dan, Sarah", kujton ajo.

Për një kohë, në vitin 2007 deri në fillim të vitit 2008, pak para se Kosova ta shpalte pavarësinë, Maliqi ishte zhvendosur në Beograd.

"Nëse shoh në retrospektivë se nëpër çfarë kam kaluar, mendoj se jemi një gjeneratë që thyente akullin, kalonte barrierat. Ishim të parët që kundërshtonim glorifikimin e kriminelëve të luftës dhe përfshirjen e tyre në institucionë", thotë ajo.

Maliqi thotë se Andrej Nosov ka qenë shtytja e madhe e shumë njerëzve për të ecur përpëra me misionin dhe vizonin e organizatës.

"YIHR-a më ka forcuar bindjen të luftoj për një qëllim që ndikon në ndryshimin e jetës së komunitetit. Këtë e kam marrë me vete kudo që kam shkuan. Më ka mësuar që me kurajo të përballoj dështimet. Kjo do të thotë të mësosh të shohesh ftohtë atë që ndodh, jo vetëm në vendin tënd por kudo në rajon", thotë ajo.

Ajo thotë se veçori e YIHR-së është ndihma për të rinjtë në krijimin e lidhjeve të reja me moshatarë në rajon, mbështetja për shoqërinë civile si dhe programet e shkëmbimit të gazetarëve.

"Nisma ka sjellë ndryshime të dukshme edhe brenda shoqërisë civile, në ndryshimin e përceptimit shoqëror për raportet ndëretnike, ballafaqimin me të kaluarën në një ambient ku pasojat e luftës ishin ende të freskëta", thotë Sarah Maliqi.

"YIHR është tejet e guximshme. Është ndryshim i mendësisë", përfundon ajo.

## PERSONAT E ZHDKUR: EMRA, JO NUMRA

YIHR Kosovo është një nga organizatat më aktive në zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur në Kosovë duke organizuar aksione në rrugë që nga viti 2007. Me rastin e Ditës Kombëtare të Personave të Zhdukur në Kosovë, aktivistët e ktheyen në emra numrin e të zhdukurve duke vendosur emrin e secilës viktimit në një mur 20 metra, për të treguar se viktimat duhet të kujtohen me dinjitet dhe se e meritojnë. Përpara këtij muri janë vendosur karrige bosh, që simbolizojnë audiencën e munguar.

Duke pasur parasysh se deri tani për viktimat flitej vetëm si për numra, zbulimi i identitetit të tyre ishte një çështje e ndjeshme për shoqërinë në Kosovë duke pasur parasysh faktin se emrat tregojnë një përkatësi të caktuar etnike. Viktimat janë viktima dhe nuk mund të diskriminohen në bazë të përkatësisë etnike. YIHR-a beson se e vërteta nuk mund të fshihet, përkundrazi duhet të bëhet ballafaqimi me të.



DRAGAN POPOVIQ

# NISMA ËSHTË NJË MBLEDHJE E TË GJITHËVE QË E KANË KALUAR DHE I KANË DHËNË NJË PJESË TË VETES



Dragan Popoviq

Drejtëor Programi, YIHR Serbi, 2006-2010.  
Dragani aktualisht punon në Fondi European për Demokraci.

**Pas diplomimit në Fakultetin Juridik, Dragani punoi ca kohë si hulumtues për shkeljet e të drejtave të romëve, duke kaluar shumicën e kohës në vendbanimet e tyre informale në Beograd. Më pas, në tetor të vitit 2004, ai aplikoi për punë në Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut. Ishte një "kohë e turbullt e llogaritjes me trashëgiminë e brishtë të Zoran Gjingjiqit dhe shpërbërjes graduale të Republikës së 5 Tetorit", e cila përfjetoi rënien e saj në vitin 2012, me kthimin e madh të ideologjisë radikale.**

Pas punësimit në Nismë, Dragani shkoi për herë të parë në Kosovë për të ndihmuar në themelin e zyrës së Nismës në Prishtinë. Viti është ende 2004, pak muaj pas dhunës së marsit: "Është e vështirë të përshkruhet se çfarë ngjarje ishte për një 24-vjeçar që takoi Kosovën për herë të parë, disa muaj pas dhunës së njohur të marsit në atë vend".

Dragani kaloi gjashtë vjet te Nisma. Gjatë asaj kohe, përtë u kristalizuan dy karakteristikat e saj më të rëndësishme: "Së pari, siç ka thënë me humor dikush, një vit në Nismë është si shtatë vite njerëzore.

Një karakteristikë tjeter e rëndësishme ishte kultura specifike organizative. Nisma ishte para së gjithash një klub njerëzish të përkushtuar, atyre që mbi të gjitha besonin në misionin e organizatës, që shoqëria të bazohej në parime si e vërteta dhe drejtësia për viktimat, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, përballja me të kaluarën e vet. Në Nismë nuk kemi punuar asnjëherë vetëm për pagë", thotë Dragani dhe shpjegon se orët e kufizuara të punës nuk ishin prioritet, por e gjithë ajo atmosferë krijonte presion të konsiderueshëm te njerëzit, që shpesh konte në një dëgjë ose burnout.

Dragani u largua nga Nisma në vitin 2010, por vazhdoi të merrej me tema të ngjashme, duke punuar në sektorin civil, politikë dhe shkencë. Ai thotë se vitet e kaluara në YIHR ishin një lloj shkolle që e ndërtói dhe e ndihmoi të bëhej ky që është sot.

"Sukseset që përfjetova në Nismë ishin të paçmueshme për rritjen time të mëtejshme. Vajza që, pas dëshmisë së Xhevad Kolxhiq-it, heq bluzën me fotografinë e Sheshelit dhe i afrohet atij për t'i kërkuar falje në Kralëvë në 2006, ose mirënjoja e të rinjve në Tuzla, sepse erdhëm në

vitin 2010 për t'i bërë nderimet tona viktimave të vitit 1995, më shënuan për tërë jetën.

Dragani thekson se mbi të gjitha, lufta për vlerat shoqërore të promovuara nga Nisma u bë pjesë e tij, çfarëdo që bëri në jetë. Mospërfillja për shoqërinë civile klasike dhe të orientuar nga projektet mbeti, si një version i çorodit të asaj që besonte se duhet të ishte sektori civil. Ai beson se aq sa kanë kontribuar veprimet e suksesshme në zhvillimin e tij profesional, ndoshta edhe më shumë kanë kontribuar gabimet që kanë bërë si dhe disfatat që kanë përfjetuar.

"Si një brez që duhej të trashëgonte ekipin e antiluftës nga viteve të 90-ta dhe që ka punuar me ta krah për krah, të gjithë bashkë përfjetuan një disfatë të rëndë, sepse sot shoqëria është në një gjendje më të keqe se 20 vite më parë. Nuk ka dyshim se në gjithë këtë ka një përgjegjësi subjektive të ne aktivistëve dhe liderëve të shoqërisë civile të asaj kohe.

Megjithatë, sado e rëndësishme të jetë për të mësuar mësimet, një situatë kaq e errët nuk duhet të demotivojë askënd. Është një proces afatgjatë, një luftë për themellet mbi të cilat do të ndërtojmë shoqërinë dhe shtetin tonë. Lidhur me këtë është ndoshta mësimi më i rëndësishëm nga Nisma – forca më e madhe kanë qenë gjithmonë njerëzit. Të përkushtuar, punëtorë, këmbëngulës, shpesh cinikë dhe të démtuar nga imazhet e tmerrshme që shikonin dhe rrëfimet akoma më të tmerrshme që dëgjonin... Njerëzit që e dinë pse ishin, janë dhe do të janë gjithmonë pjesë e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut".

# YIHR-A, SHEMBULL SE SI HAPEN RRUGËT E VËSHTIRA



**Fitore Berisha ishte njëra ndër themelueset e zyrës së YIHR-së kur u vendos që ajo të hapej në Prishtinë në vitin 2004, dhe në vitin 2005 ishte drejtore e saj. Në fillim, Fitorja kishte vetëm një anëtarë stafi dhe disa aktivistë që e ndihmonin organizatën nga jashtë.**

Ajo kujton një banesë të vogël në qendër të Prishtinës ku duhej të regullohej gjithçka për të nisur aktivitetin e organizatës dhe plot të rind entuziastë për të parë një lëvizje të gjëra e vend që po bëhen sheshin pjesë e synimeve të organizatës.

Berisha kujton dy projektet e vetme që ishin në atë kohë: "Journalists can do it" dhe projekt "Visiting programme" që ishte një program shkëmbimi rinor.

Një tjetër iniciativë të cilën ajo e ka memorizuar si një simbol ku fillojnë të thyhen mitet ishte udhëtimi në Novi Sad të Serbisë i 40 artistëve nga Kosova për në festivalin Exit. Në atë kohë ishte udhëtimi i parë i artistëve nga Kosova në Beograd. Ajo thotë se edhe pse kishte barrën më të madhe të mbarëvajtjes, secili mundohej të ishte i kujdeshëm që t'i shmangeshin incidenteve.

Pas kësaj, YIHR mbloodi aktivistë nga Kosova e Serbia dhe i dërgoi në udhëtimin e parë në Srebrenicë, vendin ku në korrik 1995 ndodhi gjenocidi ndaj mbi 8000 mijë civilëve bosnjakë. "Ne po i bënim të rinxjtë të shohin dhe të prekin vetë atë që vërtetë kishte ndodhur në Srebrenicë".

Këto janë dy projektet ku ajo punoi më shumë në mënyrë direkte dhe indirekte dhe për të cilat ende ka një ndjenjë përkatësie. Ishte një kohë që të rinxjtë nuk e imagjinonin Prishtinën apo Beogradin në atë mënyrë. "Ishte koha kur ne po u pasqyronim si ishin shoqëritë tona sidomos kjo në Kosovë".

Ajo thotë se YIHR-a po shtronët një rrugë në të cilën ngadalë mund të ecej drejt një shtegu të afrimit të njjerëzve pas një të kaluare të errët, një gjë që nuk mund ta bënin të njëjtë organizatat e tjera pavarësisht punës së madhe që bënin shumë prej tyre në ballafaqimin me të kaluarën. Vite më vonë Berisha thotë se në atë kohë nisma e YIHR-së dukej utopike dhe me shumë dilema nëse do të mund ta bënte atë për të cilën synonte. "Thjesht e kishim të vështirë ta besonim nëse do të mund t'ia dilnim".

Berisha, një piktor që në fokusin e saj ka të drejtat e njjerit dhe sidomos të grave, u largua nga organizata ku punonte dhe iu bashkua YIHR-së pasi Andrej Nosovi dhe njëz të tjerë entuziastë rreth tij e bënë të besonte se me këtë organizatë mund të bëhej një punë ndryshe që nuk ishte bërë deri atëherë.

Ajo kujton kohën e pastrazirave të marsit të vitit 2004 në Kosovë kur duhej të udhëtonte shpesh mes Prishtinës dhe Beogradit dhe me kujdes i duhej të veprohej për të vënë një bazë të organizatës në atë kohë. "Nuk ka qenë e lehtë. Ishte një punë me tepër presion për shkak të tensioneve ndëretnike".

Ajo thotë se YIHR-a është një shembull se si hapen rrugët e vështira dhe si trasohen rrugët drejt një synimi për ballafaqimin me të kaluarën, paqen dhe pajimin në rajon. Më shumë se një dekadë që kur ajo kishte lënë YIHR-në, në vitin 2017, në festivalin "Mirëdita, Dobar Dan" në Beograd ajo solli një pikë vallëzimi të titulluar "Love and Hate", me një muzikë islandezë por me valltarë nga Kosova. Koreografia përbante temën e revoltës kundër dhunës.

"Mesazhi ishte se në çdo konflikt jemi të cenueshëm dhe të goditur si njëz. Kiske reagime se unë provokoja me atë vallëzim. Por po përpinqesa t'u shpjegoja se në çdo luftë, sado brutale që të jetë, ka dashuri dhe urrejtje", kujton ajo.

Berisha thotë se YIHR-së ia ka borxh njëfarë kulturë pune të pavarrur, të bazuar në integritet – një gjë që më pas e ka përdorur për të luftuar femicidin çokund ku ekziston.

Pas më shumë se 15 viteve të jetës saj jashtë Kosovës, tanë kur është kthyer sërisht në vendlindje, Fitorja është e habitur se si YIHR-a ka mundur të qëndrojë në rrugëtimin e vet duke ruajtur të njëtin përkushtim dhe qëllim për të cilin ishte themeluar.

"YIHR-a është thjesht një sinonim i vizionit, guximit dhe vlerave njëzore", thotë Fitore Berisha.

# YIHR-A, SHKOLLË QË NA DUHET



**Një grup të rinjsh entuziastë ishin mbledhur dikur para 19 viteve për të biseduar rreth asaj se çfarë mund të arrihet në rajon brenda një periudhe kohore në çështjen e të drejtave të njeriut.**

**Shpend Qamili ishte njëri nga ta.**

Gati dy dekada më pas, Qamili kujton se atë kohë, të rinjtë ishin treguar optimistë në parashikime.

"Ne kemi menduar që do të na duhen nga 10 vjet që të merremi me çështjet ndëretnike, ballafaqimin me të kaluarën e gjëra të tillë. Ishte kalkulim jo mjaft i qëlluar nga ana jonë, ndoshta për shkak të entuziazmit, se mendonim se gjërat do të shkojnë në drejtim vetëm pozitiv për shkak se rajoni synon Bashkimin Evropian dhe besonim se rruga drejt BE-se i spastron disa gjëra", thotë Qamili.

Si njëri ndër themeluesit e Zyrës së YIHR-së në Prishtinë, Qamili thotë se në atë kohë, situaçia për t'u marrë me çështjet të cilat i avokonte organizata ishte më e favorshme se tani.

"Drejtimi të cilin e kemi pas marrë në aspektin politik ka qenë njëfarë trendi drejt pajtimit, drejt bashkëpunimit, drejt shkëmbimit, ndërsa nuk kemi pritur që do të ndodh eskalimi dhe kthimi i narracioneve të vjetra. Ka qenë pak më ndryshe, ka pasur më shumë optimizëm", thotë ai.

Kur flitet përfshirjen e rinisë në aktivitete që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, Qamili thotë se kjo është një gjë "që kërkon finesë".

"Një gjë që mendoj që e ka bërë YIHR-a më mirë se të tjerët është ajo që ka përfshirë ata të cilët nuk janë pjesë e mendimit të njëjtë. Pra, janë njerëz që besojnë në narracione të tjera, krejtësisht të kundërtë me ato të YIHR-ës, përfshirë edhe të rinjtë të cilët janë pak më të radikalizuar. Ata ishin përfshirë në nisma të ndryshme tonat.", thotë Qamili.

"Nuk kemi shkuar gjithmonë t'i ftojmë të rinjtë të cilët kanë një tendencë të janë më kosmopolitanë, më liberalë, por kemi ftuar edhe të rinj që vijnë me një narracion më klasik, më radikal, më tradicional, më nationalist dhe kjo ka qenë veçoria kryesore", shton ai.

Përgjatë viteve, Shpend Qamili ka shërbyer si mentor, është përfshirë në trajnime të ndryshme dhe është konsultuar kur

ka pasur nevojë për një opinion nga ata që konsiderohen si pionierë të organizatës.

"Më kanë thirrë, më kanë respektuar të gjitha gjeneratat dhe edhe sot kam marrëdhënie të mira me të gjithë udhëheqësit dhe aktorët të cilët i kam njojur dhe i njoh. Kam qasje jashtëzakonisht të mirë te zyrat e YIHR-ës. Nuk kam ndonjë rol, jam vetëm përkrahës", thotë ai.

Ai thotë se përvëç mundësisë së krijimit të kontakteve gjatë punës me organizatën, YIHR-a i ka dëshmuar edhe kapacitetin dhe potencialin që ka shoqëria civile për të vepruar.

"Më ka kthyer me dy këmbë në tokë në kuptimin që duhet ta rivlerësoj gjithmonë vetveten, kapacitet dhe mundësitet se ç'ka mund të bëhet. Mua më ka bërë të kuptoj që kur ideja është e mirë dhe kur puna bëhet në mënyrë të mirë në fillim, ajo ide vazhdon", thotë ai.

"YIHR-a ka krijuar një masë kritike mes të rinjve të cilët tani nuk janë edhe aq të rinj, por oë kanë punuar dhe janë angazhuar në kuadër të YIHR-ës dhe kanë qenë, janë e do të janë në të ardhmen nëpër poste kyçe, qoftë politike, qoftë të tjera", nën vizion Shpend Qamili.

Qamili thotë se edhe në vendin e punës ku punon tani, raportet e YIHR-ës i shërbejnë si bazë për shqyrtim të mëtejshëm.

Ai nën vizion se edhe në kohët kur nuk ka qenë pjesë e organizatës, asnjëherë nuk e ka ndier veten jashtë saj dhe se gjithmonë ka qenë i lidhur me aktivitetet e saj në terren.

"YIHR-a është shkollë që na duhet. Shkollë, sepse njerëzit vijnë, mësojnë, e më pas i mësojnë të tjerët. Duke u munduar t'i mësojnë të tjerët, mësojnë veten akoma më shumë. Kjo është ndoshta gjëja më e mirë për të arritur në një stad tjetër", thotë Shpend Qamili.

"Një vend i vogël si Kosova, nuk mund të imagjinohet pa YIHR-ën. Mendoj se YIHR-a duhet të ekzistojë", përfundon ai.

# YIHR-A KA VEPRUAR KUNDËR RRJEDHËS DHE KA PASUR TË DREJTË



**Valon Arifi ishte student i Ekonomisë në Prishtinë kur iu bashkua YIHR-së në vitin 2004, pasi kishte punuar një kohë me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Bujanoc. Ai vazhdon të jetë aktivist i organizatës dhe është ndër aktivistët më jetëgjatë në YIHR. Tregon se në atë kohë situata politike e shoqërore dhe raportet ndëretnike ishte jo stabile, sidomos pas konfliktit në Luginë të Preshevës të vitit 2001.**

Aty kishte një ndarje të prerë mes shqiptarëve dhe serbëve. Nuk kishte asnje lloj bashkëpunimi apo komunikimi. Nuk kishte asnje lloj besimi dhe nuk kishte rrugë për integrim.

Për herë të parë të rinxjtë shkuan në Beograd përmes YIHR-ës dhe urës së komunikimit që krijoj.

“Ishte shumë problem të merreshin të rinxjtë për të shkuar në Beograd, sepse familjarët nuk i lejonin, sepse kishin frikë për sigurinë e tyre. Nuk kishte aspak besim. Deri në atë kohë ishte problem lëvizja e lirë, ndjesia e lirisë së lëvizjes pa frikë. Në atë kohë ishte tejet e vështirë të gjeje të rinx që merrnin pjesë në programe apo nisma ndëretnike, çfarëdo qofshin ato. Ne ishim të parët që morëm guximin të sfidonim atë gjendje dhe të udhëtonim në Beograd për të marrë pjesë në protesta apo aktivitete që ndërlidheshin me krimet e luftës”, kujton ai.

Arifi thotë se nuk ka projekt që ka qenë ideator, por që në shumicën e aktiviteteve ka qenë pjesëmarrës dhe i gjithë kontributi i aktivizmit të tij është ndarë mes Kosovës dhe Preshevës. Ai përmend aktivitetet për të zhdukurit dhe diplomave, dy prej aktiviteteve ku ka qenë më shumë i përfshirë emocionalisht.

Ai thotë se ka qenë pjesë e marshit përkujtimor në Tuzla të Bosnjës në vitin 2010 ku të rinx serbë, shqiptarë e boshnjakë po marshonin për ngritur vetëdijesimin për pranimin e krimeve dhe ndëshkimin e krimeve të luftës.

“Në fillim kur protestonim për të zhdukurit në Beograd na ruante Xhandarmëria. Që atëherë gjérat filluan të lëvizin më shumë në mendjet e njerëzve sesa në rrafshin zyrtar”, thotë Arifi.

Ai ka marrë pjesë edhe në protesta të tjera në Serbi, siç është ajo në Batajnici, në periferi të Beogradit, lokacionin ku në vitin 2001 u gjetën mbetjet mortore të mbi 700 civilëve shqiptarë të Kosovës, të vrarë gjatë luftës së vitit 1999.

“YIHR-a dhe Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Gratë me të Zeza kanë kontribuar në thyerjen e mitit që mbizotëron në Serbi se nuk janë kryer kime, duke iu kundërvënë mohimit të krimeve”, thotë Arifi.

Ai në vitin 2015 fitoi çmimin “Personaliteti i Vtitit në Serbi” të ndarë nga Misioni i OSBE-së për aktivizmin me refugjatë gjatë krizës së refugjatëve nga Lindja në rrugën e tyre drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

“Janë disa nga gjëra që tregojnë se asnje organizatë e shoqërisë civile nuk do të merrte përsipër një rezik dhe do të guxonte të sfidonte hapur disa nga ato që ishin rrënjosur me vite në shoqëritë tona”, thotë Arifi.

“Para së gjithash ishte guximi për të vepruar. YIHR-a ka përfaqësuar gjithmonë një gjeneratë me vizion që sfidonte diskursin e krimit, ndërsa në anën tjeter, përpiquej të shtronte rrugë për rivendosjen e paqes, pajtimit dhe komunikimit normal të njerëzve në një kohë kur kjo dukej e pamundur. YIHR-a realisht ka mbledhur të rinxjtë entuziastë që mund të bënin ndryshime”, shton ai.

Arifi kujton se shumë njerëzve u dukej e pamundur kur u thoshte se shkon në Prishtinë dhe Beograd.

Bashkë me hezitimet vinin edhe etiketimet.

“Na thonin “të paguar nga jashtë” ose “të paguar nga ana tjeter” varësisht se ku ishim apo ku zhvillonim aktivizmin tonë”, thotë ai.

Valon Arifi thotë se YIHR-a ka ndryshuar shumëka në botëkuptimin e tij.

„Por më së shumti përsa i përket komunitetit LGBT. Para se t'i bashkohesha YIHR-së, si 15-16 vjeçar, nuk kam perceptuar drejt. Por rrugës, YIHR-a ka formësuar shumëka në pikëpamjet e mia”, thotë Arifi.

“Ndjehem krenar që kam mbetur në aktivizëm dhe me YIHR-në pas kaq shumë viteve. Nuk më ka lënë të shkëputem... Shpirti i aktivizimit që është rrënjosur tek unë është gjithashtu meritë e YIHR-së”, nënizon ai.

Duke rikapitular punën e tij dhe të organizatës ndër vite, Valon Arifi thotë: “YIHR-a në fillim ka qenë ishull i disa fëmijëve, t'i quaj kushtimisht, që kanë provuar të bëjnë diçka jo vetëm komplet ndryshe prej rajonit, por që kanë vepruar kundër rrjedhës dhe që kanë pasur të drejtë”

## PARADA E KRENARISË NË PRISHTINË: FESTOJMË DASHURINË!

YIHR Kosovo është një nga organizatorët e Javës së Krenarisë në Prishtinë, e cila përveç fuqizimit të personave LGBTIQ+, synon të rrisë vetëdijen kolektive dhe dukshmërinë e orientimeve të ndryshme seksuale dhe/ose identiteteve gjinore në shoqërinë kosovare. Merret me çështje të komunitetit LGBTIQ+ dhe lufton kundër diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë të personave LGBTIQ+ në Kosovë. Kosova është ende një shtet strukturor homofobik, sepse jetët e njerëzve queer janë të mbushura me urrejtje, dhunë dhe diskriminim. Krenaria është një protestë kundër akteve të tillë, duke festuar gjithashtu rezistencën queer, diversitetin dhe gëzimin.

Për shkak të diskriminimit të vazhdueshëm dhe sistematik, mospranimit dhe përjashtimit nga familja, shoqëria dhe shteti, personat LGBTIQ+ përballen çdo ditë me nivele të larta ankhji, stresi dhe depresioni. Paradat e krenarisë në rajon janë bërë gjithashtu platforma për forcimin e solidaritetit rajonal të aktivistëve dhe aktivisteve dhe grupeve të margjinalizuara.

Çdo vit ka një temë të ndryshme për Paradën e Krenarisë në Prishtinë, megjithatë, në edicionin e fundit, të 7-të, fokusi ishte në shëndetin mendor të personave LGBTIQ+, duke theksuar pasojat që homofobia sistemike ka në cilësinë e përditshme të jetës së njerëzve queer.



IVAN STOJANOVIQ

# NISMA ËSHTË VEND KU JAM GJITHMONË NË MESIN E NJERËZVE TË MI



Ivan Stojanovic

Koordinator i Programit për të rinjtë, Koordinator i Programit të ballafaqimit me të kaluarën, Koordinator i Fushatës „Mobilizimi i Serbisë Qytetare”, Koordinator i Zyrave Lokale, Koordinator për Zhvillim i Nismës së të rinjve për të Drejtat e Njeriut, 2004-2013. Aktualisht këshilltar për koordinimin e projekteve në Misionin e OSBE-së në Serbi.

**Ivani u bë pjesë e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi në fund të vitit 2004. Deri në moshën 26 vjeçare, sa ishte kur iu bashkua YIHR-së, Ivani kishte shumë vite përvojë aktiviste në disa organizata të shoqërisë civile në Serbi dhe kishte ndjekur gjatë punën e Nismës sepse ajo “promovonte vlerat për të cilat isha edhe unë dhe trajtonte tema që më interesonin – ballafaqimin me të kaluarën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”. Ivani fillimisht punoi në YIHR si asistent i TI-së, por shpejt kaloi në atë për të cilën fillimisht erdhi në organizatë: filloi të drejtonte Programin për të rinjtë dhe Programin për ballafaqimin me të kaluarën.**

Në kohën kur ai iu bashkua organizatës, situata në Serbi, përfat të keq, ishte e ngjashme me atë që po jetojmë tanë:

“Klima shoqërore e atëhershme, pas vrasjes së kryeministrit Gjingiq, ishte tmerruese, siç është edhe sot – mohimi i krimeve të luftës dhe glorifikimi i kriminelëve të luftës në hapësirën publike, ngritja e nacionalizmit, sidomos tek të rinjtë, neglizhenca e shtetit në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, frika dhe humbja e shpresës tek të rinjtë”.

Gjatë tetë viteve të kaluara në Nismë, Ivani veçon si nisma më të rëndësishme Programin për ballafaqinim me të kaluarën dhe fushatën “Mobilizimi i Serbisë Qytetare” përzgjedhjet parlamentare të janarit 2007, kur shumë aktivistë ishin të përfshirë në punën e organizatës, dhe YIHR-a u bë e njohur në publik. Ivani ka punuar edhe si koordinator i zyrave lokale në Nish, Kragujevc, Zrenjanin dhe Novi Sad, ndërsa që nga viti 2009 ka qenë edhe koordinator për zhvillim në nivelin rajonal, falë të cilit ka bashkëpunuar, siç thotë ai, me njerëz të mrekullueshmë në mbarë Serbinë. Bosnjë dhe Hercegovina, Kroaci, Mali të Zi dhe Kosovë.

Ivani qëndroi në Nismë deri në fund të vitit 2013, kur krijoi agjencinë e tij që merret me shkrime të projekteve dhe përmes së cilës vazhdoi të bashkëpunojë me YIHR-ën në Serbi edhe në vitet në vijim. Ai është ende i interesuar për temat që trajtoi në Nismë, kështu që në vitin 2021 ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Shkencave Politike me punimin e magjistraturës me temën e drejtësisë tranzicionale në Serbi. Pas Nismës ka punuar në disa organizata ndërkombëtare ku, siç thotë ai, “i kam aplikuar të gjitha njohuritë dhe aftësitë që i kam marrë dhe i kam krijuar me punën time në Nismë”.

Sot ai thotë se vitet që ka kaluar me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut kanë lënë gjurmë të paheqshme tek ai – si personalisht ashtu edhe profesionalisht:

“Në planin personal, Nisma ishte për mua një vend ku unë mund të përfaqësoja hapur dhe efektivisht bindjet e mia, mbi të gjitha në aspektin e qëndrimeve sociale dhe personale ndaj krimeve të luftës dhe ndryshimit të qëndrimeve të të rinjve në mënyrë që shoqëria të mund të ecë përpara. Aty kam bërë shumë miq të ngushtë dhe kam krijuar shumë njohje të reja me njerëz me besime dhe qëndrime të ngjashme.

Në aspektin profesional, i kam zhvilluar shumë aftësitë dhe njohuritë e mia, të cilat i përdor ende çdo ditë. Kjo i referohet kryesisht në organizimin e punës dhe të etikës së punës, por edhe të shkruarit dhe menaxhimit të projekteve, raportimeve dhe komunikimeve. Gjithashtu, kam takuar një numër të madh profesionistësh të fushave të ndryshme me të cilët bashkëpunoj me sukses edhe sot”.

MARIJANA TOMA

# NISMA ËSHTË GARANCI SE DO TË EGZISTOJË NJË VEND ME VLERA TË CILAVE U BESOJ



Marijana Toma

bashkëpunëtore e Nismës dhe doktorante në Universitetin Katolik të Louvain në Belgjikë.

**Bashkëpunimi mes Marijana Tomës  
dhe Nismës së të Rinjve për të Drejtat  
e Njeriut erdhi natyrshëm, pothuajse  
menjëherë pas themelimit të organizatës,  
e cila aktualisht po mbush 20 vjet.  
Marijana ka punuar si mësuese e historisë  
në shkollat fillore dhe të mesme të  
Beogradit, e më pas në Fondin për të  
Drejtën Humanitare, dhe puna edukative  
me të rinjtë ka qenë gjithmonë e afërt  
dhe e rëndësishme për të.**

"Mendoj se në vitin 2004 isha në Risan në një ngjarje të Nismës ku mblohdhën aktivistë të rinj nga i gjithë rajoni dhe diskutuan për ballafaqimin me të kaluarën. Kështu filloi".

Pas kthimit nga studimet master në Republikën e Afrikës së Jugut, Nisma fillon ta angazhojë Marijanën rregullisht në të gjitha aktivitetet dhe nismat që kanë të bëjnë me edukimin e të rinjve për drejtësinë tranzicionale. Një nga projektet e saj më të rëndësishme dhe më të preferuar është "Shkolla e Politikës së Re", ku ka qenë pedagoge dhe mentore në pjesën e projektit që ka të bëjë me drejtësinë tranzicionale. Ajo është bashkëautore e kurrikulës për drejtësinë tranzicionale, por ajo që është shumë më e rëndësishme është se ajo kishte "lirinë, nderin dhe privilegjin" për të punuar me aktivistet dhe aktivistët e rinj.

"Pavarësisht se sa e zhgënjer dhe e frustruar isha nga vetë procesi, nga pamundësia për të arritur diçka më të madhe, mbi të gjitha kur bëhet fjalë për presionet ndaj shtetit për t'u ballafaquar me të kaluarën, bashkëpunimi me Nismën dhe të rinjtë që gjeti Nisma më ka rikthyer shpresën dhe besimin dhe më ka dhën atë lloj injekzioni entuziazmi për të qëndruar në atë fushë kaq shumë vite. Ky është aspekti më i rëndësishëm i bashkëpunimit tim me Nismën".

Kur gjatë gjithë këtyre viteve mendonte se nuk mund të merrej më me drejtësinë tranzicionale, se gjithqka ishte e kotë, se po kalonte djegie, "do të shfaqej ndonjë qenie e re që Nisma do ta gjente diku: Anita Mitiq, Jovana Kolariç, Marjan Maruna, Katarina Maruna, Gjorgje Bojoviq, Sofija Todoroviq, Boris Dimitrijeviq" dhe të gjithë të tjerët me të cilët ka punuar dhe do t'i tregonin se e gjithë kjo ka kuptim, në fund të fundit.

Përveç Shkollës së Politikës së Re, Marijana veçon si një projekt veçanërisht të rëndësishëm Viziting Program të

dedikuar për të rinjtë nga Serbia dhe Kosova, për të cilin veçanërisht "e heq kapelen për Andrejin", duke besuar fuqishëm se Nisma ka krijuar një lidhje të pathyeshme mes të rinjtë e të dyja palëve, gjë që askush tjetër nuk ka pasur potencial për ta bërë.

Shumë gjëra kanë ndryshuar në këto 20 vite, thotë Marijana. Optimizëm na jep fakti se sot një numër shumë më i madh njerëzish qëndrojnë pas Nismës dhe marrin pjesë në punën e saj. Nga ana tjetër, drejtësia tranzicionale dhe ballafaqimi me të kaluarën nuk ekzistonjë më në diskursin publik, nuk diskutohen dhe këto tema janë hedhur në plan të dytë. Përveç Nismës dhe disa organizatave të tjera në vend dhe rajon, askush nuk merret më me këto tema.

"Unë do të doja të shikoja që interesimi për ato tema të rikthehet, dhe këtu e shoh Nismën në të ardhmen, kështu që duhet të vazhdojë me punën e saj edukative.

Nëse Nisma vazhdon të mbajë atë flakë të vogël të ballafaqimit me të kaluarën dhe të vazhdojë të tërheqë të rinjtë që duan të merren me të, besoj se do të krijohen disa kapsula fillestare të rinjsh që do të jenë të neveritur nga koha dhe rrëthanat në të cilat jetojnë dhe në të cilën profesori i këshillon në fakultet për të shkuar në luftë. Se do të dal një grup i të rinjve që do të thonë – mjaft më".

Nisma i solli shumë Marijanës: miqësi që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, kënaqësi që nxënësit e tejkalanat atë dhe, më e rëndësishmjë, "besimin se ajo që bëj ia vlen".

"Nisma është një garanci se egziston një vend që ruan disa vlera në të cilat unë besoj dhe një vend që jam e sigurt se do të ekzistojë një ditë kur të rritet fëmija im. E di që do të jetë shtëpia e tij e sigurt".

## GJERAQINA TUHINA

# YIHR-A, ORGANIZATË E HAPAVE TË PAIMAGJINUESHËM



**Ishte fundi i 2004 kur Kosova sapo kishte kaluar një moment tjetër të mbrapshtë pas trazirave të marsit të atij viti, kur 23 persona, shumica shqiptarë, u vranë në përleshje me policinë dhe trupat paqeruajtëse të NATO-s dhe OKB-së, derisa disa prej tyre po digjin shtëpi dhe kisha serbe. Në atë kohë Gjeraqina Tuhina, një gazetare e shquar shqiptare e Kosovës, vendosi t'i bashkohej një nisme që synonte të krijonte një urë komunikimi mes të rinjve serbë e shqiptarë.**

Ajo tregon se ishte "entuziazmi" i një djaloshi atëbotë të ri nga një qytet i vogël i Serbisë që e shtyri të kontribuojë në nismën e tij me qëllim që "ta përkrahë këtë djalë me vision".

Fjala është për Andrej Nosovin, nismëtar të Nismës...

"Ishte periudha post-trazirave të marsit të vitit 2004, një ngjarje që prodhoi pasoja serioze jo vetëm të momentit, por edhe në dekadat në vijim, e që ndikoi edhe në formën dhe substancën e shtetkrijimit të Kosovës", kujton Tuhina.

Duke parë atmoferën politike e shoqërore dhe faktin se Nosovi nuk ishte edhe aq mirë i etabluar në shoqërinë civile në Serbi, dhe pakkush e njihet, në atë kohë Tuhina shumë pak kishte besuar se Nisma do kishte sukses. Por tregon se shpejt e pa se Nosovi kishte shumë vullnet, vizion dhe mbi të gjitha guxim që të bëjë hapa që në kontekstin kohor ishin të jashtëzakonshëm.

Tuhina nuk dyshonte se Nisma do të funksiononte në një kohë kur ishte periudhë e rëndë në historinë e paslufteve, pas trazirave të vitit 2004. "E mbaj në mend si sot kur Andreji më tha se donte të formonte organizatën që një ditë do jetë më e madhja në rajon. Nuk besoja se do t'ia dilte. Fatmirësish, parashikimet e mia dolën të gabuara", thotë ajo.

Si anëtare e Këshillit të Përgjithshëm, nga dita e parë e formimit të organizatës, Tuhina ishte aktive në këtë organizatë dhe ajo ndien se disa nga projektet më të rëndësishme të kësaj organizate ishin "Visiting Program" dhe nisma tjetër e organizatës, "Dita e Papërshkruar e Historisë".

Ajo thotë se mësoi shumë nga këmbëngulja e të rinjve serbë e shqiptarë që të ecin përpara pavarsisht së kaluarës. "Ne punonim që të rritjej numri i atyre që përfshiheshin, duke marrë parasysh kontekstin kohor sepse po bëhej në periudhën kur pakkush guxonte të nisej nga Prishtina në Beograd apo anasjelltas".

Tuhina thotë se ajo çfarë ka bërë YIHR-a në atë periudhë, e që në sytë e saj ka qenë e paimagjinueshme për rrethanat e kohës, ishte krijimi i lidhjeve mes të rinjve të Kosovës dhe Serbisë, të cilat ishin plotësisht të shkëputura për shumë vjet.

Në atë kohë lidhjet kulturore apo të tjera ishin tepër të rralla dhe pothuajse nuk kishte fare kontakt mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.

YIHR-a organizoi programe vizitore ku të rinjtë u takuan e u njohën fizikisht, u krijuan kontaktet private e profesionale dhe u thyen paragjykimet si dhe barrierat të cilat ishin ndërtuar me vite e që ishin forcuar nga lufta e viteve 1998-99.

Dy nisma të tjera që Tuhina i kujton si me më shumë peshë për kohën që ishin nisur nga YIHR-a, ishin takimet dhe bashkëpunimet në nivel të gazetarëve, takimi i parë në nivel të shoqërisë civile në mes të dy vendeve dhe dërgimi për herë të parë i të rinjve kosovarë në festivalin EXIT në Beograd.

"Nga këndvështrimi i sotëm, të gjitha këto elemente duken simbolike e ndonjëherë të parëndësishme. Por jemi dëshmitarë se 20 vite me parë ishin këto hapa të paimagjinueshëm", thotë Gjeraqina Tuhina.

Ajo shton se YIHR-a ka "thyer shumë bariera mentale e madje edhe fizike, falë vizionit dhe vullnetit të një individu që nuk u ndal derisa realizoi ëndërrën e tij".

"Nga një vizion i një qytetari të një qyteti të vogël të Serbisë, YIHR-a u shndërrua në organizatën më të madhe në rajon, veprimtaria e së cilës vazhdon të prodhojë rezultate", thotë ajo.

Në aspektin personal, Tuhina thotë se ishte YIHR-a që në vitin 2006 ia mundësoi udhëtimin në Beograd, vendin ku ajo kishte kaluar pjesën më të madhe të fëmijërisë.

"Nuk e kisha parë qytetin që nga lufta për shkak të rrethanave të asaj kohe dhe ndjenjës së pasigurisë. Andrej Nosovi më bindi që të shkoja në Beograd. E dëgjova. Ishte moment shumë emocionues përmua", kujton ajo.

Dy dekada më vonë Tuhina e sheh YIHR-në si paqyrën e një vizioni të një individu të shndërruar në organizatën më të rëndësishme në rajon.

TARIK SAMARAH

# NISMA ËSHTË NJË SIMBOL I SHPRESËS



Tarik Samarah

bashkëpunëtor i aksionit „Të shikosh, të dish, të kujtosh“ në vitin 2005, YIHR Serbia, fotograf dhe themelues i Galerisë 11/07/95 në Sarajevë.

**Miqësia e Tarikut me Nismën filloi kur Nisma ishte vetëm një ide. Atë korrik 2003, në Srebrenicë, ai u takua me dy të rinj nga Beograd, Andrij Nosovin dhe Nemanja Stjepanoviqin, të cilët erdhën për të nderuar viktimat e krimtit të kryer në emër të tyre. Disa muaj më vonë u themelua zyrtarisht Nisma e të Rinjeve për të Drejtat e Njeriut.**

“Nga ai takimi ynë dhe njohja njerëzore, më vonë erdhi bashkëpunimi formal.”

Tariku dhe Andreji u takuan përsëri në vitin 2004 në Sarajevë, kur ranë dakord që fotografitë e Tarikut nga opusi “Srebrenica” të shfaqen në Serbi.

Një vit më vonë, në dhjetëvjetorin e gjenocidit në Srebrenicë, fotot e Tarik Samarahut u shfaqën në billborde nëpër Beograd, Çacak, Novi Sad dhe Nish.

Mesazhi ishte: “Të shikosh, të dish, të kujtosh.” Për Tarikun, ky veprim artistik dhe aktivist ishte si të mbante një pasqyrë ndaj një shoqërie që refuzon të shikojë reflektimin e vet.

“Në atë kohë për ne ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që fotot të ekspozoheshin në një hapësirë publike, që mesazhi të arrinte te sa më shumë njerëz dhe të thyhej heshtja dhe injorimi që ishin të pranishëm në atë kohë.”

Qëllimi i këtij aksioni ishte fillimi i dialogut mes qytetarëve dhe qytetareve të Serbisë; duke përfshirë mediat dhe personalitete të shquara. Ishte gjithashu një mënyrë për të treguar përgjegjësinë e këtij vendi për atë që ndodhi në korrik 1995 në Srebrenicë.

“Anëtarët e Nismës në atë kohë, të rinxjtë, kishin nevojë për një guxim të jashtëzakonshëm për t'u nisur me këtë projekt.”

Për Tarikun, YIHR-a përfaqësonte “shpresën në mundësinë” që shenjtërimi dhe transformimi i shoqërisë në rajonin tonë mund të ndodhë. Ai thekson rëndësinë e zërave që i rezistojnë politikave të një mendjeje dhe retrograde dhe që mund të janë model për të rinxjtë. Tariku thekson rëndësinë e punës së Nismës për edukimin, rrjetëzimin dhe motivimin e të rinjeve për të qenë agjentë të ndryshimeve sociale. Megjithatë, ndonjëherë kjo lufte kundër forcave shkatërruese duket si “vepra e Sizifit”.

“Megjithatë, është një nder të ndash idenë e humanizmit me grupe si YIHR-a dhe të jesh në anën e drejtë të historisë.”

Ka breza të tërë të rinjsh që janë rritur mbi narrativat e mohimit, kundërshtimit dhe fshehjes, por kjo nuk do

të thotë se përpjekjet “kundër matricave ideologjike dominuese” janë të kota. Në fakt, është një shenjë se të gjithë ata që punojnë në kulturën e kujtesës duhet të janë më të zëshëm. Ballafaqimi me të kaluarën është e nevojshme për shërimin e shoqërisë, thotë Tariku. Megjithatë, në rajonin tonë është ende vetëm një koncept abstrakt.

“Dhe kjo është arsyja pse puna e individëve dhe grupeve si YIHR-ja është edhe më e rëndësishme, sepse barrën e së kaluarës që nuk e kanë përpunuar ata dhe që nuk e kanë përballuar brezat e sotëm, do të duhet ta mbajnë të rinxjtë.”

Tarik Samarah themeloi Galerinë 11/07/95 në 2012 si një vazhdim i punës së tij të mëparshme. Ndërkohë, me hapjen e Galerisë, fotografitë kanë ndryshuar formë – nga një libër/monografi në një ekspositë arti. Ai e konsideron punën e tij një vazhdimësi, qëllimi i së cilës ka qenë gjithmonë për të përcjellë të vërtetën për gjenocidin në Srebrenicë, si dhe për të kërkuar llogari nga shikuesi.

“Megjithatë, vetëm natyra dokumentare e fotografisë nuk mjafton për të angazhuar vëzhguesin modern. Ajo duhet të shkojë përtëj kësaj dhe të apelojë në intimitetin e shikuesit”.

Baza dokumentare e fotografisë ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për të, sepse secila prej tyre është „shënim“ i një momenti të caktuar; nga zhvarrosja e trupave nga varret masive e deri te mbishkrimet e shkruara në muret e ish-bazës së OKB-së në Potoçare. Megjithatë, vetëm dokumentari nuk mjafton për të angazhuar shikuesin. Prandaj ndërthurja e aspekteve dokumentare dhe artistike është kontributi i Tarikut dhe Galerisë 11/07/95 në kulturën e kujtesës dhe temën e ballafaqimit me të kaluarën. Sepse arti, më shumë se çdo gjë tjetër, ka aftësinë dhe fuqinë për të përshkruar të pathënën në tmerrin e ngjarjeve traumatike.

“Besoj se çdo artist (fotograf, shkrimitar...) që ka vendosur të merret me tema të tilla ka përgjegjësinë të angazhohet në mënyrë etike përmes punës së tij dhe peshën që natyrshëm sjell trajtimi i temave të tillë, ta kthejë në një dëshmi të përgjegjshme dhe të përkushtuar.”

Në këtë mënyrë, vepra e Tarikut rrëmben përgjithmonë nga harresa viktimat e gjenocidit në Srebrenicë.

RADOVAN KUPRES

# NISMA ËSHTË RINIA QË NUK PRETENDON TË JETË E SHKUJDESUR



Radovan Kupres

drejtor programi i Nismës në Serbi 2005-2006, sot drejtor kreativ i Crt-a-s.

**Radovani u bë pjesë e Nismës së Rinisë pér të Drejtat e Njeriut në Serbi në vitin 2005, në një kohë kur ajo po ndërmerrte hapat e saj të parë, të guximshëm dhe në një kohë kur "klima në shoqëri nuk ishte e favorshme pér një debat publik rreth krimeve të luftës, rreth fajit dhe përgjegjësisë". Si pjesë e Nismës, ai ka avokuar bashkëpunimin e institucioneve serbe me Tribunalin e Hagës dhe ka luftuar pér të vërtetën pér gjithçka që ndodhi në territorin e ish-Jugosllavisë gjatë luftës së viteve të nëntëdhjeta.**

Pikërisht në atë kohë, shpjegon Radovani, në Serbi, "në rastin më të mirë, ata prireshin të shtynin fakte të pakëndshme nën qilim, në rastin më të keq – të falsifikon historianë dhe të lavdëronin kriminelët". Situata nuk është shumë më e mirë edhe sot, por prapëseprapë një pjesë shumë më e madhe e shoqërisë është e vetëdijshme pér barrën që po mbajmë nga vitet e luftës së viteve 1990-ta".

Ai kaloi pak më shumë se një vit në Nismë në pozicionin e drejtorit programor, gjatë të cilit, siç thotë edhe vetë, ishte pjesë e disa sipërmarrjeve shumë të mëdha dhe të rëndësishme. I pyetur se cilat janë nismat më të rëndësishme të Nismës në të cilën ka marrë pjesë, Radovani thotë:

"Ekspozita Outdoor kushtuar 10 vjetorit të gjenocidit në Srebrenicë është pa dyshim momenti më i rëndësishëm i përfshirjes sime në Nismë. Bëmë diçka shumë subversive dhe "të guximshme", përdorëm billborde pér diçka që në atë kohë askush nuk mendonte se mund të pëndoreshin. Shkaktuan shumë zemërim, ishim shënjestër e sulmeve të tmerrshme, por fituan edhe mbështetjen e shumë njerëzve që deri atëherë as nuk dinin pér ne.

Jehona mediatike e asaj fushate ishte e pabesueshme – ne u shfaqëm në programet dhe faqet e mediave më me ndikim nga SHBA-ja deri në Japoni dhe me shumë zë të lartë porositëm se Serbia e mohimit nuk është e vetmja Serbi që ekziston".

Si te shumë anëtarë të tjera të Nismës, ish dhe aktual, edhe te Radovani, në këtë organizatë ishin të ndërthurura personalja dhe profesionalja dhe ishte shumë e vështirë të ndaheshim. Edhe pse i gjithë sektori joqeveritar u stigmatizua në fillim të viteve të 2000-ta, ai u karakterizua nga "guxim i pakompromistë".

"Më bëri përshtypje mundësia pér të bashkëpunuar me pionierë (kryesisht pioniere) të luftës pér të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzicionale nga organizata të vjetra, por edhe pér të takuar të rinj të jashtëzakonshëm (atëherë) në ekipin e Nismës".

Ai u largua nga Nisma gjatë vitit 2006 pasi siç thotë ai, nuk ndihej më i ri.

"Është fakt se unë isha më i vjetër se shumica e anëtarëve dhe anëtarëve të ekipit, dhe se pak më shumë përvojë jetësore dhe profesionale, ishte ajo që mund t'i jepja organizatës, por sigurisht që kisha shumë edhe pér të mësuar."

Pas nismës vazhdova të merresha me atë që më së shumti merresha në të – komunikimet".

# NISMA ËSHTË NJË ORGANIZATË AVANGARDE



Suada Kapiq

bashkëpunëtore e Nismës në 2005  
dhe 2010, YIHR Serbi, YIHR Bosnjë dhe  
Hercegovinë, tani pjesë e ekipit të shoqatës  
së Metodologjisë FAMA.

**Suada Kapiq mori arsimin e saj formal duke studiuar letërsi dhe filozofi krahasuese në Fakultetin Filozofik në Sarajevë, dhe më vonë regjinë në Fakultetin e Arteve Dramatike në Beograd.**

**Pak para fillimit të luftës në vitin 1990, themeloi shtëpinë e parë të pavarur mediatike në Jugosllavi, FAMA International.**

"Ishte e lehtë për të vendosur, por rrethanat historike na shpërqendruan nga ajo që donim në fillim, të bëheshim një shtëpi e madhe mediatike e pavarur në kohë paqeje."

Punën e mëtejshme të kësaj shtëpie mediatike, të udhëhequr nga Suada, e përcakttoi fillimi i luftës, veçanërisht rrethimi i Sarajevës. Në fillim të rrethimit, Suada iku nga banesa e saj në Grbavicë, duke u bërë refugjate në qytetin e saj për katër vitet e ardhshme.

"Ekipi i FAMA-s ndoqi proceset e hyrjes në luftë dhe shkatërrimin katërvjeçar të Sarajevës: zhdukjen e një qytetërimi dhe krijimin e një të riut."

"Ne dëshmuam se si njerëzit luftuan kundër terrorist me kreativitet, pamë forcën e natyrës njerëzore, ndoqëm ndryshimet në marrëdhëni shoqërore në një qytet të rrethuar dhe gradualisht krijuam një Bankën e Dijes."

Pas përfundimit të luftës në vitin 1995, u krijuua Harta e Rrethimit të Sarajevës, e cila u ekspozua edhe në Bibliotekën Britanike në Londër si pjesë e eksposítës "Hartat që shënuan shekullin e 20-të" në vitin 2016. Është prezantuar në të gjithë botën, dhe është pjesë e një numri të madh enciklopedish botërore.

"Ne bëmë foto të shumta nëpër qytet për t'u shpjeguar të tjerëve në një vend kuptimin e qytetit të rrethuar. Kam ecur vetëm nëpër rrugë dhe zona të rezikshme dhe e dija se një hartë e "lëvizjes së sigurt" është e rëndësishme për ne."

Harta e rrethimit, së bashku me enciklopedinë e Rrethimit të Sarajevës (botuar në vitin 2000), u prezantua në Beograd në vitin 2005 në bashkëpunim me YIHR. Ngjarja u zhvillua me mbështetjen e aktivistëve dhe aktivisteve, si dhe të elitisë intelektuale nga Beogradhi, Sarajeva dhe Zagreb, të cilët folën së bashku për shpërbërjen e Jugosllavisë.

"U mahnita vërtet nga vendosmëria dhe strategjia e zgjuar, pa të cilën nuk do të ishte e mundur të bëhej numri tashmë

i madh i nismave, projekteve dhe sigurisht ndikimi në tema që ishin dhe janë me interes jetik për të gjithë rajonin", Suada përshkruan bashkëpunimi me Nismën e drejtuar atëherë nga Andrej Nosov.

Ekipi FAMA, i drejtuar nga Suada, në vitin 1996 regjistroi historinë e folur "Rrethimi i Sarajevës 1992-1996", i cili përbëhet nga intervista të regjistruara me qytetarë dhe qytetare të kryeqytetit të Bosnjë-Hercegovinës. Enciklopedia e përmendor bazohet në atë projekt, si dhe në harta, album të negociatave të Dejtonit, kronologji, libra komik, ilustrime dhe fotografie.

Bashkëpunimi me YIHR vazhdoi në projektin "Srebrenica, Harta e Gjenocidit" në vitin 2010. Përmes animacionit dokumentar, gjegjësisht 17 hartave të animuara, u shfaq gjenocidi në Srebrenicë, me qëllim që të edukohet opinioni i gjerë për këtë krim, veçanërisht të rinjtë. Autor i këtij projekti është Ekipi i FAMA-s dhe në realizimin e tij ka kontribuar ekipi i Nismës i udhëhequr nga Alma Mashiq.

"Përmes atij bashkëpunimi, në atë kohë tani të largët, me të rinj të guximshëm, të shpejtë dhe inteligjentë, ne morëm një platformë që ajo që bëjmë të ketë një përdorim edukativ, në mënyrë që të rinjtë në të gjithë rajonin të shohin, dëgjojnë, mendojnë dhe flasin për temat nga projektet tona".

"Një organizatë avangarde, prandaj më keni pëlqyer, prandaj ju besova plotësish dhe prandaj bashkëpunuam me ju".

Në vitin 2014, Ekipi i FAMA-s themeloi shoqatën FAMA Metodologjia, e cila merret me promovimin e arsimit, kulturës, shoqërisë civile dhe mediave në shoqërinë e luftës dhe të pasluftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në rajon. Suada është bashkëthemeluese e kësaj shoqate, si dhe anëtare e ekspit. Përmes punës së saj, ajo ende i është përkushtuar luftës kundër manipulimit politik të historisë në rajon.

## TË SHIKOSH, TË DISH, TË KUJTOSH


Fushata e mohimit të gjenocidit në Srebrenicë ende vazhdon. Në vitin 2005, aksioni i Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut „Të shikosh, të dish, të kujtosh”, gjatë të cilit në Beograd u shfaqën 36 bilborda me fotografi që përshkruan gjenocidin në Srebrenicë nga artisti sarajevas Tarik Samarah, tërroqi vëmendje të madhe të publikut në Serbi. Nga një bilbord u vendos edhe në Nish, Novi Sad dhe Çacak.

Aksioni u realizua me rastin e dhjetëvjetorit të gjenocidit të Srebrenicës dhe Nisma e të Rinjve gjatë këtij aksioni ishte objekt i sulmeve të grupeve dhe individëve nationalistë. Grupet nacionaliste të mirëorganizuara të bashkuara rreth „mbrojtjes së serbizmit” dëmtuan shumicën e bilbordave me bojë të zezë dhe shkruajtën mesazhe fashiste si „Thika, teli, Srebrenica”, „Do të përsëritet” e të ngjashme.

Pesë vjet më vonë, në vitin 2010, Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë miratoi një deklaratë që dënonon krimet në Srebrenicë. Edhe pse vetë deklarata i referohet vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës kundër Serbisë, në të nuk përdoret fjala „gjenocid” si kualifikim i krimit. Shoqatat e qytetarëve dhe aktivistët/et luftuan pa u lodhur kundër mohimit institucional të kimeve dhe kjo luftë ende vazhdon.



# YIHR-A ËSHTË DRITË NË ERRËSIRËN E KOMUNIKIMIT NË RAJON



**Gazetarja hulumtuese kosovare Jeta Xharra nuk ka mbajtur ndonjëherë ndonjë pozitë në YIHR, por i ka qëndruar afër që nga fillimi deri tash.**

**Dy dekada pas themelimit të organizatës, Xharra thotë se ka marrë pjesë në shumë aktivitete që i kanë organizuar të rinjtë e mbledhur brenda kësaj organizate pasi ka parë në ta shpirtin energjik e rinor për t'i ndryshuar gjërat.**

"Që nga themelimi i YIHR-ës kam qenë e involvuar ose si aktiviste, ose paneliste, ose si moderatore", thotë Jeta Xharra, që drejtton për më shumë se 15 vjet zyrën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) në Kosovë.

Arsyeja për këtë angazhim është avokimi që të rinjtë nga vendet që vite më parë kishin kaluar nëpër një periudhë konflikti të armatosur, të vendosin ura bashkëpunimi e komunikimi.

"Shumë pak bashkëpunim ka pasur mes të rinjve shqiptarë e serbë kur filloi punën YIHR-a dhe kjo vazhdon të jetë ashtu. YIHR-a që nga fillimi ishte drita në këtë errësirë që organizonte programe të shkëmbimit të përvojave sidomos mes Kosovës e Serbisë, gjë që është shumë me rëndësi", thotë ajo.

"Askush, as sot, as atëherë, nuk organizon vizita të të rinjve shqiptarë në Beograd dhe anasjelltas, vizita të të rinjve serbë në Prishtinë. Andaj, ky organizim sidomos mbetet i pazëvendësueshëm sepse i thyen paragjykimet dhe i shtyn njerëzit të shkojnë në një ambient të cilin gjithë jetën e kanë të mësuar si armiqësor nga shkolla, familja, politika dhe mediat", shton ajo.

Xharra thotë se është vlerë e madhe që të arrish t'ia thyesh paragjykimet njerëzve me programe të tillë siç bën YIHR-a.

Asaj i kujtohet një hulumtim që e kishte bërë YIHR-a në monitorimin e gjuhës së mediave në Serbi në të cilin i patën identifikuar mediat në Serbi që ende e përdorin termin derogativ "shiptari" për shqiptarët.

"YIHR-a është e rëndësishme në kontekstin e organizmit të paradës LGBTI+ në Kosovë, gjë për të cilën gjithmonë duhet shumë guxim. Raporti tjetër më i guximshmi

që e ka bërë YIHR-a në Kosovë është "State of Constriction: Governance and Free Expression in Kosovo" (Tcurrja e Hapësirës Publike: Qeverisja dhe Liria e Shprehjes në Kosovë) – ky raport i listoi në mënyrë detajiste të gjitha ndikimet e dëmshme në mediat në Kosovë, presionin që e përjetojnë edhe mediat por edhe kallxuesit dhe me këtë si limitohet hapësira për liri të shprehjes në Kosovë", thotë ajo.

Në aspektin personal, Jeta Xharra thotë se YIHR-a i ka mundësuar të bëjë miq të mirë të cilët i qëndrojnë dhe u qëndron afër edhe sot.

Por në aspekt më të gjërë, ajo shpjegon se organizata ka arritur të ndikojë në avokimin për të drejtat e njeriut.

"Ka ndikuar shumë pozitivisht sepse tash të drejtat e njeriut janë pjesë e perspektivës time në gjithë temat që i bëj, ja duke e përmendor edhe hulumtimin e fundit që e kam bërë për diskriminimin e grave brenda televizionit publik", thotë ajo.

Në përgjithësi, Xharra thotë se YIHR-a i ka bërë njerëzit, e sidomos gjeneratat më të reja, më mendjehapur.

"YIHR-a është e domosdoshme për shoqëritë post-konfliktuale si ato të Ballkanit Përendimor", përfundon Jeta Xharra.

MILICA MILIQ

# NISMA ËSHTË NJË FAMILJE – E DONI EDHE KUR TË MËRZIT, DHE KUR NUK JE DAKORD, DHE MBI TË GJITHA SEPSE NDIEN SIGURI



Milica Miliq

koordinatore e lëvizjes "Nisma ime", YIHR Serbi 2005-2008, në vitin 2016-2018, Kryetare e Bordit të Drejtoreve të YIHR. Aktualisht punon si producente e pavarur.

**Kur iu bashkua Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në vitin 2005, Milica Miliq ishte 20 vjeçë dhe kishte shumë entuziazëm dhe besim se një organizatë si Nisma nuk do të kishte nevojë të ekzistonte për një kohë të gjatë; ajo besonte se Nisma vërtet do të "ndryshonte gjithçka". Në atë moment, Nisma është një organizatë e re, Ratko Mlladiq akuzohej për krimet lufte, i arratisur dhe hero kombëtar.**

Sot, kur Nisma mbush 20 vjet, Milica është në të dyzetat, Ratko Mlladiq është një kriminel lufte i dënuar me burgim të përfshirë. Ai është ende hero kombëtar.

"Besoja se errësirën e përgjithshme shoqërore të nacionalizmit, mohimit apo glorifikimit të krimave, urrejtjes dhe intolerancës, tensioneve ndëretnikë do t'i thyenim, sepse ne jemi brezi i ri dhe më në fund e ndërpërmë praktikën e heshtjes, ofrojmë njohuri që është bazuar në fakte dhe tanë këto njohuri janë të disponueshme për të gjithë dhe besoja se nuk do të kishte më nevojë ta bëjmë atë punë sepse gjërat do të ndryshonin, natyrshëm. Ne e dimë që kjo nuk ndodhi. Gjërat po ndryshojnë ngadalë dhe në mënyrë të pamjaftueshme, por procesi është i pandalshëm".

Milica ishte pjesëmarrëse e gjeneratës së parë të programit të Rrjetit të Avokatëve të Drejtësisë, i cili, siç thotë ajo, ishte revolucionar në vitin 2005. Ai përfshinte edukimin e bashkëmoshatarëve mbi krimet e luftës, që kanë të bëjnë me të kaluarën, drejtësinë tranzicionale dhe leksione mbi punën e Tribunalit të Hagës. Programi përfshinte dhjetë pjesëmarrës/ë të përzgjedhur/a, të cilët në vitet në vijim organizuan dhe zhvilluan punëtori edukative me të rinxitë mbi këto, atëherë fjalë për fjali "tabu" tema.

Në tre vitet e ardhshme, 2005-2008, Milica punoi në një program kushtuar të rinxive – ajo i mësoi ata për ballafaqimin me të kaluarën, i edukoi për të drejtat e njeriut dhe mori pjesë në zhvillimin e rrjetit aktivist "Nisma Ime".

"Nisma pati një efekt të madh formues tek unë, puna në organizatë më solli njohuri, aftësi, kontakte, vetëbesim dhe krijoj një bazë përrugën time të mëtejshme profesionale, vuri themelin e sistemit tim të vlerave dhe profilizozi tema sociale që janë thelbësore për mua dhe sot. Për mua, Nisma nuk është ndonjë punëdhënës, vend, organizatë ku kam punuar, por çështje identiteti, ajo ekziston sepse n'e bëjmë atë, në të njëjtën mënyrë që na përcakton ajo neve, atëherë dhe tanë. Di vetëm që nuk kam këtë lloj mendimi dhe ndjesie për asnjë organizatë tjeter ku kam punuar".

Milica mori pjesë në fushatën për shënimin e dhjetëvjetorit të gjenocidit në Srebrenicë – TË shikosh, të dish, të kujtosh, në vitin 2005. Në atë kohë, Nisma vendosi fotografi që dokumentojnë gjenocidin e Srebrenicës nga autorë Tarik Samarach në billborde në lokacione në qendër të Beogradit. Pas disa orësh, të gjitha billbordet u shkatërruan, ndërsa fotografitë dhe mesazhet u zhgaravitën me llak makinash.

"Në atë moment, billbordet në qendër të Beogradit ishin njohja më e zhurmshme e gjenocidit në Srebrenicë. Në atë

kohë Nisma pati një jehonë të madhe në opinion, përmua personalist ishte një akt guximi dhe vendosmërie. Gjithashtu, Nisma organizoi një udhëtim në Potoçare më 11 korrik, kur unë isha atje për herë të parë. Ajo përvjë më ndryshoi jetën."

Ndër fushatat e tjera në të cilat ka marrë pjesë, ajo veçon fushatën e GOTV "Të rendësishëm jemi Ne", e cila lançoi rrjetin aktivist "Nisma Ime". Ekziston edhe festivali "Ditët e Sarajevës" në Beograd – Nisma e parë e madhe që doli nga korniza e punës së organizatës në atë kohë. Festivali i artit, në disa lokale, koncerte, eksposita, debate, mbrëmje.

"Ishte puna më sfiduese që kam punuar ndonjëherë. Festivali është tepër i rendësishëm emocionalisht përmua, kur e organizuam për herë të parë, thamë se do të bënim "Ditët e Sarajevës" në Beograd, derisa ndodhi që koncerti i një grupi nga Sarajevo u bë një ngjarje kryesore në Beograd, derisa ndonjë teatër të ftojë një shfaqje Sartri ose Teatri i Dhomës si pjesë e paraqitjeve të rregullta të ftuara. Sot është një gjë krejt normale dhe nuk ka më nevojë që në Beograd të ekzistojnë "Ditët e Sarajevës". Festivali "Mirdita, dobar dan" është synimi i radhës – që të mos ketë më nevojë që Nisma ta organizojë. Dua të besoj se edhe ky festival do të shuhet sa jemi gjallë".

Pas vitit 2008 u largua nga Nisma dhe vendosi t'i përkushtohej fakultetit dhe në vitin 2009 pranoi ftesën e Andrej Nosov për të ndërtuar së bashku një organizatë të re – Fondin Heartefact.

"Kemi krijuar një produksion teatror të pavarur, me idenë për të krijuar një hapësirë unike kulturore rajonale përmes punës së një organizatë të re, në një kohë që dukej pothuajse si çmenduri, tek, një dështim i garantuar. Puna në Heartefact, përmua, ishte një vazhdim i natyrshëm i punës që bëra në Nismë. Thelbi ishte gjithmonë i njëjtë, por fokus i ishte i ndryshëm".

Në vitin 2017, Milica u zhvendos me familjen e saj në Holandë, ku punon si producente e pavarur. Ajo ka bashkëpunuar me festivat e filmit "Eastern Neighbors Film Festival", "Movies That Matter", festivalin e filmit të angazhuar të organizatës Human Rights Watch dhe "International Documentary Film Festival Amsterdam – IDFA".

"Nisma hodhi themelët përmua në çdo kuptim. Gjatë gati 20 viteve të angazhimit tim profesional, kam zgjedhur gjithmonë organizata dhe punë që kanë kuptim përmua, që janë të rendësishme, që trajtojnë problemet dhe çështjet nga marginja sociale".

**MIROSLAV JANKOVIQ**

# NISMA ËSHTË KËTU NË DITË TË PASIGURTA



Miroslav Jankoviq

studues i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe koordinator i programit të të drejtave të njeriut, YIHR Serbi, 2003-2007, tanë këshilltar ligjor në Departamentin për media të Misionit të OSBE-së në Serbi.

**Në fund të vitit 2003, Miroslav u gjend në një lloj udhëkryqi: nga njëra anë, ishte një ofertë për të filluar karrierën e avokatit, dhe nga ana tjetër, puna për të cilën aplikoi në Nismë. Kur mori vesh se ishte pranuar në pozitën e studiuesit të shkeljeve të të drejtave të njeriut, nuk pati dilemë veçse të bëhej pjesë e YIHR-ës. Një vit më vonë, Miroslavi kaloi në pozicionin e koordinatorit të programit për të drejtave të njeriut.**

"Ishte një periudhë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe e vrullshme për sektorin civil në Serbi. Nisma ishte në ballë të asaj vale pasi kishim një ekip të përsosur që zotëronte njoħuri, vullnet, energji dhe integritet për t'u marrë me tema komplekse dhe të vështira siç janë të drejtat e njeriut dhe ballafaqimi me të kaluarën."

Edhe pse e përkruan atmosferën në ekip si të përsosur, sfidat para tyre ishin të mëdha dhe kërkuese. Në atë kohë, bashkëpunimi mes sektorit joqeveritar dhe shtetit "pothuajse nuk ekzistonte" dhe nuk ishte e lehtë të arriheshin ndryshime në një mëdisë të tillë.

"Ndonjëherë më duket se arritjet tona ishin më të mëdha se sa ishte e mundur".

Miroslavi është veçanërisht krenar që ka marrë pjesë në hapjen e zyrave të Nismës në Podgoricë dhe në Prishtinë, dhe që ka qenë në një ekip që ka trajnuar të tjerët për dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe shkrimin e raporteve.

Një nga temat e para me të cilat është marrë ishte zbatimi i Ligjit për qasje të lirë në informacione publike në Serbi.

"Kemi bërë një hulumtim të gjerë, kemi testuar transparencën e institucioneve dhe kemi shkruar reportin e parë në historinë e Serbisë për zbatimin e atij ligji jashtëzakonisht të rëndësishëm për një shoqëri demokratike në tranzicion."

U bë edhe takimi me Komisionerin e parë për informacione me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënavë personale, Rodolub Shabiqin.

"Arrita ime më e madhe është padyshim ndihma dhe mbështetja që u kemi dhënë shumë njerëzve të thjeshtë të cilëve shteti u ka shkelur të drejtat e njeriut dhe të cilët as deklarativisht nuk kujdeseshin për ta në atë kohë, siç ishte rasti i Zhivota Millanovicit nga Jagodina".

Gjegjësisht, Zhivota Millanovic, si udhëheqës i organizatës fetare "Hare Krishna" në Serbi, ishte viktimitë e sulmeve të shumta, dhe disa herë ishte shpuar me thikë. Nisma e mbështeti Millanovicin dhe së bashku ngritën kallëzime penale. Drejtësia erdhë në formën e një vendimi nga

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg në vitin 2010, e cila qëndroi në anën e Millanovicit.

Miroslavi veçon edhe rastin në vitin 2005 kur ata i kërkuan Agjencisë së Sigurisë dhe Inteligjencës t'u jepte atyre numrin e personave të përgjuar në Serbi gjatë të njëjtë vitit. Meqenëse BIA (ASI) nuk e bëri një gjë të tillë dëshmi pasi ishin shtuar të gjitha mjetet juridike, kjo çështje përfundoi edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Gjykata vendosi në favor të Nismës në vitin 2013, e cila përfaqëson "një udhërrëfyes drejt një transparence më të madhe dhe disa standardeve të reja në punën e BIA-s".

"Ne kishim një interesim të madh mediatik dhe publik për atë rast, të cilin ditëm ta kthejmë në avantazhin tonë. Një fitore e pabesueshme e një grupi të vogël të rinjsh kundër një strukturë kaq të madhe dhe të fuqishme".

Ai nuk është më pjesë e Nismës që nga nëntori i vitit 2007 kur kaloi në Misionin e OSBE-së në Serbi, ku punon edhe sot. Mirëpo, punën e tij në Nismë ai e cilëson si pikë kthuese, sepse aty mori njoħuri që i përdor edhe sot në punën e tij.

"Ajo luftë nuk është e lehtë dëshmi shoh si një maratonë që po vrapoj edhe sot me të njëjtin entuziazëm dëshmi me parimet që m'i ka rrënjosur Nisma ime".

Shton se puna në këtë organizatë i ka mësuar etikën e punës, rëndësinë e integritetit, rëndësinë e fakteve, pragnjithqka që është parakusht për zhvillim personal dhe profesional.

"Kur mendoj për Nismën, që ndodh shpesh, e shoh veten me pallton që më blenë prindërit një ditë para se të fillojnë tē punoja në atë organizatë. Dhe kjo pallto është një metaforë dëshmi emruesi i përbashkët i Nismës sime dëshmi prindërvë të mi. Të dyja i mbaj dhe i ruaj në vete edhe sot, dëshmi për to më ngroh në ditë të ftohta dëshmi pasigurta, ashtu si ajo palltoja e asaj kohe".

VLLADIMIR MILLOVANOVIQ

# NISMA ËSHTË NJË PËRPJEKJE E VAZHDUESHME PËR NJË SHOQËRI MË TË MIRË DHE MË TË DREJTË



Vlladimir Milovanovic

koordinator projektit dhe drejtor kreativ i fushatës "Të rendësishëm jemi ne" 2005-2008, YIHR Serbi, tani drejtor dhe themelues i kompanisë së produksionit "Propaganda Film".

**Në kohën kur Vlladimiri iu bashkua Nismës në vitin 2005, shoqëria në Serbi po i drejtohej gjithnjë e më shumë vlerave dhe ideologjive konservatore pas reformave. Ishte periudha pas vrasjes së kryeministrit Zoran Gjingjiq.**

"Në të njëjtën kohë, shoqëritë e traumatizuara nga lufta në rajon po shëroheshin nga konfliktet e përgjakshme dhe dukej se gjeneratat e reja në vendet e ish-Jugosllavisë kishin potencialin të distancoheshin nga politika nacionaliste e vendeve të tyre.

Vlladimiri thotë se "barërat e këqija të dhunës në të cilat jetojmë sot" u mbollën në vitet nëntëdhjetë, por lulëzuan në periudhën 2004-2008.

Duke punuar në Nismë, ai mësoi shumë për kronologjinë e konflikteve të luftës në vendet ish-Jugosllavisë, si dhe për detajet e krimeve. Ai e cilëson punën e Nismës si një "përpjekje konsistente, këmbëngulëse dhe etike pa kompromis për ta bërë shoqërinë tonë një vend më të mirë dhe më të drejtë për jetën e të gjithë qytetarëve".

"YIHR-a ishte një organizatë e vogël atëherë, por me disa njerëz të shkëlqye. Ishte një hub interesant njerëzish dhe idesh që, sipas standardeve të OJQ-ve, prodhonin përmbytje mjaft avangarde në atë kohë."

Ai thelloi njohuritë e tij në fushën e drejtësisë tranzicionale duke punuar me viktimat, duke ndjekur gjyqet për krimet lufte dhe duke hulumtuar dokumentacionin në dispozicion. Të gjitha ato prova dëshmonin për rolin e elitave kombëtare "në frymëzimin e luftëra të viteve të nëntëdhjetë", si dhe për rolin e strukturave shtetërore dhe parashtetërore në organizimin dhe kryerjen e krimeve kundër popullatës civile.

Vlladimiri e filloi punën e tij në Nismë si koordinator projekti, dhe përfundoi si drejtor kreativ i fushatës "Të rendësishëm jemi ne", të cilën e cilëson edhe si projektin e tij të preferuar. Fushata e lartpërmendor Get out the vote, GOTV, e vitit 2008 kishte për qëllim të animonte të rinjtë për të votuar në zgjedhje.

"Ishte një nga fushatat e para të GOTV-së në internet në vendin tonë dhe në botë, e cila, duke përdorur teknologji dhe forma të reja aktivizimi, synonte popullatën e re në vend.

Pas largimit nga Nisma, Vlladimir vendosi të tjerhiqej nga sektori joqeveritar.

"Në të njëjtën kohë, ka pasur shumë gabime nga ana jonë, në radhë të parë në komunikim dhe taktkë gjatë përcjelljes së fakteve dhe provave lidhur me krimet e luftës dhe rolin e strukturave zyrtare dhe individëve në to.

Tani ai ka kohë që është joqeveritar, por i duket se problemi kryesor atëherë, ndoshta edhe tani, është financimi i projekteve dhe menaxhimi i aktiviteteve burokratike, thaujse korporative.

"Nga njëra anë është e nevojshme të drejtohet një organizatë e madhe, por në atë standardizim të procedurave nga aplikimi deri në zbatimin e projektit, kishte një hendek të madh mes realitetit në terren dhe atij që ishte përshtaktim i projektit.

Vlladimiri beson se një problem tjeter është se nuk iu kushtua vëmendje e mjafueshme shëndetit mendor si të viktimate ashtu edhe të aktivistëve dhe aktivisteve të sektorit të OJQ-ve, të cilët ishin në kontakt të përditshëm me histori traumatiqe – qoftë përmes intervistave me viktimat, përmes dokumentacionit apo gjyqeve për krimet e luftës.

"Shpresoj që gjërat të kenë ndryshuar ndërkokë, sepse të gjithë ata që punojnë me viktima dhe trauma do të duhet t'i nënshtronen trajnimeve të veçanta psikologjike, por edhe vetë të marrin një formë adekuate të mbështetjes terapeutike."

Pas sektorit të OJQ-ve, Vlladimiri zgjodhi filmin si mjet komunikimi, kështu që studimet master për regji filmi dhe televizioni i kreua në Fakultetin e Arteve Dramatike në Beograd.

"Unë gjithmonë i kam mbrojtur dhe do t'i promovojo ato vlera përmes punës dhe sjelljes sime.

**EDINA HASANAGA ÇOBAJ**

# NISMA ËSHTË NJË PLATFORMË PËR PJESËMARRJE AKTIVE NË SHOQËRI



**Edina Hasanaga Çobaj**

drejtore ekzekutive e zyrës 2006-2020, tani anëtare e Bordit të Drejtorëve, YIHR Mali i Zi.

**Që gjatë studimeve Edina u interesua për aktivizmin dhe aktivitetet e sektorit joqeveritar. Para se t'i bashkohej Nismës, ajo ka punuar si mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale dhe ka qenë trajnere e komunikimit pa dhunë.**

Kur YIHR u themelua në Mal të Zi në vitin 2006, atëherë Edina njëzet e gjashtë vjeçare aplikoi për pozitën e koordinatores së zyrës. Në të njëtin vit, ajo u zgjodh dhe qëndroi në atë detyrë deri në vitin 2020.

Nevoja për themelimin e YIHR-së u imponua nga konteksti social i asaj periudhe: krimet e luftës të pahetuara dhe të paprocedura, diskriminimi ndaj pakicave dhe grupeve vulnerabël, dhuna e motivuar politikisht, sulmet ndaj gazetarëve dhe gazetareve. Përveç kësaj, Mali i Zi e rifitoi pavarësinë në të njëtin vit dhe pati optimizëm se në vrullin e frymës pro-evropiane, të drejtat e njeriut do të ishin në krye të axhendës, kujton Edina.

"Megjithatë, praktika ka treguar se duhet shumë përpjekje, punë dhe angazhim për të përkthyer mesazhet verbale pro-evropiane në rezultate të prekshme dhe standarde të vendosura nga vendet që janë të larta në shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut".

Puna e YIHR-së në Mal të Zi ishte shumë e vështirë në fillim. Në atë kohë, institucionet shtetërore nuk e kuptionin plotësisht rolin e sektorit joqeveritar, thotë Edina. Megjithatë, asnjë nga këto nuk i pengoi aktivistët dhe aktivitetet e Nismës që të monitorojnë shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të ofrojnë ndihmë juridike falas për të gjithë ata që kishin nevojë.

"Fatmirësish, me veprimin e YIHR-së, ajo pamje sot ka ndryshuar dhe situata është shumë më ndryshe, kështu që sektori i OJQ-ve njihet si partner në zgjidhjen e anomalive të shumta sociale dhe institucionale.

Edina thotë se me kalimin e kohës Nisma është bërë pjesë e identitetit të saj. Duke udhëhequr YIHR-në, ajo pati mundësinë të përfshihej në proceset vendimmarrëse si grua në një shoqëri patriarchale.

"Ishte një hapësirë e re ku unë, si grua në Malin e Zi tradicional, edhe nga një komb pakicë, i cili tradicionalisht diskriminohet dhe nuk pranohet, mund të merrja mundësinë të marr pjesë në proceset vendimmarrëse, të tregojë njohuritë e mia, të jem e nderuar, të drejtoj

një organizatë joqeveritare dhe përmes kësaj mënyre të kontribuoj në ndryshimin e shoqërisë për të mirë për të gjithë qytetarët e saj, veçanërisht grupet vulnerabël".

Gjatë gjithë viteve të punës në Nismë, Edina nisi aksione, nisma dhe fushata të shumta. Megjithatë, si "kurorë" të veprës, ai vë në pah krijimin e Qendrës së Informacionit dhe Dokumentacionit si arkivi i vetëm në Mal të Zi për krimet e luftës të kryera në vitet 1990.

"Rëndësia e saj reflektohet në edukimin e një numri të madh studentësh të shkencave juridike dhe politike si pushtetarët e ardhshëm."

Në nivel rajonal, ajo veçon si projektet më mbresëlënëse ato që synon shkëmbimin e të rinjve, duke kontribuar në thyerjen e paragjykimeve dhe stereotipeve.

"Dëshiroj gjithashtu të theksoj se ne ishim ndër të parët që prezantuan opzionin që uebfaqja jonë të jetë në tre gjuhë, në mënyrë që të respektojmë popujt pakicë dhe të kontribuojmë në ruajtjen e identitetit të tyre.

Sot, vite pas themelimit të Nismës, grupet minoritare janë në pozitë më të mirë, janë më të dukshme dhe në këto ndryshime ka kontribuar puna e palodhshme e aktivistëve dhe aktivisteve të Nismës, thotë Edina. Gjithashtu, raporte të ndryshme të Nismës janë cituar rregullisht nga organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja.

"Megjithatë, ajo që nuk ka ndryshuar është ajo flaka nacionaliste e viteve të nëntëdhjetë, e cila nuk është shuar kurrë plotësisht dhe që vetëm ndryshon intensitetin e djegjes në shoqëri.

Nisma mbetet një organizatë ku të gjithë luftëtaret dhe luftëtarët e vërtetë për të drejtat e njeriut mund të gjejnë hapësirën e tyre për veprim.

"Puna në Nismë përfaqëson një përvojë të pasur jetësore të mbushur me shumë momente të bukura, plot ngjyra, sfida të përditshme dhe besimin se përmes veprimeve tona kontribuojmë për ta bërë jetën e dikujt pak më të mirë.

# YIHR-A REFLEKTON, ADAPTOHET E PËRGJIGJET NDAJ DINAMIKAVE TË REJA POLITIKE



**Ishët vera e vitit 2006 kur një vajzë nga Prishtina, Besa Luci, sapo kishte përfunduar studimet në Shkenca Politike dhe Gazetari në Universitetin Amerikan në Bullgari dhe po bëhej gati për studimet master, këtë herë në Universitetin e Missouri-t në SHBA.**

Në atë kohë, në Vjenë po zhvilloheshin bisedimet Kosovë-Serbi për statusin e Kosovës, i cili do shënonte fundin e administrimit ndërkombëtar të vendit dhe Besa u angazhua në mbulimin mediistik të këtyre bisedimeve, krasas punës së njëjtë që bënин kolegët e saj në Beograd të mediave në Serbi.

"Për shkak të prapavijës akademike time dhe interesimit për ta kuptuar në praktikë se si narrativat gazetareske ndikojnë në formësimin e perceptimeve dhe njohurive më të gjera shoqërore, e vlerësova si një mundësi të mirë profesionale angazhimin në YIHR, e cila njihej si një ndër organizatat më të besueshme në fushën e të drejtave të njeriut", kujton Besa Luci 17 vjet më pas.

Më vonë ajo do të kthehej sërisht në organizatë në vitet 2009-2010 si bashkëpunëtore e kohëpaskohshme ndërsa gjatë viteve 2010-2020 ishte pjesë e Kuvendit dhe Bordit të YIHR-së.

Shumë vite kanë kaluar dhe Besa Luci tani mendon se YIHR-a ka shërbyer në një kohë kur ballafaqimi me të kaluarën nuk ishte trajtuar si pjesë përbërëse e bisedimeve midis Kosovës e Serbisë, ose të paktën, në një kohë kur ballafaqimi me të kaluarën nuk ka përfshirë qytetarët e të dy vendeve.

Por pavarësisht viteve që kanë ecur, gjërat nuk është se kanë avancuar me kalimin e tyre.

"YIHR-a vazhdon të funksionojë në një kontekst të ngashëm edhe sot, sepse bisedimet, tash të njohura si negociata, vazhdojnë të mos jenë mjaftueshëm të vëmendshme ndaj përvojave të njerëzve, rrëfimeve të tyre dhe mënyrave të tyre për t'u ballafaquar me të kaluarën", thotë Besa Luci.

"Duke qenë për një kohë të gjatë e në një kohë të rëndësishme një organizatë që ka mbledhur të rinjtë dhe të rejet nga Kosova e Serbia në hapësira të barabarta për ta njohur njëri-tjetrin, për të diskutuar e për t'u solidarizuar me njëri-tjetrin në kauza të të drejtave të njeriut, YIHR-a ka kontribuar në një klimë bashkëpunimi rajonal, që asokohe ka qenë aq e rëndësishme sa e rrallë", shton ajo.

Nga përvaja që ka fituar me YIHR-ën, Luci thotë se e ka kuptuar në nivel edhe më përbajtësor se sa e

rëndësishme është të shikohet me sy kritik se si kujtohet e kaluara, kush kujtohet dhe se si vetë mënyra se si ndërtohet kujtesa duhet parë me sy kritik.

"Kur flasim qoftë për demokraci, për paqe, apo për drejtësi – nuk mund t'i trajtojmë si procese që udhëhiqen e përcaktohen vetëm nga klasat politike. Në këto procese qenësore janë dokumentimi dhe artikulimi i përjetimeve të njerëzve dhe i asaj se si ato përjetime ndërlidhen me kujtesën kolektive", thotë Besa Luci.

"Mendoj që YIHR-a ka ngritur vazhdimisht pyetje të rëndësishme rrith asaj se kush dëgjohet, cilat përvaja ia dalin të janë në sipërfaqe e cilat janë shtypur – dhe këto pyetje janë të domosdoshme", shton ajo.

Këto reflektime dhe praktikën e vënies në pikëpyetje të asaj se sa gjithëpërfshirëse e të hapura janë këto procese ajo thotë ta ketë përfshirë dhe përpinqet ta përfshijë çdo ditë në punën e saj aktuale si kryeredaktore në KOSOVO 2.0.

"Ndonëse shumëçka ka ndërruar prej atëherë, edhe sot të drejtat e njeriut vazhdojnë të janë të cenueshme e të cenuara. Prandaj, nevojitet të jemi edhe kritik edhe të vëmendshëm që t'i mbrojmë ato, ashtu që të vërtetat e njerëzve të mos shtypen e të mos mbeten në hije, sidomos në një kontekst të luftërave në rajon, ku zakonisht rrezikojnë të mbizotërojnë zërat e atyre që përcajnë e që refuzojnë të marrin përgjegjësitë që u takojnë", thotë Luci.

Pavarësisht se ka qenë e angazhuar në YIHR kryesisht si bashkëpunëtore e jashtme për periudha më afatshkurtëra, Besa Luci thotë se YIHR-a për të gjithmonë do të mbetet një ndër mundësitë e para për të vënë në praktikë dijen e marrë gjatë studimeve, por edhe një ndër vendet e para, ku i ishte besuar një projekt me peshë të madhe, në një kontekst të ndjeshëm politik.

"YIHR-a është një nismë që qëndron besnikë ndaj përkushtimit për të mbrojtur e promovuar të drejtat e njeriut; që vë në pah rëndësinë e ballafaqimit me të kaluarën si proces qenësor i paqes; dhe që vazhdimisht reflekton, adaptohet e përgjigjet ndaj dinamikave të reja politike e atyre të pushtetit", thotë ajo.

## **PREMTIMET E ZBRAZËTA JANË REKLAMA MË E MIRE**

Më 1 tetor 2010, aktivistët dhe aktivistet e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut të Bosnjës dhe Hercegovinës, së bashku me aktivistët/et e „Zeros së mprehtë“ nga Banjalluka, organizuan një aksion parazgjedhor në rrugë në Sarajevë dhe Banjallukë me mesazhin „Premtimet e zbrazëta janë reklama më e mirë“. Qëllimet e kësaj fushate parazgjedhore ishin t'i kujtonin qytetarëve/eve premtimet zbrazëta të dhëna nga politikanët/et në zgjedhjet e vittit 2006. Aktivistët/et me bluza me mbishkrimet „Premtimet e zbrazëta janë reklama më e mirë“ dhe „3 Tetori MENDO!“, u shpërndanë kalimtarëve/eve pako bosh. Në paketa shkruhej: „Shëndetësia më e mirë“, „Regjim pa viza“, „Më shumë vende pune dhe punësim të të rinjve“, „Reforma në arsim“, „Standarde evropiane të arsimit të lartë“.


Aktivistët/et u lidhën me një zinxhir dhe, me tingujt e bilbilave, ecën nga Katedralja e Sarajevës deri në qendrën e biznesit BBI me bluza me mbishkrimet: „Mos u tall, VOTO“, „Zëri im, rroga juaj“, „Kërkoi fjalën“, „Unë jam parlamentar, M'U PRISH PUNA“, „E ke të lehtë kur ke“.

Zinxhirët simbolizonin kufizimet ndaj të rinjve në Bosnje dhe Hercegovinë. Bashkëpunimi i të rinjve nga Sarajevo me të rinjtë nga Banja Lluka në këtë aksion tregoi se problemet e të rinjve janë të njëjtë në mbarë Bosnjën dhe Hercegovinën dhe se politikanët/et bëjnë pak për ta ndryshuar atë.



PREDRAG MAXHAREVIQ

# INICIJATIVA JE ORGANIZACIJA KOJA IZLAZI IZ KLIŠEA



Predrag Maxhareviq

koordinator i zyrës së YIHR-së në Kragujevc, koordinator i fushatës "Mobilizimi i Serbisë Qytetare", koordinator rajonal për mbledhjen e nënshkrimeve të nismës KOMRA, 2006-2011, YIHR Serbi, asistent regjisori dhe drejtor casting-u.

**Predragu fillimisht iu bashkua Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi në 2006. Më pas ai u kontaktua nga Ivan Stojanoviqi, i cili tashmë punonte në YIHR dhe të cilin e kujton që nga periudha e Rezistencës, ndryshimet e 5 tetorit dhe rrëzimi i Sllobodan Milosheviqit nga pushteti. Predragu nuk e kishte të panjohur angazhimin aktivist. I pyetur se si ishte klima socio-politike në ato vite, ai përgjigjet qartë:**  
**"Çfarë klime politike mund të ketë në një vend ku vritet kryeministri?"**

Andrej Nosov dhe i gjithë ekipi në atë kohë i pëlqyen shumë që në fillim – ata ishin të ndryshëm nga ai, por të gjithë kishin të njëjtin qëllim.

"E pashë Nismën si shumë më tepër sesa një organizatë që merret vetëm me të drejtat e njeriut".

Të guximshëm, të hapur ndaj një mendimi tjetër dhe plotësisht të gatshëm për të dalë nga klishetë që ishin të njohura në sektorin civil në atë kohë.

Në YIHR i pëlqente të merrej me logistikë, organizim, pra me ato "gjëra më konkrete". I pëlqenin fushatat, jo projektet.

Kur ai u bashkua për herë të parë Nismës, kjo organizatë hapte zyrat e saj në Kragujevc, Novi Sad dhe Zrenjanin me qëllim të decentralizimit dhe zgjerimit të aktiviteteve. Nëpërmjet aktiviteteve të këtyre "degëve" të Nismës, qindra të rinj morën pjesë në forume, leksione dhe fushata.

"Do të veçoja punën në zyrën në Kragujevc, ku kemi krijuar një bazë mjaft të mirë të të rinjve, të etur për t'u angazhuar socialisht, disa prej tyre kanë lënë gjurmë më të madhe në Nismë sesa unë."

Një nga segmentet më të rëndësishme të angazhimit të Predragut në YIHR është udhëheqja dhe organizimi i fushatës "Mobilizimi i Serbisë Qytetare" në dhjetor 2006 dhe janar 2007, e cila kishte për qëllim inkurajimin e të rinjve për të votuar.

"Ajo fushatë ishte diçka e re dhe ndryshe nga çdo gjë që ishte bërë më parë, ne kishim një karvan me DJ-a nëpër Serbi, me promovues nga sfera të ndryshme sociale dhe

në atë mënyrë tërhoqëm një numër të mirë të të rinjve për të dale në votime dhe për të votuar.

"Ne punuam si ekip dhe në çdo qytet ku ishim, reagimi i njerëzve ishte i madh".

Kur iu bashkua Nismës për herë të dytë në vitin 2011, Predragu ishte koordinator për mbledhjen e nënshkrimeve të fushatës për KOMRA. Fushatën e përmendur ai e përmend si sfidë të madhe, sidomos në aspektin logistik. Qëllimi ishte krijimi i një komisioni të pavarrur rajonal që do të vërtetonte faktet për krimet e luftës të kryera gjatë viteve të nëntëdhjetë. Me atë rast u mblohdën qindra mijëra nënshkrime.

"Kemi mundur ta përballojmë këtë, sepse organizata po zgjerohej dhe po punohej në të gjitha këto fushata, në një mënyrë të ndryshme nga organizatat e tjera.

Më vonë kaloi në Heartfact, një organizatë e themeluar nga Andrej Nosov. Aty, në vitin 2012, ai pati mundësinë të përmirësohej në aspektin e produksionit, duke punuar në shfaqje të reja dhe duke organizuar luajtje dhe shfaqje mysafire të atyre ekzistuese. Ky është një hap shumë i rëndësishëm në karrierën e Predragut, i cili e drejtoi më tej drejt produksionit të filmit televiziv, me të cilin është i angazhuar edhe sot.

# YIHR-A, MAKINË LËVIZËSE PËR TË DREJTAT E NJERIUT



**Besart Lumi sapo kishte regjistruar Fakultetin e Shkencave Politike në Prishtinë në vitin 2006 kur i ati i tij i ndjerë, gjithashtu aktivist i të drejtave të njeriut, i kishte treguar për një thirrje për "Visiting Program" që ftonte të rinjtë e Kosovës të bëheshin pjesë e këtij programi për të vizituar disa ditë Serbinë dhe për t'u takuar me të rinj serbë.**

Në atë kohë Lumin 18 vjeçar, fillimisht nuk e tërhoqte kjo thirrje, por i ati insiton që të aplikonte. Pasi kishte aplikuar dhe përzgjedhur për këtë program, ai kishte kaluar për herë të parë kufirin e Kosovës dhe kishte hyrë në Serbi në një moment të papërfytyrushëm për të deri atëherë. Ishte hera e parë që ai kishte kaluar kufirin për të hyrë në Serbi dhe kontakti i tij i parë me të rinj serbë.

Pasi kishte përfunduar programin, Besarti ishte kthyer në Kosovë dhe kishte filluar të merrte pjesë në aktivitete të tjera të YIHR-së kundër diskriminimit si vullnetar. Një vit më vonë, në qershor të vitit 2007, ai mori një ftesë për një punëtori në Ulqin, si pjesë e programit "Nisma ime" dhe u bë pjesë e programit.

Në atë kohë Kosova po zhvillonte negocitat në Vjenë për statusin dhe klima politike në vend ishte mbështjellë në pritet se çfarë do të rekomandonte i dërguari i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari. Ishte një kohë kur kishte më shumë shpresë dhe entuziazëm, një lloj pritje e njërrëzve se do të bëhet diçka, do të ketë shtet të pavur. Kishte gjithashtu një motiv më të madh për t'u thënë njërrëzve të dalin e të votojnë. Ka qenë një kohë e një pike kthuese ngase njërrëzit ishin duke pritur pavarësinë e vendit. Ai thotë se koha kur ai nisi të punonte me YIHR-ën ishte gjithashtu një kohë kur ishte më e matshme se çka është suksesi. "Nuk ishte gjithmonë mendimi për shtetndërtim, por më tepër për zhvillim si shoqëri, si vend".

Zgjedhjet e përgjithsme do të mbaheshin në nëntor dhe Lumi së bashku me të tjerët ideoi fushatën "Dil Voto".

Përderisa disa lëvizje opozitare bënin thirrje për bojkotim të zgjedhjeve, Lumi në fushatën për të dalë në votime mblodhi konfirmimin e të paktën 5 mijë qytetarëve.

"Dil voto" dhe "Nisma Ime", sipas tij, janë dy projekte të suksesshme të shoqërisë më të cilët ai më së shumti e identifikon veten dhe janë shpirti i aktivizimit në YIHR.

"E kemi pasë njëmend çkado që jemi munduar të bëjmë", thotë ai.

Që atëherë, duke përjashtuar vitet 2014-2016, ai është pjesë e YIHR-ës me role e detyra të ndryshme dhe është një ndër personat më jetëgjatë në organizatë.

Për Lumin, atë që e ka bërë YIHR-a në raport me të drejtat e njeriut ka qenë përpjekja për krijimin e urave të bashkëpunimit dhe komunikimit mes të rinjve të komuniteteve të ndryshme.

Ai thotë se YIHR-a ka krijuar ura të reja komunikimi dhe ka lehtesar ndërveprimin e të rinjve të dy vendeve që për një kohë të gjatë janë të bllokuara në ndarjet që u ka sjellë lufta.

Në mozaikun e një historie personale pas shumë viteve me YIHR-ën e së fundmi edhe si anëtar Bordi, Lumi thotë se YIHR-a e bëri më të hapur, ia zgjeroi dijen dhe e bëri më të vëtdijshëm për mëritë afatgjata që lufta lë te njerëzit.

Në kohën kur kemi punuar ne, jo shumë njerëz ishin të kyçur në aktivitete të tilla të promovimit të të drejtave të njeriut, paqes dhe pajtimit.

"Është një linjë e vazhdueshme komunikimi dhe një kënd ku gjithmonë sheh mundësi bashkëpunimi përtëj kufijve që të rrethojnë. Të bën të shohësh se kudo, në Kosovë, Serbi, Bosnjë, ka njërrëz që duan t'i shtyjnë përpara ndryshimet pozitive dhe të lënë pas barrën e armiqësive", thotë ai.

Lumi shprehet se forcat kundër bashkëpunimit në të gjitha vendet e rajonit kanë qenë gjithmonë më të fuqishme sësë forcat për bashkëpunim.

"Nëse flisni për bashkëpunim ose për viktimat, duke patur parasysh se hapësira për komunikim ngushtohet, shoqëria civile ka bërë ndryshime, por janë vërejtur pak. Njerëzit që kanë kaluar nëpër YIHR kanë qenë njërrëz te grumbulluar rrëth vlerave", thotë ai.

Gjatë viteve të veprimtarisë së vetë, Lumi thotë se YIHR-a ka sfiduar narativat nacionaliste e përcarëse dhe nuk është frikësuar që të ngrisë për debat temat e vështira.

"Mendoj që YIHR-a është një makinë lëvizëse që mbledh njerëz që promovojnë të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe që besojnë në ndryshim dhe janë të gatshëm për të punuar për ndryshim", përfundon ai.

**BARDH BAKIJA**

# YIHR-A, VLERË E SHTUAR PËR RAJONIN



**Bardh Bakija i është bashkuar YIHR-së në fund të vitit 2006, sa ishte student i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës. Ai u ftua të merrte pjesë në një nga aktivitetet e YIHR-ës dhe vazhdoi të jetë pjesë e organizatës. Në kohën kur u bashkua, kishte qenë një prej studentëve më të dalluar që braktisi studimet ngase nuk po ndihej "i përbushur" në atë lloj sistemi. "Isha më rebel dhe nuk mjaftohesha me ato që ofroheshin në atë kohë. YIHR-a për mua ishte ai kanali ku mundesha ta çoja përparrë atë energji të aktivizimit", kujton Bakija.**

Në atë kohë, Bakija shpjegon se Kosova ishte ende nën protektorat ndërkombëtar, në pritje të njës së negociatave për statusin final. "Kishte një lloj euforie e entuziazmi rinas se përshtypjen që po ecim në një drejtësi ku ne mund të kishim ndikim", thotë ai.

Ai e përshkruan atë kohë si një periudhë "idealizmi të hatashëm" që u jepte forcë për të ecur përparrë. "Ne identifikoheshim si një lloj lëvizje për progres".

Bakija u bë Koordinator i tij Rinjve në YIHR e pastaj Drejtor i Programit për të Rinjtë.

Bakija përmend disa aktivitete me rëndësi që filluan të jetësohen gjatë kohës sa ishte në YIHR e që përfshijnë programin "Ravelling to Europe" në vitin 2007, ku iu mundësua marra e vizave 30 studentëve që donin të udhëtonin për një muaj në vendet evropiane në një kohë kur Kosova ishte e izoluar dhe "Street activism", brenda të cilës ishin ideuar disa fushata kundër diskriminimit dhe për qasje në dokumente publike.

Ai flet për nismën "Nisma ime" si koncept i bërtës së një aktivizimi të drejtëpërdrejtë dhe një prej projekteve me të cilin ai e identifikon më shumë veten. "Ka qenë një prej përpjekjeve tonë për të ndërtuar një bazë të aktivizimit të rinjve, duke lëvizur kudo nëpër Kosovë për të nxitur të rinjtë që të angazhohen në jetën publike".

Bakija thotë se ajo që ka bërtë YIHR-a, për dallim nga organizatat e tjera, është një lloj ndërtimi i idealizmit "shumë të pastër" që krahasuar me tanë "mund të thuhet se ka një lloj cinizmi".

Në këndvështrimin e tij në YIHR ishte mbledhur një grup i tij Rinjve ndryshe. "Ishte një grup që dante të shkëputet nga një trashëgimi e së kaluarës, duke u përpjekur të ndërtojë një lloj shprese gati mesianike për një shoqëri që shkëputet nga e kaluara shkatërruese".

Nga perspektiva e tanishme, ai thotë se ishin "goxha radikalë dhe të guximshëm", në aksionet që bënin, dhe identifikoheshin si një lëvizje progresiste. Bakija thotë se janë përpjekur të ndërtojnë një intolerancë ndaj krimeve të luftës pavarësisht se ku kanë ndodhur ato.

"Kemi bërtë diçka që atëherë ka qenë e paimagjinueshme për shumë të tjerë. Kemi krijuar ura komunikimi e bashkëpunimi ndëretnik dhe një aktivizimi jo selektiv për të drejtat e njeriut", thotë ai.

Bakija thotë se në YIHR ishim një gjeneratë e të rinjve që po përpinqeshim të tërhiqnim të tjerët në jetën publike. "Këto themelë që ka hedhur YIHR-a dhe të qenit e një organizatë rajonale e kanë bërtë të mundur jetëgjatësinë e saj".

Ai thotë se YIHR-a ishte edhe hapësirë fizike jo vetëm në aspektin e të drejtave për të cilat avokon, por edhe si një vend ku jetësohen ide dhe dizajnohen aktivitete. "Ishte një hapësirë arti e quajtur Risoma ku mblidhë aktivistë, njerez që kanë dashur ta shohin veten aktivë dhe jepnini ide".

Vite pas, Bakija thotë se për të YIHR-a ka pasur një ndryshim rrënjesor. "Ka pasur organizata të tjera që kanë bërtë punë të mëdha por YIHR-a ka qenë një univers tjetër".

Ai ka kaluar dy vite intensive të punës me YIHR-ën dhe në aspektin personal thotë se kjo i ka dhënë atij një lloj kuptimi të ri përveten dhe i ka hapur horizonte në shumë aspekte.

"Në komunikimin ndëretnik edhe unë kam mësuar rrugës. Isha një fëmijë i luftës nga Gjakova, por nuk isha i përgatitur. YIHR-a ma ka dhënë një lloj adrenaline se për të çarë përparrë duhet të rezikosh dhe të ballafaqohesh me çfarëdo lloj pushteti", thotë ai.

Për të, YIHR-a është një model shumë i veçantë dhe i provuar i një shoqërie, një koekzistence mes popujve të rajonit, që mund të jetë një model në miniaturë se si shoqëritë mund të veprojnë përmes një sistemi të përbashkët të vlerave që nuk është në asnjë mënyrë i ndikuar nga ndonjë lloj orientimi.

"Kjo e identifikon YIHR-ën dhe e paraqet si një lloj vlerë të shtuar për rajonin", përfundon Bardh Bakija.

# NISMA ËSHTË URË QË BASHKON BREZAT



Nerma Jellaçiq

anëtare e Bordit të Drejtoreve, 2006-2007,  
YIHR Serbi, tani drejtoreshë e menaxhimit  
dhe marrëdhënieve me jashtë të Komisionit  
për Drejtësi Ndërkombëtare dhe Përgjegjësi.

**Në fillim të viteve 2000, Nerma shpesh udhëtonte në vendet e ish-Jugosllavisë si gazetare, kështu që ajo kaloi kohë edhe në Beograd. Andrey Nosov dhe ekipi gjithashtu punuan shumë në rajon, kështu që rrugët e tyre shpesh kryqëzoheshin. Nerma u zgjodh anëtare e Bordit Drejtues të Nismës në vitin 2006 pikërisht me ftesë të Andreyit. Në atë kohë, ajo ishte drejtoreshë e Rrjetit Ballkanik të Kërkimeve (BIRN) në Bosnje dhe Hercegovinë.**

"Ishte një kohë më pozitive kur dukej se ekzistonte mundësia për t'u ngritur sfidues kundër kriminelëve, mohuesve dhe ndihmësve të tyre dhe për të frymëzuar shumicën dërrmuese të të rinjve që ishin "të uritur" për dije.

Në të njëjtën kohë, gjykatat e brendshme dhe prokuroritë për krimë lufte u krijuan dhe u forcuan, u vendosën diskutime për forma të tjera të drejtësisë tranzicionale, kufijtë (emocionalë, jo fizikë) u hapën në një mënyrë, me njëfarë energjje që nuk e kemi parë që nga viti fundi i luftërave të viteve të nëntëdhjeta."

Megjithatë, sot nuk ka asnjë entuziazëm dhe optimizëm që ekzistonte në fillim të këtij mijëvjeçari në të gjithë rajonin e ish-Jugosllavisë, "sepse zërat e kleriko-nacionalizmit të mbështetur nga mediat e rreme dhe rrjetet sociale mbizotëruan zërin e arsyes, dashurisë dhe toleranca e dërguar nga organizata si YIHR-a."

Nerma thotë se YIHR ende sot jep një shembull për të rinjtë që vijnë nga shoqëritë konfliktuale dhe pas konfliktit, se është një urë që lidh brezat e rinj nga rajoni prej vitesh dhe "ofron një antidot për helmin në të cilin ata rriten", që përbëhet nga narrativa shtetërore që lidhen me luftërat e viteve të nëntëdhjeta dhe nacionalizmin.

"Në nivelin personal, YIHR-a është për mua një mozaik i njerëzve të rinj dhe të talentuar që punuan për themelimin e organizatës, me shumë prej të cilëve jam ende në kontakt, dhe sigurisht pas të cilëve mbetet trashëgimia e YIHR-së në formën e saj aktuale – një organizatë që nevojitet sot si 20 vjet më parë."

Nerma thotë se Nisma e të Rinjve ka bërë progres serioz në Bosnje dhe Hercegovinë, pavarësisht nëse ato janë

realizuar në nivel lokal apo rajonal, gjë që është arritur përmes projekteve të shumta si shkollat verore të drejtësisë tranzicionale, vizitat e të rinjve nga rajoni dhe vizitat në vendet e krimeve të luftës.

"Edhe pse situata në BeH si dhe në Serbi nuk mund të përshkruhet në një mënyrë positive, sepse shohim kthimin e mohimit, dehumanizimit dhe formave të tjera të mosdurimit, angazhimi i Nismës mbetet edhe më i rëndësishëm."

Nerma qëndroi në BIRN deri në vitin 2008, kur u zgjodh zëdhënëse e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Ajo qëndroi në atë pozicion deri në vitin 2014. Pas kësaj, ajo kaloi në Komisionin për Drejtësi dhe Përgjegjësi Ndërkombëtare, ku ende mban postin e drejtoreshës së menaxhmentit dhe marrëdhënieve me jashtë.

"Ne mbledhim prova në ato vende ku institucionet dhe organet hetuese ndërkombëtare dhe vendase nuk kanë akses ose ku reziku është shumë i lartë.

Sado që jemi të vetëdijshëm për kufizimet në të cilat funksionon drejtësia penale, për mua mbledhja e provave për atë që po ndodh dhe personat dhe institucionet që qëndrojnë pas krimit është një hap i domosdoshëm jo vetëm për ndjekjen penale para gjykatave, por edhe për konstatimin e gjendjes faktike dhe të drejtën për të vërtetën që kanë të gjithë qytetarët/et".

## FESTIVALI „DITËT E SARAJEVËS“

Festivali „Ditët e Sarajevës“ u organizua për herë të parë në vitin 2007, si përkujtim i 15-vjetorit të fillimit të rrethimit 44-mujor të Sarajevës, me qëllim të njohjes së popullatës së re me ngjarjet e përbashkëta të kohëve të fundit, të kaluarën dhe me rrjedhat aktuale kulturore dhe sociale në Bosnjë dhe Hercegovinë.

„Ditët e Sarajevës“ përfaqësonin krijimin e lidhjeve të reja midis njerëzve dhe artistëve/eve, dhe disa qindra njerëz merrnin pjesë në programin e festivalit çdo vit. Për një numër të madh aktivistësh/esh nga Sarajevo, kjo ishte vizita e tyre e parë në Serbi.

Si pjesë e përgatitjeve për festivalin „Ditët e Sarajevës“ në vitin 2010, aktivistët/et e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut të BeH organizuan një aksion në rrugë në sheshin Alija Izetbegoviq, në të cilin banorët e Sarajevës u shkruan mesazhe qytetarëve/eve të Beogradit në bluzu. Qytetarët dhe qytetaret e Sarajevës printuan 150 bluzë që ua dërguan qytetarëve/eve të Beogradit, për të rivendosur ose përmirësuar kontaktet mes dy qyteteve. Autorët/et shpjeguan pse i printuan bluzat. Autori i mbishkrimit „Për miqtë nga Beograd, nga miqtë nga Sarajevo“, thotë – „Mendoj se është koha për të ndërtuar marrëdhënie paqësore midis këtyre dy qyteteve“.

Festivali organizohej çdo vit në Beograd deri në vitin 2014 dhe fitues/e të çmimit të festivalit, i cili iu dorëzua individëve dhe institucioneve që kontribuojnë në vendosjen e komunikimit dhe bashkëpunimit të përhershëm dhe paqësor ndërmjet Beogradit dhe Sarajevës, janë: Teatri Jugosllav i Dramës dhe menaxheri i atëhershëm teatrit Branko Cvejqiq, Mirjana Karanoviq, Natasha Kandiq, Gratë me të zeza, Borka Paviqeviq dhe Bilana Srblanoviq.

Që nga viti 2017, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut organizon „Mirëdita, Dobar dan!“ një festival, qëllimi i të cilit është të afrojë skenën kulturore të Kosovës me Serbinë dhe anasjelltas, të prezantojë skenën bashkëkohore kulturore dhe artistike të Serbisë para publikut nga Kosova. Përveç prezantimit më të mirë të skenës së artit bashkëkohor, vëmendja e veçantë e programit të festivalit është përqendruar në debatet publike dhe avokimin publik.



RASHA NEDELKOV

# NISMA ËSHTË NJË VEND I SIGURT, RRETH I NJERËZVE PËRPARIMTARË QË LUFTOJNË PËR VLERAT QË JANË TEMA TABU NË SHOQËRINË TONË



Rasha Nedelkov

drejtor programi i YIHR-së 2006 - 2007.  
Aktualisht drejtor programi në "Crta", një  
organizatë e shoqërisë civile e dedikuar  
për zhvillimin e kulturës demokratike dhe  
aktivizmit qytetar.

**Periudha ndërmjet viteve 2006 dhe 2007  
ishte koha kur ekzistonte optimizmi se  
forcat demokratike do të forcoheshin  
dhe do të bëhen dominuese në  
procesin e transformimit të shoqërisë,  
kujton Rasha Nedelkov, i cili në atë  
kohë ishte drejtor i programit të Nismës  
së të rinjve për të drejtat e njeriut në  
Serbi. Për atë si aktivist, Nisma ishte një  
"ambient natyror" dhe një nga këndet e  
pakta ku ai mund të realizonte idetë e tij  
dhe të zhvillohej.**

"Filova të ndjek më intensivisht punën e Nismës në vitin 2005 kur ata filluan fushatën "Të shikosh, të dish, të kujtosh" për gjenocidin në Srebrenicë. Unë isha 24 vjeç atëherë dhe besoja se do të isha në gjendje të lëvizja botën. Këtë e provova në mënyrë idealiste përmes aktivizmit në një parti politike, nuk m'u desh shumë kohë për të kuptuar se deri në çfarë mase priorititetet e një partie politike nuk ishin vlerat apo idetë politike, por përfitimi materialo-politik dhe ruajtja e statusit quo.

I zhgënjer nga hipokrizia e thellë e partisë, e kisha të qartë se vështirë do të mund ta realizoja luftën time për një Serbi tjetër përmes aktivizmit partiak. Në rrethana të tilla, ftesa për t'u bërë pjesë e Nismës ishte jo vetëm një përgjegjësi dhe nder i madh për mua, por edhe një shpëtim dhe një shans për të luftuar për idetë që besoj me njerëz me të cilët ndaja të njëjtat vlera".

Nisma përfaqëson një vend të sigurt për Rashën, një rreth njerëzish përparimtarë që luftojnë padiskutim për vlerat që ishin dhe mbeten tema tabu në shoqërinë tonë.

"Kam pasur mundësinë të merrem me çështje të rëndësishme sociale, të mësoj metoda të reja pune, të punoj me njerëz kreativë dhe energjikë. Ka qenë mjedis, pra njerëzit që përbën Nismën që kanë pasur ndikimin më të madh tek unë. Të gjithë ne e pamë angazhimin në Nismë si thirrje, jo si punë. Edhe sot kam të njëtin qëndrim ndaj aktivizmit, punës dhe angazhimit social dhe besoj se rruga ime e zhvillimit do të kishte qenë dukshëm ndryshme nëse nuk do të kisha pasur mundësinë të punoja në Nismë në angazhimet e mia të para profesionale".

Si veçanërisht të rëndësishme, ai vë në dukje programet "Nisma ime", një rrjet aktivist që punoi për të lidhur të rinjtë nga i gjithë rajoni dhe "Justice Advocates Network",

të cilin e konsideron gjithashtu një nismë shumë të rëndësishme të edukimit të bashkëmoshatarëve në fushën e drejtësisë tranzicionale.

"Edhe pse nuk zgjati, mendoj se Nisma JAN është edhe sot e një rëndësie thelbësore, ndaj shpresoj që gjenerata e re e Nismës do të gjejë fryshtëzim në ato përpjekje fillostarte dhe të arrijë shumë më tepër se ne.

ZHELKO STANETIQ

# NISMA ËSHTË ZEMRA E SERBISË



Zhelko Stanetiq

aktivist i YIHR-së që nga viti 2007 dhe drejtor i Qendrës Qytetare të Vojvodinës në Novi Sad.

**Në vitin 2007, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut shpalli një konkurs të quajtur "Me prerjen e kufijve deri te miqtë e rinjë". Ishte e nevojshme t'i përgjigjesh temës në format video ose fotografie dhe fituesit të konkursit do t'i jepej vend në grupin e aktivistëve që do të vizitonin "Festivalin e Filmit të Sarajevës". Zhelko Stanetiq, atëherë student i gazetarisë në Novi Sad, fitoi në konkurs, dhe udhëtimi në Bosnje përcaktoi mjaft jetën e tij të ardhshme profesionale.**

Në ato vite, shoqëritë në vendet e krijuara nga shpërbërja e Jugosllavisë ishin më të larguara nga njëra-tjetra sësot. Qendra Qytetare e Vojvodinës (QQV) lindi si rezultat i bashkëpunimit me Nismën dhjetë vjet më parë, në të cilën ishin angazhuar aktivistë të Nismës nga Novi Sad.

"Afërsia e ngjarjeve të luftës në atë periudhë, individët e akuzuar për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ishin ende të lirë, dhe pikat e komunikimit mes njerëzve nga vende të ndryshme ishin kryesisht organizata të tillë si Nisma. Pothuajse askush që i përkiste gjeneratave të reja nuk udhëtoi në Sarajevë apo Prishtinë, përvèç nëse organizohej nga njëra prej organizatave të shoqërisë civile. Edhe pse ka ende shumë probleme të pazgjidhura nga lufta, koha ka bërë të mundur që njerëzit të fillojnë të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë në nivele të ndryshme dhe ky është një proces që (fatmirësisht) nuk mund të ndalet".

Në atë kohë, Nisma kishte zyrën e saj lokale në Novi Sad, dhe Zhelko iu bashkua si aktivist, menjëherë pas kësaj u bë koordinator për bashkëpunim me media.

"Ky është njëkohësisht edhe pozicioni im i parë në Qendrën Qytetare të Vojvodinës. Ndërkoçi, kam koordinuar rrjetin "Nisma ime" në zonën e Vojvodinës, kam qenë i angazhuar si trajner i qendrës së trajnimit të Nismës disa vite dhe kam qenë koordinator i procesit të mbledhjes së nënshkrimeve në mbështetje të Nismës për themelimin e komisionit të KOMRA-s për zonën e Vojvodinës. Nevojat lokale e diktuan atë proces dhe ne morëm mbështetjen dhe ndihmën e plotë nga Nisma në vitet e para të punës".

Programi i parë dhe sipas tij më i rëndësishëm që realizuan ishte programi i rrëfimeve gojore i quajtur "Histori të patreguara". Lindi nga nevoja për të theksuar dhe regjistruar rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë viteve të nëntëdhjetë në Vojvodinë. Në atë kohë, shumica e burimeve të organizatës ishin të përqendruara në kërkimin dhe dokumentacionin në terren. Sot, aktivitetet kanë të bëjnë më së shumti me prezantimin e rezultateve të atyre kërkimeve përmes formave të ndryshme të artit për të ndërtuar dhe ushqyer një kulturë pjesëmarrëse të kujtesës. Aktualisht janë në pritje të premierës së filmit të parë të metrazhit të shkurtër të prodhuar nga QOV.

Zhelko e lidh zhvillimin e tij profesional me Nismën; duke punuar atje, ai kuptoi se dëshiron të vazhdojë të merret me të drejtat e njeriut, kulturën e kujtesës dhe ballafaqimin me të kaluarën e luftës në këto zona dhe përfshirjen e të rinjve në proceset socio-politike përmes aktivizmit rinor.

"Mendoj se Nisma si rrjet i njerëzve aktivë, të përkushtuar, ka ndikuar në një numër të madh të ndryshimeve pozitive për shoqëritë në Serbi dhe në rajon në njëzet vitet e fundit. Në planin personal, gjatë viteve të punës, Nisma më solli shumë njerëz të afërt që i njoha atëherë, dhe sot i kam mikeshat dhe miqtë e mi më të mirë. Në planin profesional, Nisma ishte për mua një mundësi e vlefshme që të bashkëpunoja me njerëz nga vendet e gjithë ish-Jugosllavisë, të mësoja dhe të përparoja në një ambient të tillë".

Fushatat e GOTV, "Mobilizimi i Serbisë Qytetare" dhe "Të rëndësishëm jemi Ne" sollën një numër të madh të rinjsh dhe të talentuarish në Nismë dhe bindën një numër edhe më të madh të tyre për të marrë pjesë në zgjedhjet shumë të rëndësishme të atyre viteve. Programet e vizitave të Nismës kanë mundësuar mijëra të rinj të vizitojnë vendet të ndryshme të rajonit për herë të parë në jetën e tyre.

Ndër veprimet më të rëndësishme në të cilat mori pjesë Zhelku ishte shkrimi i fjalës "Ajo fjalë e vështirë e huaj – gjenocid" në trotuarin para parlamentit të Republikës në vitin 2010, menjëherë pas miratimit të Deklaratës për Srebrenicën.

"Aksioni u organizua si një protestë e qartë për shhangjen e përdorimit të fjalës gjenocid dhe relativizimin e faktave për atë që ndodhi në korrik të vitit 1995. Fatkeqësisht, ne jemi dëshmitarë të këtij procesi edhe sot".

Bashkëpunimi i QOV-së me Nismën nuk është ndërprerë asnjëherë, vetëm ka ndryshuar forma gjatë gjithë këtyre viteve, ndonjëherë ka qenë pak a shumë intensiv: "Mendoj se aktivistet dhe aktivistët nuk pushojnë kurrë të jenë të tillë, veçanërisht aktivistet dhe aktivistët e YIHR-së".

**AGON MALIQI**

# YIHR, STRUKTURA MË E GUXIMSHME NË VENDET E ISH-JUGOSLLAVISË



**Bashkëpunimi i Agon Maliqit me YIHR-në nis me miqësinë që krijoj me Andrey Nosov para se të themelohej formalisht YIHR-a në Kosovë. Maliqi dhe Nosovi ishin takuar në vitin 2001, në programin e shkëmbimeve rimore dhe atëherë e gjitha kishte filluar më shumë si një lloj bashkëpunimi personal. Pasi ishin themeluar zyrat rajonale dhe Nisma zgjerohej më shumë, Maliqi ishte bërë edhe formalisht anëtar i YIHR-ës dhe mes viteve 2007-2008 ai ishte drejtor i zyrës në Kosovë. Më vonë ai nuk pati ndonjë bashkëpunim të strukturuar me YIHR-ën, por gjithmonë ishte në një linjë bashkëpunimi me Andrejin dhe organizatën në nivelin rajonal, duke mbështetur gjithashtu YIHR-ën në Kosovë.**

Mes viteve 2018-2019, Maliqi hyri sërisht në sferën e YIHR-ës kur u bë anëtar i Bordit të saj në Beograd.

Maliqi e përshkruan në një kontekst tejet kompleks shoqëror e politik në vend kohën kur ai nisi të bashkëpunonte me Nismën, sidomos në vitet e para pas luftës në Kosovë, pastaj në vitet para shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Ai kujton kur Andrey Nosov, pak ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, shkruajti një editorial që u publikua në Kosovë ku thoshte se shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë materializim i një të drejtë historike, gjë që nxiti shumë kërcënime ndaj tij në Serbi.

Fuqizimi i të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhje dhe jetën publike, sidomos në nismën "Nisma ime" ishin disa nga projektet ku ai kishte një rol ideues dhe shtytës, përfundimisht kryesisht në dy dimensione: bashkëpunimin rajonal dhe paqen e pajtimin ne vend.

Nën sloganin: "Kokrra jote, jo e babës", YIHR-a dhe aktivistët e saj në Kosovë, në atë kohë, po sfidonin kulturën e votimit familjar, por edhe thirrjet për bojkotim të zgjedhjeve nga lëvizjet politike në vend, si Vetëvendosja.

Ai thotë se YIHR-a, sidomos në atë kohë, ka përfaqësuar një rrymë skajshmërisht progresiste të Serbisë. "YIHR-a ishte një organizatë vërtetë rajonale, në dimensionin e saj dhe në botëkuptimin universal".

Përtej kohës së angazhimit të tij në organizatë, Maliqi e sheh YIHR-në si thellësisht parimore, me qëndrime të drejta dhe reale sa i përket historisë së Kosovës. "YIHR-a ka qenë vazhdimi i asaj që e ka promovuar p.sh. Natasha Kandiq dhe HLC, organizata që kanë për qëllim të mbrojnë vlera universale, pa agjenda etnike apo hegemonie". Në një dimension autentik, ai thotë se atë që e bëri YIHR-është një simbol i një platforme të së vërtetës, dhe të drejtave të njeriut. "Veçoria e YIHR-ës ishte gjithashtu se nuk ishte ide e themeluar nga jashtë përfundimisht paqen artificialisht".

YIHR-a në Prishtinë luajti gjithashtu një rol aktiv që çështja e diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual të futej në Kushtetutën e Kosovës.

Megjithatë, në trajktoren e komunikimit ndëretnik, Maliqi ndjen se në vitet e fundit ka pasur regres. "Ndoshta këtë e bën afërsia kohore me luftën. Në atë kohë kjo afërsi e ka bërë më të lehtë që të kuptohet më shumë e vërteta përfundimisht e tragjedisë që ka ndodhur. Veçanërisht në Serbi kishte më shumë zëra progresiv sesa tanë".

Ai përmend partitë politike pro njohjes së pavarësisë së Kosovës dhe një shoqëri civile më të arsyeshme. "Kthim prapa ka edhe në Kosovë. Por në Serbi po vërehet efekti i ngujimit. Sa më shumë po largohen në kohë nga lufta ajo distancë kohore po e bën luftën dhe përfundimisht e saj më të ndikueshme prej mitologjive politike".

Ai flet përfundimisht për një realitet kur shumëcëka po bëhet më e ceneshme prej propagandës. "Sa më shumë breza vijnë që nuk e ka përjetuar luftën, aq më shumë po u jetet mundësia elitave politike përfundimisht ta interpretuar atë ashtu siç u përshtatet".

"Në atë kohë, lufta dhe pasojat e saj ishin të freskëta dhe nuk mund të mohoheshin, ngase krimet ishin parë dhe përfundimisht", thotë ai.

Sidoqoftë, Maliqi thotë se në atë kohë ka qenë më e lehtë përballja me përfundimisht e krimeve.

"Në Serbi elitat politike e kanë prodhuar këtë kthim prapa dhe këtë kulturë mohimi. Gjithashtu, shoqëria civile si duket e ka humbur atë zellin në atë nivel që ka qenë atëherë", thotë ai.

Maliqi thotë se YIHR-është një zë i nevojshëm. "Në Kosovë vërehet një shpërfillje në perspektivën e trajtimit të pakicave dhe në dimensionin etnik. YIHR-është e vetmja që ka një lloj besimi te komuniteti serb".

Pavarësisht përvojave unike, ai thotë se mungesa e rezultateve më të prekshme në raportet Kosovë-Serbi e kanë bërë pak më cinik, po edhe më shumë "me këmbë më tokë".

"YIHR-është një organizatë liberale dhe më të guximshme në vendet e ish Jugosllavisë", përfundon Agon Maliqi.

ZHELKO BODROZHIQ

# NISMA PËRFAQËSON ENERGJI TË RE NË LUFTËN CIVILE PERSONALE DHE PROFESIONALE PËR NJË BALLKAN NORMAL



Zhelko Bodrozhiq

redaktor i revistës "Rez", YIHR Serbi 2007-2008. Themelues dhe redaktori "Kikindske novine" ("Gazeta e Kikindës"), dhe kryetar i NUNS-it (APGS).

**Gjatë viteve të nëntëdhjeta, Zhelko Bodrozhiq ishte organizator i protestave civile dhe për shkak të artikujve të tij gazetaresk, ai u dënuua dhe u gjobit disa herë në kohën e ligjeve represive për media të regjimit të Millosheviqit. Ai është gazetari i parë në Serbi që fitoi një çështje kundër shtetit para Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Nju Jork (në vitin 2005), si dhe dy raste para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (në vitin 2009).**

Ai e ka mbështetur punën e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut që nga themelimi i organizatës, duke iu përgjigjur ftesave për aksione dhe forume të ndryshme. Duke qenë se ndante të njëjtat vlera me Andrej Nosovin, në vitin 2007 pranoi ftesën e tij për t'u bërë pjesë e organizatës: ata mblodhën një ekip gazetarësh nga rajoni dhe themeluan revistën "Rez" ("Prerje"), kryeredaktor i së cilës ishte Zhelku.

"Tani që i shikoj të gjitha numrat, "Rez-i" ishte vërtetë përparrë kohës së tij në shumë mënyra. Në atë kohë, "Kikindske", së bashku me "Vranjske", "Nezavisna svetlost" dhe disa gazeta të tjera lokale, ishin të njohura në mbarë vendin dhe ishin në përputhje me atë që bën Nisma. Andrej ka patur edhe më parë idenë për të krijuar një revistë rajonale. Ekipi nga "Kikindske" ka punuar në pjesën teknike, Mila Melank si redaktore arti dhe Misha Dragin si redaktor teknik, por kemi pasur edhe bashkëpunëtorë të mirë në të gjitha vendet që kanë gjetur bashkëbisedues të mirë. Ishte kryesish një grup më i ri njerëzish mendjehapur që donin të dilnin nga ato narrativa nacionaliste dhe politika ksenofobike që ishin ende të përhapura në të gjitha vendet tona".

Siq thotë Zhelku, në një ambient ende plot urejtje nacionaliste, "Rez-i" edhe për aq kohë të shkurtër që u publikua, arriti të t'rheqë vëmendjen e publikut.

"Ai foli me guxim për tema që shumë i shmangën dhe i ndriçoi nga të gjitha anët e ish-Jugosllavisë. Ne ishim qartazi kundër luftës, ndarjes dhe urejtjes dhe donim pa kompromis që shoqëritë tona të ballafaqoheshin me të kaluarën, që kriminelët të etiketoheshin dhe të dënoheshin dhe t'u përkushtoheshim viktimate në të gjitha anët. Përveç kësaj, revista, më duket, ka lënë mbresa edhe në kuptimin vizual. Kishim numra kushtuar personave LGBT+, me kopertina provokuese dhe për mua shumë të bukura".

Zhelko kujton se Andrej në atë kohë në Serbi u etiketua si „tradhtar dhe mercenar i huaj”, njeri që është për “Shqiptarët dhe Kosovën”, dhe të gjithë të tjerët që guxuan të flisin hapur për çështjet e së kaluarës në ato vite u cilësuani si “antiserbë, serbë të dytë, shqiptarë, ustash, balie”.

“Atëherë besoja se pas pak vitesh do liroheshim nga ato histori të errëta, se shoqëria do të bëhej më e ndjeshme ndaj minoritetave, por doli që ne jemi ende në atë spirale të së keqes dhe urejtjes. Për më tepër, gjeneratat e reja janë edhe më të helmuara nga nacionalizmi dhe ksenofobia. Këtu në Serbi, qeveria në mënyrë sistematike, sidomos në dekadën e fundit, e ka imponuar këtë urejtje ndaj të tjerëve dhe atyre që

janë ndryshe dhe tani një medium si “Rez-i” nevojitet më shumë se kurrë”.

Përveç kësaj se u “pritën në thikë” për shkak të temave që trajtuan, ata morën shumë lavdërimë edhe nga kolegët dhe koleget e redaksive të ndryshme. Çdo numër ishte i disponueshëm edhe në edicionin në internet, për të cilin ishte i ngarkuar Ivan Bunçiq.

“E kuptuam pas disa kohësh se projekti i botimit të një reviste rajonale ishte thuajse i pamundur, sepse na rëndonte shpërndarja e shtrenjtë dhe në disa raste e pamundur. Na duheshin shumë më tepër para për t'i bërë ato të disponueshme kudo, dhe muaj të tërë fushatash promovuese, por për diçka të tillë nuk kishte fonde të mjaftueshme.”

Nisma e ndihmoi Zhelkon të bëhej më i ndjeshëm dhe forcoi pikëpamjet e tij. Pas “Rez-it”, ai mori një “ngazëllim të ri” për të vazhduar si redaktor në të njëjtin drejtim në “Kikindske”.

“Është mjaft dëshpëruese dhe zhgënjeze kur ripërjeton diçka që menduat se do të mbetej vetëm një e kaluar e shëmtuar. Fëmijët e mi si studentë sot mbajnë parullat që unë mbajta në fillim të viteve të nëntëdhjeta dhe më duhet të pyes veten nëse kemi bërë diçka dhe e kemi çuar përparrë. Duket se nuk kemi bërë, por mendoj se kemi bërë, sepse Serbia dhe vendet e tjera ish-jugosllave do të ishin në një gjendje edhe më të keqe nëse nuk do të ishim ne që kundërshtuam hapur luftën, nacionalizmin dhe çdo formë urejtjeje. Vite më parë, Serbia u kthye djathtas dhe shumica e qytetarëve janë ende të bllokuar në ide që janë katastrofike si për veten e tyre, ashtu edhe për të gjithë të tjerët në mjesid”.

Nisma, thotë Zhelko, është e veçantë sepse bashkoi të rinjtë nga rajoni që nuk ishin parë kurrë më parë, e lëre më të shoqëroheshin. Atë e ndihmoi posaçërisht për të kuptuar nevojat dhe të drejtat e të gjitha pakicave, veçanërisht gjatë Paradave të para të pasuksesshme dhe dhunës në rrugë.

“Nisma ishte avangarde në çdo kuptim. Ky ishte brezi i njerëzve që lindën kur Milosheviqi erdhë në pushtet dhe ata kishin dikë nga lëvizja kundër luftës për të mësuar. Këta të rinj nuk u rënduan nga e kaluara e shëmtuar dhe filluan të bashkijnë rajonin. Në atë moment, Nisma ishte një zbulim për disa të rinj, diçka e re që ma hapi edhe më shumë mendjen, siç kam bërë kur isha fëmijë dhe “i ngjitur! me Xhoni Shtuliqin”.

Për punën e tij, Zhelko mori çmimin e gazetarit “Dushan Bogavac” për etikë dhe guxim në vitin 2001, dhe çmimin “Stanislav Stasha Marinkoviq” për arritje të veçanta në gazetari në vitin 2018.

TANJA MATIQ

# NISMA PËRFAQËSON RININË DHE PAKOMPROMISIN – NUK KA MBYLLJE, DUHET TË SHIKOHET VETJA DHE OBORRI I VET



Tanja Matiq

koordinatore për mediat e ekipit të YIHR-ës dhe zëvendës kryeredaktore e revistës "Rez" në periudhën 2007 - 2008. Aktualisht punon si menaxhere në agjencinë turistike online Booking, në Amsterdam.

**Në kufirin e Kosovës dhe Serbisë, rrugës për në Beograd, gazetarja e atëhershme e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) nga Kosova, Tanja Matiq, takoi Andrej Nosovin në vitin 2004, një nga themeluesit e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut. Tanja iu bashkua Nismës në vitin 2006/2007, në kuadër të fushatës "Nuk janë të gjithë njësoj", e cila synoi ndërgjegjësimin për rëndësinë e daljes në votime. Në fillim të vitit 2007, YIHR themeloi revistën "Rez", dhe Tanja, e cila në atë kohë drejtonte pjesën mediatike të Nismës, u bë pjesë e ekipit redaktues të revistës, numri i parë i së cilës doli në qershor të të njëjtit vit.**

"Kur u njohëm, unë punoja në Prishtinë për BIRN-in si gazetare në zyrën e Kosovës. Ishte fantastike të shihje dikë kaq të ri që nuk kishte ndonjë nxitje nacionaliste. Përkundrazi, përpiquej të bënte një lidhje mes Kosovës dhe Serbisë. Punuam së bashku disa vite dhe më pas u shpërngula në Beograd dhe atëherë iu bashkova ekipit të mediave".

Në atë kohë, Zhelko Bodrozhiq ishte kryeredaktor i revistës, Tanja zëvendëse, ndërsa Jelka Jovanoviq redaktonte temën rajonale. Ivan Bunçiq ishte i ngarkuar për versionin në internet të revistës.

"Ishte një periudhë e mrekullueshme, kishim bashkëpunëtorë gazetarë nga e gjithë ish-Jugosllavia dhe botuan rreth 10 botime. Fatkeqësisht, nuk ishte një medium fitimprurës dhe ishte mjaft e vështirë të gjeje dikë që donte të printonte diçka të tillë në Serbi. Revistën e kemi shtypur në Kikindë, ku shtypeshin edhe gazetat e Kikindës. Ishte mjaft e vështirë për të gjetur shpërndarës, pasi temat tona ishin provokuese, shoqërore dhe politike. Nuk kishim reklamues që kërkonin diçka, ishim të pavarur dhe nuk ishim mbështetës të asnjë partie politike".

Në atë periudhë, BIRN-i ishte një nga organizatat e pakta që kishte gazetarë në të gjithë ish-Jugosllavinë, BIRN-i ishte i angazhuar në gazetari investigative dhe analiza socio-politike, dhe duke qenë se nuk kishte organizata që merreshin me kulturën dhe aktivizmin në rajon, lindi ideja për të formuar "Rez-in" ("Prerje-n").

"Kam menduar se gazetari duhet të jetë objektiv dhe të mos mbajë anën e askujt, të ketë pikëpamjet e veta, por është shumë e rëndësishme që gazetaria t'i shërbejë të vërtetës. Kam pasur këtë dilemë personale sepse po shkoj në aktivizëm nga gazetaria – a është mirë apo jo. "Rez-i" ishte pika ku mund të vazhdoja të shpreheshha si gazetare, dhe nga ana tjeter, të kontribuoja në një organizatë të re ku ka të rinjë, disa prej të cilëve as që jetonin në

ish-Jugosllavi. Mendoj se ishte e dobishme nga njëra anë, dhe nga ana tjeter, kur e shikoj, Serbia ndoshta ka mbetur e njëjtë. Disa gjëra ndryshojnë, por fatkeqësisht ende është e nevojshme të kemi organizata si Nisma. Mendoj se "Rez-i" ishte një revistë shumë cilësore, do të doja që diçka e tillë të ekzistonte ende".

Tanja mendon se Nisma është një lëvizje e të rinjve, të vendosur, të pakompromis dhe energjikë – njerëzve që nuk janë kryelartë dhe që e dinë se kur është koha për t'u larguar.

"Ajo që ishte gjeniale për mua ishte se Andreji nuk vendosi të qëndronte përgjithmonë në krye të organizatës. Nisma është një organizatë që ndryshoi drejtuesit e saj, Andreji u largua për t'u angazhuar në aktivizëm në kulturë. Është specifike që organizata ka qëndruar gjithmonë e hapur ndaj ndryshimeve nga brenda dhe ndaj zërave të tjerë, gjë që e bën atë të ndryshme nga të tjerët".

Tanja u largua nga Nisma në maj të vitit 2008 në agjencinë e lajmeve SENSE për të raportuar për gjyqet e krimeve të luftës në Hagë. Nisma i dha asaj një bazë të mirë për t'u marrë me drejtësinë tranzicionale, veçanërisht krimet e luftës të kryera gjatë luftërave të viteve të nëntëdhjjeta.

"Një nga arsyet pse u largova nga Serbia është se pas atyre zgjedhjeve pati shumë zhgënjim sepse nuk kishte ndryshuar shumë, dhe nga ana tjeter kjo ishte edhe sfidë profesionale. Nisma më edukoi shumë për krimet e luftës, për gjérat që ndodhën në territorin e ish-Jugosllavisë, kështu që raportimi nga Tribunali ishte një vazhdim i natyrshëm i gjithë atij rrugëtimi".

Në SENSE ishte deri në vitin 2016 dhe ende jeton në Holandë. Ka punuar si producente e disa filmave dokumentarë që Mirren me drejtësinë tranzicionale: "Këtë e kam bërë krahas punës sime komerciale, që do të thotë se kam qëndruar gjithmonë në ato ujëra".

JELKA JOVANOVIQ

# NISMA ËSHTË SHPRESË



Jelka Jovanovic

redaktere e temës rajonale të revistës "Rez" të YIHR-së në vitet 2007-2008. Sot gazetare e Novo Magazin.

**Është viti 2007. Gazetarja e Danas-it, Jelka Jovanovic pranon me kënaqësi ofertën e kolegut të saj, bashkëpunëtorit të Danas-it dhe themeluesit të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Andrej Nosov, për të shkruar për revistën rajonale "Rez", të cilën e redaktonte Tanja Matiq, gazetare e atëhershme e BIRN-it. Falë Andrejit, Jelka e ndiqte nga afër punën e Nismës, të cilën fillimisht e konsideroi si "ëndërr të paarritshme të një grapi të të rinjve nga vendet ish-Jugosllavisë".**

"Si gazetare që gjithmonë e kam preferuar printin, më ka pëlqyer themelimi i një reviste të tillë, më ka pëlqyer emri, më kanë pëlqyer njerëzit me të cilët kam punuar. Të mbledhur nga të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë, shumica prej nesh bashkëpunonin në jetët tona të mëparshme ose disi e gjetëm njëri-tjetrin. Edhe sot nuk jam e sigurt se i kemi justifikuar synimet e themeluesit. Atëherë në botë filloj kriza e printimit dhe mesazhet virtuale nuk u ndoqën sa duhet. Megjithatë, besoj se kemi bërë një punë të mirë".

Jelka e konsideroi shumë të rëndësishëm faktin që në Nismë u mblohdhën para së gjithash burrat, sepse ata janë ata nga të cilët pritet të bëjnë luftë, dhe jo të luftojnë kundër luftës. Ajo gjithashtu i konsideroi të rëndësishme gratë e reja që ishin kundër konfliktit "të bazuar në mite dhe ndarje të pakuptimta".

"Ata ia dolën të ruajnë mendjen e shëndoshë, por edhe më shumë entuziazëm, edhe pse antifashizmi dhe të drejtat e njeriut ishin ende një ëndërr e paarritshme për Serbinë dhe këtë pjesë të Ballkanit. Dhe, përfatim tim, forca e tyre më kundërshtoi. Më vjen keq që sot nuk ka një nismë të tillë mediatike, sepse rrjetet sociale dhe publikimet online nuk mund të mbushin boshllëqet dhe t'i bëjnë njerëzit të mendojnë si letra, pavarësisht risive. Me këto dy dekada vonesë, mendoj se nuk do të ishte keq të bëhej një riprintim qoftë edhe elektronik, sepse idetë që u vendosën aty janë më të gjalla dhe më të nevojshme sot se kurrë".

Si gazetare, Jelka është shoqëruar dhe ka mbështetur aktivistët e Nismës. Siç shpjegon ajo, nuk ka qenë nismëtare e aksioneve dhe fushatave, por një ndjekëse dhe pjesëmarrëse aktive.

"Besimi në idealet dhe rezultatet e mira, rinia dhe forca me të cilën lufton për ato ideale – kjo ende e dallon

Nismën në sektorin e OJQ-ve nga të tjerët. Do të doja që më shumë fëmijë, që sot mund të ishin nipërit dhe mbesat e mia, të ndiqnin atë rrugë".

Jelka thotë se nuk është larguar asnjëherë nga Nisma, sepse kjo është e pamundur. Ajo ende sot përpinqet të marrë pjesë në aksione – si gazetare edhe si qytetare – gjë që jo gjithmonë është e realizueshme fizikisht, por i sjell të njëjtën kënaqësi dhe kënaqësi si në fillim.

"Jam e bindur plotësisht se idetë dhe, theksoj, idealet e Nismës së të Rinjve nuk do të humbasin kurrë jo forcën e tyre, por domosdoshmërinë e tyre. Unë i ndaj dhe i përfaqësoj në punën dhe përfshirjen time shoqërore".

## RRJETI AKTIVIST “NISMA IME”

Aktivizmi ka zënë gjithmonë një vend të veçantë në aktivitetet e Nismës dhe organizimin e të rinjve. Për Nismën, aktivizmi ka qenë gjithmonë një sjellje apo aktivitet i planifikuar që shërben për të arritur ndryshime politike, shoqërore apo sociale. Demokracia, e ardhmja evropiane dhe paqja nuk kanë pasur kurrë alternativë për Nismën.

Në vitin 2006, Nisma organizoi një fushatë për bojkotimin e referendumit për Kushtetutën e re të Serbisë. Kushtetuta u formula pa debatuar, me kompromise të shumta dhe paraqet një hap prapa në fushën e të drejtave të njeriut sipas zgjidhjeve të vlefshme deri atëherë. Përmes fushatës së bojkotit u formua „Nisma ime”, një rrjet aktivist i të rinjve anembanë Serbisë, të cilët avokojnë ballafaqimin me të kaluarën dhe që janë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përfshirjen e të rinjve në jetën publike dhe politike.

„Nisma ime” organizoi tre fushata. Fushata e parë, e quajtur „Mobilizimi i Serbisë Qytetare”, në prag të zgjedhjeve parlamentare në Serbi në vitin 2007, me qëllim të motivonte të rinjtë me orientim demokratik të cilët ishin të zhgënjyer nga politika dhe politikanët, si dhe të rriste ndërgjegjësimin e pakicave për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje. Fushata u bë në dymbëdhjetë qytete të Serbisë. Lëvizja aktiviste „Nisma ime” më pas nisi fushatën për zgjedhjet presidenciale në Serbi „Abstignon-minon” në janar 2008, si dhe fushatën „Të rëndësishëm jemi ne” në prill të po atij viti.

Në këtë mënyrë, Nisma u përpooq të komunikonte me të rinjtë në një mënyrë tjeter dhe të vendoste standarde të reja në fushatat publike. Një segment veçanërisht i rëndësishëm është përdorimi i mediave të reja në fushat, të cilat e veçojnë Nismën nga organizatat e tjera të ndërlidhura. Rrjeti aktivist „Nisma ime” ishte rajonal dhe mblodhi të rinjtë, ndërsa aksione të ndryshme u organizuan edhe në vende të tjera.



IVAN BUNÇIQ

# PA ORGANIZATA SI NISMA, SHOQËRITË SI SERBIA NUK KANË MUNDËSI TË PËRPAROJNË



Ivan Bunçiq

menaxher projekti, YIHR Serbi 2007 - 2010,  
aktualisht Senior Software Developer në  
kompaninë e automobilave Tesla.

**Pas vrasjes së kryeministrit serb Zoran Gjingjiq dhe vendimit të presidentit të atëhershëm Boris Tadiq për të bashkëpunuar me qeverinë e Vojislav Koshtunicës, situata në Serbi dhe në rajon ishte më se e tensionuar. Rreth asaj kohe, në shkurt 2007, Ivan Bunçiq iu bashkua Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut me rekomandimin e mikeshës së tij mirë, dhe tani gruas së tij, Milica Miliq. Milica në atë kohë ishte koordinatore e lëvizjes "Nisma ime" dhe Nisma kishte nevojë për një web developer dhe administrator të sistemit. Ishte një organizatë e re me buxhet modest me zyra në Prishtinë, Sarajevë, Podgoricë, Kragujevc, Novi Sad dhe Beograd dhe vetëm pas disa vitesh u hap zyra në Zagreb, kujton Ivani.**

"Në vitin 2007, pas vetëm disa vitesh drithë, Serbia përsëri u bë një forcë e errët në Ballkan. Nisma duhej si një hallkë që do të duhej të edukonte shoqëritë e rajonit dhe t'i detyronte të përballeshin me të kaluarën e errët me qëllim të mos përsëritez".

Pas një dekade pune, partnerët ndërkombëtarë e kanë njojur Nismën si një organizatë të rëndësishme si për Serbinë ashtu edhe për rajonin.

"Ishte e rëndësishme si një vend ku mblidhen të rinj, të aftë, të gatshëm për të kundërshtuar mendimin se vetëm "serbi është njeri dhe të gjithë të tjerrë janë mut", se "gruaja është për kuzhinë, dhe se pederi, lezbikja, shqiptari dhe muslimani nuk duhet të ekzistojnë."

Ivani nuk është marrë drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut në Nismë. Duke punuar si web developer dhe administrator i sistemit, ai solli risi në fushën e integrimit të sistemit dhe rrjetit të IT-së, krijoi materiale online, bëri lidhjen e librave, broshura dhe faqe interneti, të cilat ai beson se do të lënë gjurmë të rëndësishme.

"Do të tingëlojë qesharake, por kur filluan, Twitter dhe Facebook nuk ekzistonin globalisht, dhe Google sapo kishte lancuar Gmail dhe domene të personalizuara për organizata dhe kompani. Deri atëherë, çdo zyrë rajonale kishte mail serverin e vet te provajderi lokal. Kjo e vështirësoi shumë bashkëpunimin dhe organizimin. Unë rekomandova dhe zbatova Google, të cilin Nisma e përdor edhe sot, megjithëse në atë kohë nuk ishte as e sigurt që të gjitha ato shërbime online do të mbijetonin për kaq shumë vite".

Si aktivitete dhe fushata të rëndësishme të realizuara gjatë angazhimit të tij, ai veçon fushatën e GOTV

"Të rëndësishëm jemi Ne" në të cilën të rinjtë nga Kosova dhe Serbia diskutuan për narrativat që janë dominuese në mjedisin e tyre; si dhe projektet „Justice Advocates Network“ dhe „Lufta në Serbi“.

"Nisma më solli shumë njohje dhe miqësi dhe më hapi sytë, më mësoi të vëzhgoja botën nga këndvështrime të ndryshme. Ajo më sensibilizoi për shumë tema që as nuk i mendoja në atë kohë. Ndryshon nga organizatat e tjera sepse mbron pa kompromis pikëpamjet dhe mbron të drejtat e njeriut të të gjithë personave, pavarësisht nga karakteristikat e tyre. Nisma më ka ndihmuar në aspektin biznesor dhe personal pikërisht përmes pakompromisit për gjërat elementare përtej apo poshtë të cilave nuk mund të shkoj".

Ivani "nuk ka ikur kurrë nga Nisma" dhe jeton vlerat e saj. Ai ka qenë në Bordin Drejtues, ndërsa që nga viti 2007 është në Asamblenë e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut edhe pse, siç thotë tani, "nuk është i ri".

MILLAN RADOVIQ

# NISMA ËSHTË NJË PLATFORMË KYÇE PËR AVOKIMIN AKTIV PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NLERİUT



Millan Radoviq

, studiues dhe koordinator i projektit të YIHR Podgoricë 2007-2012, sot drejtor programi në Aleancën Qytetare.i.

**Millani iu bashkua Nismës së të rinjve për të Drejtat e Njeriut në Podgoricë në 2007. Si sociolog nga arsimi, ai dëshironte të kontribuonte me njohuritë e tij në procesin e pajtimit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e vlerave qytetare si në Mal të Zi ashtu edhe në rajon. Në atë kohë, i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor po kalonte një proces të dhimbshëm tranzicioni, "plot ndryshime dhe sfida", dhe pjesë përbërëse e këtij procesi ishin çështjet e kimeve të luftës të kryera gjatë viteve të nëntëdhjeta, të drejtat e pakicave, torturat në njësitë e burgjeve etj.**

"Klima politiko-sociale në atë kohë ishte mjaft sfiduese për sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut por edhe sundimit të ligjit dhe kjo gjë ishte një motiv shtesë për t'u angazhuar në këtë organizatë.

Millani kaloi pesë vjet në Nismë. Gjatë asaj kohe, organizata ka realizuar dhjetëra veprime dhe fushata, ndërsa si më të rëndësishmet ai veçon ato që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut. Ekipi i Nismës mbloodi dokumentacion dhe hulumtoi faktë rrith kimeve të luftës të kryera gjatë luftërave të viteve të nëntëdhjeta, në mënyrë që të kuptoheshin me të vërtetë ato ngjarje dhe në mënyrë që viktimat dhe familjet e tyre të kishin qasje adekuate në drejtësi.

"Kështu krijuam Qendrën e Dokumentacionit dhe Informacionit, e cila përmban një arkiv të pasur për këto ngjarje dhe që shërben për edukimin e publikut për këto ngjarje. Organizimi i vizitave studimore, veçanërisht vizita në Dubrovnik, u mundësoi të rinje si dhe përfaqësuesve të funksioneve publike që të përballen nga afér me pasojat e luftërave dhe ta shohin situatën nga një këndvështrim tjetër nga ai i paraqitur në Mal të Zi".

Krahas kësaj, Millani veçon shkëmbimet rimore rajonale të cilat, siç thotë ai, mundësuan dialogun dhe shkëmbimin e përvojave, "që kontribuan në forcimin e lidhjeve rajonale dhe ndërtimin e një rrjeti të liderëve të rinj për të drejtat e njeriut". Ka edhe raporte të Nismës për gjendjen e të drejtave të njeriut në Mal të Zi, të cilat kontribuan në ndryshime të shumta në këtë fushë, dhe falë të cilave Nisma u njoh nga organizata të mëdha ndërkombëtare si Amnesty International, si dhe Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, të ambasadave të ndryshme dhe Bashkimit Evropian të cilët i cituan dhe iu referuan gjetjeve të tyre.

"Kjo ishte vendimtare për ngritjen e vetëdijes dhe presionin ndaj institucioneve kompetente për të ndryshuar praktikën e tyre.

Rezultat të madh kemi arritur pikërisht në fushën e torturës sepsë në fillim kemi regjistruar edhe mbi 50 raste në vit, ndërsa sot ky numër është dhjetëfish më i vogël, dhe ajo që është e rëndësishme, ka ndryshuar ndërgjegjësimi dhe vullneti politik i autoriteteve në institucione, dhe sot na shohim si partnerë me të cilët duan të punojnë në mënyrë që punonjësit e tyre të respektojnë të drejtat e njeriut kur përdorin, për shembull, mjete shtrënguese".

E gjithë kjo, vazhdon Millani, forcoi kapacitetet kërkimore të Nismës në Mal të Zi, por gjithashtu kontribuoi në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe arritjes së drejtësisë për viktimat.

Pas viteve të kaluara në Nismë, në vitin 2012 Millani vazhdoi karrierën e tij në Aleancën Qytetare, e cila u themelua nga Nisma. Fillimi ishtë qenë koordinator i programit për të drejtat e njeriut, ndërsa tanë mban postin e drejtorit të programit. Prandaj thotë se asnjëherë nuk është larguar plotësisht nga Nisma.

"Mund të them se vitet e kaluara në YIHR patën një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin tim profesional sepsë më dhanë përvojë dhe njohuri në ato fusha që kam pasur dhe kam mundësi t'i zbatoj në projekte të tjera në Aleancën Qytetare. Mund të them gjithashtu se YIHR ishte një themel kyç në rrugën time profesionale, duke më ofruar mjete, njohuri dhe një rrjet kontaktesh për të vazhduar punën në promovimin e të drejtave të njeriut dhe ndryshimeve pozitive sociale në Mal të Zi dhe më gjere".

RABA GJOSHI

# YIHR-A, RRYMË SHOQËRORE DHE BURIM I MUNDËSISË PËR TË VEPRUAR



**Ishte pranvera e vitit 2007 kur Raba Gjoshi sapo kishte përfunduar studimet në psikologji dhe për të ishte një moment i një të ardhmeje të panjohur profesionale. Në atë kohë dikush nga YIHR-a e kishte ftuar të merrte pjesë në një punëtori të projektit "Nisma Ime", nga u agazhua në mobilizimin e aktivistëve përfunduar fushatën "Dil Voto", e cila u bënte thirrje të rinjve për të dalë në zgjedhje.**

Më pas dera ishte e hapur për Gjoshin në Nismë që përpinqej të ndërtonte një urë komunikimi mbi bazën e shkëmbimit të të rinjve që mblidheshin përfunduar komunikuar përfunduar, aktualitetin dhe vizionin përfunduar ardhmen.

Kosova atëbotë mbizotërohej nga atmosfera e negociatave përfunduar statusin e saj politik.

"Ka qenë një kontekst shumë i vështirë social dhe politik, i një shoqërie të dalë prej luftës, skajshmërisht të traumatizuar dhe thellësisht të ndarë në baza etnike", thotë Gjoshi.

Në aspektin politik, ajo kujton se shoqëria kosovare ballafaqohej me të kaluarën, në një kohë tejet të ndjeshme ku mbizotëronte një lloj vazhdimesie e luftës politike.

Ajo që ndihmoi Gjoshin, në aspektin personal, që të ketë një njoħuri tjetër përfunduar realitetin politik e shoqëror në Serbi ishte vizita e saj e parë në Beograd në fund të vitit 2007. "Ishte rikthim i traumave, sidomos kur kam parë veturat e policisë të tipit "Zastava", më ngallin njëloj frike", kujton ajo.

Në vitin 2010, Gjoshi u bë drejtoreshë e YIHR-ës në Kosovë, në kohën kur kishte filluar transformimi prej organizatës rajonale në rrjet të organizatave nationale.

Projektet me të cilat krenohet ajo, dhe sheh gjurmët e saj, janë ato të nxijes së dialogut shoqëror përmes aksioneve avokuese dhe të memorializimit, kryesisht përfunduar personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Në vitin 2010, Gjoshi kishte vendosur që së bashku me kolegët e aktivistët e YIHR-së në Kosovë të shënonin Ditën Kombëtare të të Pagjeturve, përmes një muri të vendosur në qendër të Prishtinës me emrat e të gjithë personave të zhdukur, pa dallim etnie sipas listës së Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Aksioni kishte qenë tejet i guximshëm meqë përfunduar parë shfaqti në publik emrat e të gjitha viktimate dhe kështu sfidoi diskursin publik. Aktivistët u kërcënuan edhe pse ishin nën mbrojtje të policisë dhe KFOR-it. "Eshtë dashur ta ruajmë murin gjithë natën që të mos na e rrënonin para se ta shfaqnim përfunduar". Familjarët e viktimate aq sa ishin ndier të përbushur me përkujtimin

e të dashurve të tyre, po aq ishin goditur nga realiteti i drejtësisë së munguar dhe të vërtetës së heshtur.

Gjoshi përmend sfidat e të qenit pjesë e organizatës, ngase kishte njerëz që YIHR-në e percepton si organizatë nga Beograd, dhe rrjedhimisht shpesh kishte mungesë besimi. "Identifikimi me një organizatë si YIHR-a ishte problematik, dhe shpesh na etiketon si tradhëtar apo dorë e zgjatur e Beogradit".

Nën drejtimin e saj, YIHR-a kaloi në qeverisje lokale, fuqizo bashkëpunimin me institucionet vendore dhe u afroa më tutje me komunitetin vendor nga të gjitha etnitë duke bërë që organizata të rritet kredibilitetin dhe pranimin nga komuniteti i gjërë.

Në aspektin personal ajo thotë se eshtë rritur me YIHR-ën, sikurse YIHR-a eshtë rritur me të. "YIHR-a më ka dhënë mundësi të materializoj vlerat e mia personale të cilat janë reflektuar në punën time në organizatë".

Kur u largua nga YIHR-a në vitin 2015, pas më shumë se 8 viteve, duke lënë pas pjesën më të madhe të të njëzetave të saj, Gjoshi, thotë se ndjeu vlerën e asaj përvoje.

"Ishte një angazhim që kishte ndikuar në formësimin e personalitetit tim dhe vlerave që përfaqësoj. Eshtë një përvjohje e përfunduar unike e cila ka mbetur e integruar brenda meje", thotë ajo.

Gjoshi thotë se vështirë që ndonjë organizatë tjetër do të mund ta bënte atë që ka bërë YIHR-a. "Eshtë udhëhequr nga vizioni dhe guximi i rrallë."

Më shumë se një dekadë pas, duke parë një ndarje të thellë etnike, Gjoshi thotë se tani eshtë më pak entuziaste se pajtimi mund të jetë i lehtë dhe i shpejtë. "Nuk mund ta them me gojën plot", thotë ajo.

Ajo thotë se YIHR-a eshtë një rrymë shoqërore dhe burim i mundësisë përfunduar natyrshëm bazuar në disa vlera të përgjithshme. "YIHR-a në Kosovë ka përfaqësuar një vizion jokonvencional përfunduar me fuqizimin e shoqërisë dhe shtetit".

# ISHTE E RËNDËSISHME TË SHKUNDEJ APATIA SHOQËRORE



**Ishte një punëtori e organizuar në kuadër  
të një fushatë që avokonte pjesëmarrjen  
në zgjedhjet e vitit 2007 në Kosovë ajo  
që bëri që Vjosa Rexhepi të bëhet pjesë  
e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e  
Njeriut (YIHR).**

Duke qenë pjesë e fushatës për një muaj rresht, asaj i ka rënë të ketë kontakt me shumë shokë e shoqe të reja pjesë të rrjetit "Nisma Ime" të cilët thotë se i ka pjesë të shoqërisë edhe sot. Ajo thotë se si aktivistë dhe aktiviste ndanin vlera dhe besime të njëjta, gjë që e shtyu që të vazhdonte të ishte pjesë e këtij rrjeti, e të merre pjesë edhe në shumë e shumë aktivitete të tjera në vijim, angazhim të cilin e ka mbajtur për disa vjet në detyra të tjera qoftë si pjesë e Kuvendit të organizatës por edhe tani si anëtare e Bordit të saj.

"Për atë kohë mendoj që ishte shumë e rëndësishme shkundja e apatisë shoqërore rrëth padrejtësive dhe shkeljes së të drejtve të njeriut. Vetë krijimi i një grupei aktivistëve dhe aktiviste për të ngritur zërin kundër padrejtësive dhe këtyre shkeljeve ishte një sukses", thotë Vjosa Rexhepi.

"YIHR-a ka vazhduar të jetë zëri dhe adresa e shumë grupeve shoqërore të shtypura dhe puna që e ka bërë në edukimin e vetëdijësimin e të rinjve si dhe ballafaqimin me të kaluarën sollën ndryshim të jashtëzakonshëm në ato fusha", shton ajo.

Kur flet për kontekstin politik të asaj kohe, Vjosa Rexhepi kujton se Kosova atëbotë ishte në një fazë të rëndësishme zhvillimi institucional dhe politik, prandaj ishte një periudhë ku kishte shumë hapësirë për punë dhe angazhim në fushën e të drejtave të njeriut.

"Po e theksoj njërin nga programet e YIHR-së, atë të "Ballafaqimit me të kaluarën", ku për shumicën e shoqërisë ishte "mjaft herët" për të filluar një diskutim që ka të bëjë me pajtimin dhe bashkëpunimin me Serbinë, e të mos flasim për shkëmbim të vizitave dhe njohje të njëri-tjetrit jashtë retorikave politike", thotë Vjosa Rexhepi.

"Edhe në kontekstin politik por edhe atë shoqëror, nuk ishim të gatshëm për një fillim të ri në aspektin e ballafaqimit me të kaluarën. Shoqëria ishte e mbushur me shumë paragjykime, dhe ishte detyra jonë që t'i zbusim ato, derisa sa të eliminohen plotësisht. Rruga nuk ishte e lehtë, dhe as e shkurtër, vazhdon deri sot", shton ajo.

Ajo thotë se YIHR i kishte krijuar vetes infrastrukturë për të qenë e suksesshme në punën që bën si promotore e të

drejtave të njeriut në një kontekst më të gjërë rajonal. "YIHR-a ishte një organizatë rajonale, me zyra në pothuajse të gjitha shtetet e regjionit, gjë që e bëri të veçantë e të suksesshme në punën e saj. Në këtë mënyrë u vunë kontaktet e para nga të gjitha anët e rajonit, u ndanë eksperiencia reale nga secili shtet dhe pastaj mbi to u vazhdua më tutje me projekte të përbashkëta dhe rritje të numrit të njerëzve të cilët kaluan nëpër programe të ndryshme", thotë ajo.

Vjosa Rexhepi thotë se përfitimet nga YIHR-a në aspektin personal shkojnë përtjer dhënia së mundësisë për avokim e promovim të çështjeve të drejtave të njeriut.

"Duke qenë pjesë e një rrjeti të aktivistëve që lufton për të drejtat e njeriut dhe sado pak ke mundësi që të kontribuosh për një të mirë më të madhe dhe ndryshim në jetën e të tjerëve, kjo të jep një ndenjë përmbrashje. Aty kam gjetur ndjenjën e komunitetit dhe shoqërisë duke ndarë pasionin për të drejtat e njeriut me individë të të njejtë mendim, gjë që të përmbrashë emocionalisht", thotë ajo.

Ajo thotë se në kohën kur kishte nisur punën në YIHR, shumë pak të rinj ishin inkluadruar në aktivitete të organizatës për promovim e të drejtave të njeriut, paqes dhe pajtimit dhe se "shumë shpesh edhe paragjykohesha nga shoqëria".

"Mirëpo, në rastin kur t'i beson në ato vlera, e ke shumë më të lehtë për t'u përballur me to dhe për të vazhduar tutje", thotë Rexhepi.

Ajo nënizon se në fillimet e saj, YIHR-a e kishte të rëndësishme që ta shkundë apatinë shoqërore rrëth padrejtësive dhe shkeljes së të drejtave të njeriut.

"YIHR-a është një hapësirë gjithëpërfshirëse që bashkon të rinjtë për të përforcuar zërat e tyre, për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut dhe për të sjellur ndryshime domethënëse përmes aktivizmit", përfundon Vjosa Rexhepi.

**RUZHICA DEVIQ**

# NISMA ËSHTË FORCA DHE ENTUZIAZMI I TË RINJVE QË BESOJNË NË NJË TË ARDHME MË TË MIRË DHE NJË SHOQËRI MË TË DREJTË



**Ruzhica Deviq**

koordinatore e programit të shkëmbimit  
rajonal, YIHR Serbi, 2007-2009.

**Në vitin 2007, Ruzhica Deviq vendosi t'i bashkohet Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi për të mësuar më shumë rrëth ngjarjeve sociale dhe politike në rajon. Në ato vite Serbia ende nuk kishte një regjim pa viza, ndaj Ruzhica udhëtonte vetëm në vendet e ish-Jugosllavisë. Papunësia ishte e lartë, sidomos tek të rinjtë.**

Në vitin 2007, Ruzhica Deviq vendosi t'i bashkohet Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi për të mësuar më shumë rrëth ngjarjeve sociale dhe politike në rajon. Në ato vite Serbia ende nuk kishte një regjim pa viza, ndaj Ruzhica udhëtonte vetëm në vendet e ish-Jugosllavisë. Papunësia ishte e lartë, sidomos tek të rinjtë.

"Ndryshimet në shoqëri, të cilat i prisnim me padurim pas viteve të errëta të 90-ta, dhe që shkurtimisht u duk se u realizuan pas vitit 2000, dhe në vitin 2007, përsëri duke shin të paarritshme dhe të largëta", thotë Ruzhica.

Serbia në ato vite zhytej në një klimë politike që ishte trashëgimtare e politikës destruktive të viteve të nëntëdhjetë dhe atmosfera në shoqëri ishte depresive dhe pa perspektivë. Ruzhica ndjeu nevojën për t'u përballur me këtë për të mos rënë në apati dhe pakënaqësi të përgjithshme.

"Kosova ishte tema kryesore politike, krejtësisht e parëndësishme për mua në atë kohë. Nuk kam takuar asnjëherë një shqiptar/e nga Kosova, as nuk kam qenë e interesuar të shkoj e të marr ndonjë përvojë të jetës që është disa qindra kilometra larg. Kosovarët ishin disa të tjerë, të huaj për mua, për të cilët kisha një mendim të ngulitur në mënyrë stereotipike, si të gjithë në Serbi dhe të cilin e fitova në bazë të imazhit mediistik të Kosovës, që doli të ishte shumë i gabuar".

Me Nismën shkoi për herë të parë në Kosovë, Prishtinë dhe Graçanicë dhe ai udhëtim e ndryshoi përgjithmonë. Ajo theu stereotipet dhe paragjikimet që kishte për njerëzit në Kosovë dhe bëri miq të rinj, por u përball edhe me të vërtetën për luftën në Kosovë, për viktimat civile dhe krimet.

Pas kthimit nga Kosova, shpejt u punësua në Nismë për krijimin e programave të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe në programin e praktikës në Tribunalin e Hagës. Ajo ishte në krye të programit të shkëmbimit të të rinjve Visiting dhe deri në vitin 2009, pothuajse çdo muaj drejtonte grupe të reja të rinjsh, studentë, gazetarë, aktivistë, artistë nga Serbia etj. në Prishtinë dhe Sarajevë dhe mirëpriti grupe të rinjsh nga Kosova dhe Bosnja e Hercegovina në Beograd.

"Një numër i madh i të rinjve nga Serbia, BeH dhe Kosova e kaluan programin dhe për herë të parë vizituan shoqëritë që konsiderohen armiqësore në vendet e tyre dhe takuan bashkëmoshatarët e tyre për të cilët deri atëherë kishin paragjykime të mëdha. Unë ende e konsideroj programin Viziting një nga programet më të rëndësishme të Nismës dhe ishte i pari që hapi derën mes Kosovës dhe Serbisë për të rinjtë".

Megjithatë, 20 vjet më vonë, ky program nuk është më aq ekskluziv, thotë Ruzhica, sepse të rinjtë nga Beograd shkojnë në klabinë Prishtinë me iniciativën e tyre dhe anasjelltas; grupe muzikore nga Serbia shkojnë në Prishtinë dhe studentë nga këto qytete bashkëpunojnë. Përveç kësaj, sot ka një numër të madh të programeve të tjera të ngashme që lidhin të rinjtë nga Kosova dhe Serbia.

"Në Serbi ende ka reagime të forta kur flitet për jetën në Kosovë ndryshtë, përmes artit dhe kulturës që krijuhet atje, e jo përmes gjuhës sëurrejtjes dhe mohimit të tjetrit. Kështu ndodh edhe sa herë që organizohet festivali i kulturës kosovare 'Miredita, Dobar dan'. Kosova është ende tema kryesore në Serbi në një mënyrë të ngashme si në vitin 2007, por gjithsesi arritëm të ndryshonim diçka". Gjatë dy viteve të punës në Nismë, ajo ishte e përkushtuar në përpjekjen për të treguar një imazh ndryshtë të Kosovës dhe për të edukuar të rinjtë për të kaluarën e luftës. Pas Nismës, ajo donte të "shihte pak botën" dhe të pushonte, kështu që dy vitet e ardhshme i kaloi jashtë Serbisë – një vit në praktikë profesionale në Gjermani dhe një vit në studime në Indonezi. Pas kthimit në Serbi, ajo mbeti e përkushtuar ndaj të njëjtave ide dhe vlera përmes aktivizmit dhe punës profesionale.

"Punën e Nismës e kam ndjekur edhe pas vitit 2009 dhe ardhjen e grupeve të reja të rinjsh që vazhduan punën tonë me të njëjtin zell dhe pasion. Fatkeqësisht, nevoja për të njëjtat tema ekziston edhe sot. Nisma nuk hoqi dorë kurrë nga ajo luftë dhe në këto 20 vite ende nuk është lodhur". Deri më 1 shtator, Ruzhica punoi në Fondacionin për Arsimin e Romëve si koordinatore e programit arsimor. Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, ajo është aktive në sektorin civil në Serbi si menaxhere, koordinatore dhe hulumtuese në projekte dhe programe në fushën e arsimit, të drejtave të njeriut dhe të pakicave, kulturës së përkujtimit dhe kërkimit mbi Holokaustin dhe gjenocidin kundër romëve.

# NISMA JANË DASHURI, PASION DHE MIQËSI



Alma Mashiq

drejtore/drejtoreshë ekzekutive, 2008-2017, YIHR Bosnjë dhe Hercegovinë, tani koordinatore e programit të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdurur në Ukrainë.

Kur iu bashkua Alma Nismës në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2008, si drejtoreshë ekzekutive, atëherë kishte përvojë të pasur të fituar në organizata ndërkombëtare dhe diplomaci. Në atë kohë, Nisma ishte në një situatë të vështirë: llogari të papaguara, hapësirë pune pa rrymë, ujë, gaz, telefoni ishte fikur. Para kësaj, Alma ishte anëtare e Bordit mbikëqyrës të kësaj organizate dhe YIHR-a në Bosnje dhe Hercegovinë funksiononte vetëm një vit.

Pra, organizata duhej të ngrihej tërësisht nga hiri nga para, dhe mendoj se në atë kohë isha mjafshëm e gatshme për të pranuar një sfidë të tillë".

Para Nismës, Alma punoi në Komitetin Ndërkombëtar të Shpëtimit (International Rescue Committee) gjatë dhe pas luftës. Në atë kohë, ajo ishte ndër të paktët njerëz që arriti të udhëtonin nëpër të gjithë Bosnjën dhe Hercegovinën gjatë kohës së luftës, duke kaluar kufijtë e Kroacisë dhe Serbisë. Almën e kishin ndalur, arrestuar dhe mbyllur.

Kështu që, pavarësisht se kam parë dhe kam mbijetuar  
merre të ndryshme, mendoj se kjo pjesë e punës më  
ërcaktoi disi për gjithçka që do të ndodhte më vonë dhe  
farë do të bëja, dhe kjo është pikërisht përpjekja për të  
dihmuar njerëzit e zakonshëm që të mos behen viktima.  
Pasi kaloi në Komisionin Ndërkontrollor për të Zhdukurit në  
itën 1999, ajo u mor me pasojat e luftës, përkatësisht me  
të që i bënte njerëzit më së shumti "të kthenin kokën" –  
iq janë varret masive.

Yupi, lufta mbaroi, rroftë paqja, le të vazhdojmë ne, dhe  
eshtë pikërisht vështirësi e madhe të përballohen ato  
pasojë”.

Sidomos pas luftës në Bosnie dhe Hercegovinë, e cila u krye përfundoi as me fitues e as me humbës, por të gjithë nundën të interpretoton historinë dhe faktet e luftës në një niveli që është qëndruar nga vende të ndryshme.

Ajo që mësoi gjatë punës së saj është se njerëzit që kanë uajturi më shumë në luftë dhe kanë humbur të dashurit e tyre janë në fakt njerëzit që përpilen më shumë pér paqen lhe ndërtimin e besimit

Ajo i përshkruan të rintjtë me të cilët ka punuar në YIHR si aktiviste dhe aktivistë të jashtëzakonshëm, të cilët për atë e përfaqësojnë pasurinë më të madhe të kësaj organizate. Dhe ajo që në fakt është përmua më e vlefshme nga të gjitha, është se ata janë ende miq të shkëlqyer dhe që hapesh i shoh disa foto të tyre të përbashkëta në Facebook nga dasmat, festat, ditelindjet e fëmijëve, nga udhëtimet e përbashkëta, pushimet verore".

Dhe kjo për mua personalisht është vlera dhe pasuria më e madhe e Nismës".

Megjithatë, ka pasur presione dhe kërcënime të shpeshta politike ndaj Almës, si dhe ndaj aktivistëve dhe aktivisteve të tjerë të Nismës. Ata u quajtën "helmues të të rinje" që përhapin gjenjeshtra dhe të pavrëteta, për shembull gjatë punës në projektin "Harta e gjenocidit në Srebrenicë".

Kjo nuk i pengoi ata të shtyjnë kufijtë me aktivitetet e tyre. Si një nga aktivitetet e shumta të Nismës në të cilat ka marrë pjesë, me vështirësi mund të veçojë kampin në Kozarac, i cili është një "hit absolut dhe numër një". Kampi u pasua nga "Shkolla e kujtimeve të ndryshme" e nxitur nga aktivistet dhe aktivistët në Stocë dhe Focë.

"Ishte një projekt kaq popullor dhe efektiv, saqë mund të shumëfishohej lehtësisht në zona të tjera të Bosnjës dhe Hercegovinës, veçanërisht në komunitetet e ndara dhe ato larg qyteteve më të mëdha."

Këtu është edhe "Docu Corner" i Festivalit të Filmit në Sarajevë, i cili nisi si "askush dhe asgjë në disa cepa të kafeneve", por shumë shpejt u bë pjesë e pazëvendësueshme e programit. Veçon edhe "Ditet e Sarajevës" në Beograd, ku artiste dhe artistë si Amira Medunjanin, Damir Imamoviq dhe Dubioza kolektivi u prezantuan para publikut të Beogradit.

Kur u largua Alma nga Nisma në vitin 2017, vendosi të linte gjithçka pas. Disa vite më parë i vdiq i shoqi dhe iu përkqësua shëndeti, për këtë arsyе vendosi të shpërndalej në Barcelonë.

Edhe pse orari i saj është mjaft i ngjeshur për shkak se jeton mes Barcelonës dhe Kieveit, ajo nuk e lë ditëlindjen e Nismës "për asgjë në botë", kështu që padishim këtë nëntor do të jetë në Beograd.

"Dhe t'ju takoj juve fëmijët e rinj, që jeni rritur në Nismë, dhe thjesht t'ju shpreh nderin dhe respektin që vazhdoni të mbani pishtarin, i cili u ndez 20 vitesh më parë dhe po përcillet brez pas brezi. Dhe duhet ta them, me shumë sukses".

Për Almën, Nisma ka qenë gjithmonë vend që ka dhënë një nxitje për të menduar ndryshe; Projektet e Nismës nuk ishin "të kallupuar" – është gjithmonë diçka më e mirë, më e quximshme, më këmbëngulëse dhe më të vrashdë.

# NEDIM JAHIQ

# NISMA ËSHTË POPULLI YT - NJERËZIT QË MBLEDH



Nedim Jahiq

vullnetar, koordinator projekti, bashkëpunëtor i jashtëm, YIHR Bosnjë dhe Hercegovinë, 2008 – 2014, tani *Engagement and Outreach Director* në USAID.

Nedimi dëgjoi për Nismën për herë të parë kur aplikoi për të marrë pjesë në punëtorinë e tyre, të mbajtur në Fakultetin Juridik në Sarajevë. Tema ishte ballafaqimi me të kaluarën, e cila nuk kishte shumë rëndësi për të. Megjithatë, ai u drejtua nga mendimi që dëgjoi në fillim të studimeve të tij: përfshirja në çdo trajnim dhe seminar sepse është e mirë për CV-në.

Atëherë shkruaja për disa media online në BeH në atë kohë, okusi im ishte në disa anë të tjera. Në thelb, Nisma u bë një orniزë e mirë për mua për të vepruar në atë kohë".

Nedimi kujton kur vizitoi Beogradin me Nismën si pjesë e programit për të rinjtë. Edhe pse nuk është shumë për njohje, akoi shumë njerëz të rinj me shaka të mirë. Pas kthimit në sarajevë, i frysmezuar nga vizita, ai mori pjesë në nisjen e ushatës "Qytetar, unë jam ai". Ata bënë postera dhe një grup në Facebook dhe filluan të mbledhin njerëz. Ai ishte 19 vjeçë atë kohë. Ata mblodhën firma për peticione, vendosën bankarta në Banja Llukë dhe "në mes të natës" ndaloj policia.

Një grup nga Sarajeva, duke vendosur pankarta, pankarta është alfabetin cirilik. Asgjë nuk është e qartë për askënd. Në shuan.”

Nga udhëtimet e shumta me Nismën, veçohet Beer Fest 2008 në Beograd. Më pas ai mori pjesë në një diskutim për gresionin e Rusisë kundër Gjeorgjisë, pesë veta rrinë atje lhe të gjithë presin me padurim që të përfundojë diskutimi lhe pastaj të vazhdojnë për në Ushqen.

Edhe pse ai kishte "njoħuri tħad paktē" pér shumicen e temave, jaellimi i tħix nsejja kohi isħieġ - ndryshimi i vendit.

Vizitojmë pak vendet e krimeve të luftës. Lexojmë pak përato. Kemi shkruar disa aktivitete interesante. Mblodhën njerezë kombësive të ndryshme, ideale për çdo donator. Një histori ngrohtë njerezore. Na u desh shumë kohë për të kuptuar se ishim bërë hapa të mëdha”.

Pas tre viteve të përfshirjes së Nedimit në Nismë, erdhiti 2011 dhe një ngjarje e madhe: ai foli për gjendjen e të drejtave të njeriut në Bosnie dhe Hercegovinë para Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë.

Stili i Emma Watson-it. Vetëm me një kostum të dobët, nendoj se ishte fjalë për fjalë mature. Por nuk ishte si një djalë epse isha i ri. U larguam se vdiqëm duke punuar, shëtitëm vendin, mblodhëm qindra nënshkrime. Ne tingëlluam më mirë se delegacioni zyrtar i Bosnie-Hercegovinës, gjë që shtë edhe e mirë edhe e tmerrshme në të njëjtën kohë".

Krahas së gjithave ka pasur edhe "mijëra dështime" gjatë punës në Nismë. Për shembull kur u mblohdhën nënhkrime

për aktivistët e "Nismës Ime" në Mostar, në verë në 40 gradë. Bashkia u dha leje për të ngritur një stendë në atë ditë shurmë të nxehët. Nënshkruan vetëm "një njeri e gjysëm".

"Ne bëmë një protestë para Flakës së Përjetshme në Sarajevë në Ditën e shtetit. Gjysma e ekipit është e përgjumur, por unë i bëra që të ngrihen dhe të vijnë. Çmenduri. Pastaj dalim në të gjitha gazetat, sepse në atë kohë në BeH nuk kishte njeri që të bënte "sit-inet" dhe gjëra të ngjashme".

Që nga viti 2012, Nedimit "iu prish pak filmi", dhe iku të merrej me tema të tjera. Mirëpo, edhe atëherë ka qëndruar pranë Nismës. Në bashkëpunim me YIHR-ën, organizoi "Shkollën e Kujtimeve ndryshe", e cila bazohet në idenë se të folurit për fakte nuk funksionon në dialogun ndërretnik në BeH. Kjo është arsyja pse vendosën t'u japin fëmijëve një hapësirë për të dëgjuar shumë këndvështrime të ndryshme. Me atë rast ata vizituan pothuajse të gjithë vendin.

Nedimi thotë se nuk e di më kush është Nisma, por se është mirë.

"Sepse duhet të jetë një vend ku vijnë njerëz të rinj gjatë gjithë kohës, mësojnë diçka dhe ecin përpara – përhapin ide e kështu me radhë." Do të doja të njihja këta njerëz të rinj. Si këta që më dërguan email-in që ta shkruaj këtë. Atë djalin që më tha të dërgoja tezat pér disa pyetje, kjo është ajo që u them të gjithëve në punën që bëj – kur pres që ai përtón të shkruaië dhe nuk do të shkruaië asqë me kuptim."

Shumica e miqve të tij janë të lidhur me Nismën. Nedimi pretendon se nuk ka të bëjë shumë me Nismën, sësa me dëshirën për të bërë piesë të kësaj organizate këdo që njeh.

"Kemi marrë shumë rreziqe në rini, me tekste, qëndrime, veprime, të gjithë na thoshin të mos ngatërroheshim, se më mirë të mbarojmë fakultetin dhe gjithë ato mutra". Por, kemi mbaruar gjithçka, punojmë, nuk kemi dështuar në jetë. Por ne e ndajmë atë pjesë të jetës dhe e fusim atë në gjithçka që hasim. Në fund të fundit, kjo është Nisma. Njerëzit e tu – të cilët i mbledh".

Ka vazhduar të ndjekë temat në të cilat beson dhe thotë se puna e tij aktuale bazohet në përvojën që ka fituar në YIHR.

MARIO MAZHIQ

# NISMA ËSHTË KORNIZË QË MË INKURAJOI TË THEM ATË QË DUHET THËNË DHE ATË QË NUK DO TË GUXOJA TA THEM SI INDIVID



Mario Mazhiq

themelues i YIHR-së në Kroaci 2008-2018;  
themelues dhe konsulent kryesor në  
Europe&Southeast Consultancy.

**Gjatë shkollës së mesme në Petrinjë, Mario Mazhiq themeloi grupin e të rinjve të Komitetit Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, fokusi i të cilët ishte edukimi rajonal i të rinjve për të drejtat e njeriut. Më vonë, përmes procesit të KOMRA-s, ai u takua me njerëz nga rajoni të cilët janë pjesë e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, dhe në vitin 2008 vendos që të themelojë Nismën edhe në Kroaci.**

“Në atë kohë Nisma ishte rajonale, por ne e kemi regjistruar si organizatë kombëtare në Kroaci, gjë që më vonë ka ndodhur edhe në organizata të tjera në rajon. Pas kësaj, nënshkruam një memorandum bashkëpunimi. Për ne ishte e rëndësishme që Nisma Rajonale të ishte zëri i një brezi të rinjsh që, me punën e tyre në organizatë, ngrihen kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut nga e kaluara dhe trashëgimisë së tyre”.

Në të njëjtën periudhë kur Mario themeloi Nismën, Kroacia ishte në negociata me Bashkimin Evropian, të cilit iu bashkua në vitin 2013.

“Kishte një nivel të lartë të identifikimit të publikut të gjerë me të akuzuarit dhe të dënuarit për krimet luftë. Ishte një periudhë negociatash dhe pune intensive me BE-në. Kishte pyetje të veçanta për të drejtat themelore, bashkëpunimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, i dhanë së shumti formë punës së Nismës në atë kohë. Ne supozuam se nuk ka shumë vëmendje dhe mbështetje në sektorin institucional apo politik, por se duhet të përdorim procesin e anëtarësimit dhe negociatave me BE-në si një lloj mundësie për të ndikuar në proceset politike”.

Në vitin 2012, gjatë fellowship në Universitetin e Columbias në Nju Jork, Mario filloi të zhvillonte programin rajonal të Nismës “Narrativat e përbashkëta”. Ideja ishte që të mblidheshin njerëz që nuk janë aktivistë, të cilët i ndau lufta, t'i lidhin ata me njëri-tjetrin dhe t'u mundësohet dialogu. Ideja e Marios pati sukses dhe më vonë këtë program e kaluan mbi 150 të rinj nga i gjithë rajoni. Mario beson se nisma KOMRA është gjithashtu një projekt veçanërisht i rëndësishëm që do të mundësonë vërtetimin e faktave në nivel rajonal dhe promovimin e perspektivës së „tjetrit” përmes dëshmive publike dhe proceseve publike të ballafaqimit me të kaluarën.

„Ne kemi ende një nivel të lartë të keqkuptimit të perspektivës së të tjerëve. Nuk them që viktima duhet të kuptojë këndvështrimin e dhunuesit, por duhet të kuptojë këndvështrimin e një shoqërie tjetër”.

Pavarësisht sulmeve dhe presioneve ndaj Nismës, ai nuk u tremb asnjëherë. Ai e ndjente se nëse do të provokon çfarëdo lloj reagimi, bëjnë gjënë e duhur.

„Më dukej se efekti më i keq që mund të kemi është heshtja, se nuk na marrin parasysh dhe nuk na dëgjojnë. Nga kjo kisha frikë, kjo ishte frika ime”.

Nisma ka kryer edhe hulumtime për krimet e luftës, sepse kanë vërejtur se, pavarësisht nga presioni i BE-së në atë kohë, nuk po bëhej mjaftueshmë për t'i ndjekur penalistik. Mario thekson se krimet e kryera nga forcat kroate në Kroaci dhe BeH janë veçanërisht të neglizhuara dhe se ka raste që publiku i gjerë nuk i di.

„Ne bëmë kërkime mbi krimet kundër serbëve në Vukovar në verën e vitit 1991, për „Blesak”, për „Ollujën” dhe krimet të tjera, dhe i treguan publikut dhe institucioneve të BE-së se Kroacia nuk bën atë që thotë se po bën.”

Gjithashtu, Mario thekson se është i rëndësishëm projekti i Nismës “Rrjeti i politikanëve/eve të rinj/reja” (Political Youth Network) i cili bashkon njerëz nga sfera politike. Të rinjtë flasin me njëri-tjetrin dhe me politikanë të njohur se çfarë do të thotë të jesh një qytetar politikisht aktiv, i cili e mbështet punën e tij në vlera të caktuara.

Mario ishte drejtor programi i Nismës në Kroaci deri në vitin 2018. Largimi nga organizata për të si themelues ishte mjaft i vështirë.

„Unë mendoj se mund të jetë e rrezikshme për një organizatë kur njerëzit nuk e dinë se kur është koha për t'u larguar. Për mua ishte e rëndësishme që Nisma të ketë një ekip që është funksional dhe që do të mbajë sinqerisht vlerat e saj. Gjithashtu, ishte e rëndësishme për mua që të vendosja disa projekte kyçe para se të largohesha”.

Pas largimit nga Nisma, shkoi për studime master të Zhvillimit Ndërkombëtar dhe Politika në Çikago, në gjeneratën inauguruese të Obama Foundation Scholars, dhe më pas filloi të punojë si konsulent kryesishët me organizata ndërkombëtare, fondacione dhe njerëz që kontribuojnë për të drejtat e njeriut dhe paqen ndërkombëtare.

„Mendoj se Nisma është çështje gjenerative dhe se perspektiva përsa i përket luftës dhe konflikteve në rajon është thelbësishët e ndryshme në varësi të gjeneratës. Është e rëndësishme që hapësira në Nismë t'u dedikohet njerëzve të rinj dhe të jetë platformë për gjeneratat e reja”. Në vitin 2019, Mario mori çmimin francez për të drejtat e njeriut „Liberté, Egalité, Fraternité” në emër të Nismës për projektin „Narrativat e përbashkëta”.

## LIBRI „NARRATIVAT E PËRBASHKËTA“

Libri „Narrativat e përbashkëta“ është rezultat i përpjekjeve të më shumë se 180 të rinjve nga pesë vende post-jugosllave për të marrë pjesë në procesin e krijimit të rrëfimeve të përbashkëta për ngjarjet më të diskutueshme gjatë luftërave të viteve të nëntëdhjeta në vendet post-jugosllave.

Në vitin 2019, Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kroaci iu dha çmimi i Republikës së Francës për të drejtat e njeriut „Liri, Barazi, Vëllazëri“ për projektin „Narrativat e përbashkëta“, dhe çmimin e dorëzoi Kryeministri i Qeverisë së Francës.

Ky projekt la një përshtypje të fortë te shumë pjesëmarrës dhe pjesëmarrëse, dhe ata vazhduan të zhvillojnë dhe përmirësojnë angazhimin e tyre duke punuar me organizatat e shoqërisë civile të dedikuara për ndërtimin e paqes dhe pajtimin. Ata gjithashtu kontribuan akademikisht dhe vazhduan arsimimin e mëtejshëm në fushën e zgjidhjes së konfliktive.

Metodologjinë e Narrativave të përbashkëta si një qasje për të mësuar rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe kimeve të luftaş që kanë ndodhur në të kaluarën ua kemi prezantuar ekspertëve dhe eksperteve të shumtë, si dhe aktivistëve dhe aktivisteve të përkushtuar ndaj ndërtimit të paqes dhe krijimit të narrativave të përbashkëta në pjesë të ndryshme të botës.



VISAR MEHMETI

# YIHR-A MË NDIHMOI TË HEQ BARRIERAT



**Visar Mehmeti për herë të parë dëgjoi për YIHR-në në fillim të vitit 2008, kur u bë thirrje për të rinjtë nga Presheva që të marrin pjesë në një program shkëmbimi të përvojave.**

**I riu nga komuna me shumicë shqiptare në jug të Serbisë, më vonë do të bëhej Koordinator i organizatës për këtë komunë.**

"Kjo thirrje kishte të bënte me organizimin e një vizite 2-3 ditore të të rinjve preshevare në Beograd dhe Novi Sad e që për atë kohe ka qenë hera e parë që organizohej një gjë e tillë duke e ditur që mes të rinjve të Luginës së Preshevës dhe Beogradit, ose thënë ndryshe qyteteve të Serbisë, ka pasur shumë bariera, të cilat ende ekzistojnë", thotë Mehmeti.

Konteksti politik i kishte ndihmuar mjaft ngritjes së barrierave. Territori me tre komuna me shumicë shqiptare në vitet 2000 dhe 2001 kishte kaluar nëpër një rezistencë të armatosur të shqiptarëve ndaj policisë së Serbisë e cila përfundoi në pranverë të vitit 2001 me një marrëveshjeje politike.

"Ka qenë periudhë jo shumë larg konfliktit të vitit 2001 në Luginë, dhe ka qenë një klimë e zbehtë. Shumë pak njerëz ose edhe OJQ janë marrë me avancimin e të drejtave të shqiptarëve dhe integrimin e tyre", kujton ai. Mehmeti thotë se qëllimi dhe fokusi i YIHR-së, siç tregon vet emërtimi i organizatës, kanë qenë të rinjtë, informimi dhe vetëdijesimi i tyre për të kaluarën e afërt në territorin e ish-Jugosllavisë.

Edhe në punën që bën tash e pesë vjet, Mehmeti thotë se është duke u shërbyer nga përvoja që ka fituar me YIHR-ën. Ai thotë se gjatë periudhës dyvjeçare, sa ka qenë Koordinator i YIHR-së në Preshevë, ka qenë pjesë e shumë aktiviteteve të organizatës të cilat u kanë ndihmuar të rinjve nga Presheva që të njihen dhe shkëmbejnë përvoja me moshatarë të tyre nga rajoni.

"Një tjeter aktivitet që vlen të theksohet ka qenë vizatimi i grafikave për tekstet shkollore në gjuhën shqipe si dhe pranimi i diplomave, aksion që ishte pasqyruar shumë në mediat e Kosovës dhe Serbisë", thotë Mehmeti.

Përveç këtyre, YIHR-a kishte organizuar edhe trajnime të ndryshme për të rinjtë. Edhe në aspektin personal, Visar Mehmeti thotë se YIHR-a i ka ndihmuar mjaft.

"Duke e ditur se Presheva ka qenë dhe ende është shumë pak e integruar, mund të them se shumëka ka ndryshuar tek unë, përfshirë paragjykimet dhe barrierat që i kemi pasur ndaj të tjerëve, e kjo ka ardhur si rezultet i mungesës së kontakteve me moshatarëtanë në rajon", nënizon ai.

Mehmeti thotë se gjatë një praktike që e ka bërë në zyrat e YIHR-së në Beograd i ka rënë të merret me hulumtimin e krimeve të luftës të kryera në Kosovë nga forcat serbe me fokus në vrasjet e familjes Bogujevcit në Podujevë dhe familjes Berisha në Suharekë por edhe me rastin e vrasjes së vëllezërve Bytyqi në vitin 1999.

Ai ka qenë edhe pjesë e "New Policy School", një shkollë e organizuar nga YIHR-a, e cila zgjati gjashtë muaj dhe kishte synim mësimet bazë për të drejtat e njeriut, drejtësinë tranzicionale dhe integrimet europiane.

"Shumë pak organizata në rajon ka pasur në atë kohë që janë marrë me promovimin e të drejtave të njeriut, ballafaqimin me të kaluarën, e mos të flasim për Preshevën. Për ne këtu, YIHR-a ka qenë diçka krejt ndryshe, e ajo që e bën edhe më të veçantë është fakti se është e themeluar nga të rinjtë, ku vlerat e kësaj organizate kanë qenë drejtësia, liria, demokracia dhe paqja", thotë Mehmeti.

MAJA MIQIQ LLAZOVIQ

# PËR MUA NISMA ËSHTË NJË ANGAZHIM, NJË SISTEM VLERASH DHE NJË VENDIM JETËSOR



Maja Miqiq Llazoviq

drejtore e YIHR-së Serbi nga 2010-2014.

**Maja Miqiq Llazoviq iu bashkua Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi në vitin 2008. Ajo ishte 24 vjeçë, sa po kishte mbaruar fakultetin juridik dhe nuk kishte qenë kurrë më parë aktiviste. Ajo ka dëgjuar për Nismën nga mediat dhe ka vendosur të aplikojë për pozitën e studiueses për të drejtat e njeriut. Në intervistën e punës, ajo kuptoi se kjo ishte ajo që donte të bënte.**

"Nisma nuk ka qenë kurrë punë, Nisma ka marrë frymë dhe ka jetuar. U pendova që nuk u anëtarësova më herët, dhe nga ana tjeter, pikërisht për këtë shfrytëzova rastin për të qenë me zë të lartë dhe për të shprehur një rebelim që mund të ketë qenë i fjetur në vitet e mëparshme.

Gjithmonë e kam ndjerë se jam e privilegjuar dhe se më e pakta që mund të bëj është të ekspozoj veten, të jem zë dhe t'u krijoj hapësirë atyre që nuk e kanë atë privilegji dhe që kërcënohen çdo ditë për shkak të asaj që janë".

Ne kemi besuar se disa gjëra në shoqëri do të ndryshojnë. Me kalimin e kohës mendoj se kemi hyrë në vitet e zhgënjimit".

Maja thotë se gjatë kohës së saj në YIHR, ka pasur një atrim domethënës mes Beogradit dhe Sarajevës dhe përmes festivalit "Ditët e Sarajevës" organizuar nga Nisma që nga viti 2007. Disa nga artistët, thotë ajo, erdhën në Beograd për herë të parë pas luftës, dhe tanë ata janë mysafirë të rregullt.

"Për ne ishte shumë e rëndësishme të flisnim për rrithimin e Sarajevës. Mbaj mend që në vitin 2009 isha e ftuar në RTS për disa minuta në 2009 dhe sa po gjeta rastin të flisja përtë para se të më ndërprisin. Ishte një punë kaq e madhe përmua."

Ajo është veçanërisht krenare për Paradën e Mesnatës në Beograd në vitin 2013, e cila u organizua pasi Parada u ndalua përsëri zyrtarisht.

"Shumë prej nesh punuam bashkë në Paradën e Krenariës dhe sërisht na ndaluan të ecnim. Ishte një poshtërim i madh përmua, nuk mund të pranoja që të kishim vetëm një konferencë më shumë dhe Krenarinë në katër mure. Dhe atë mbrëmje ne ecëm, spontanisht dhe sinqerisht".

Maja tregon se "ishin të rinj dhe hapat e vegjël i inkurajonin", por mundësitetë e Nismës ishin të kufizuara.

"U largova nga Nisma në momentin kur mendova se po e dëmoj organizatën me negativitetin tim. Gjithçka u rrëzua përmua në një moment, mendova se ishte fajt ynë që nuk arritëm të ndryshonim botën. Vendosa që është koha përtë ecur përpëra dhe për t'ua lënë atë hapësirë të rinjve që kanë besim dhe entuziazëm të pandotur dhe që nuk janë cinikë. Doja t'ia dorëzoja Nismën gjeneratës së dytë – me sa më pak ngarkesë dhe të shëndetshme organizative".

Maja ende shpesh analizon se çfarë ishte Nisma në jetën e saj dhe beson se ajo e ndihmoi të ndërtonte gjithçka që do te vetja.

"Kur flas për Nismën është një emocion. Dikur kishte shumë pakënaqësi dhe zhgënjime, sepse ne donim të arrisnim shumë, dhe arritëm shumë pak sipas standardeve të mia në atë kohë. Duke u pjekur dhe duke e parë botën jashtë flluskës së universit të mrekullueshëm të Nismës, gjithçka më merr një vlerë dhe peshë të re dhe bëhet më e rëndësishme sesa kur isha pjesë e roganizatës në një nivel operacional dhe të përditshëm."

Puna në Nismë mbartte një "rrezik" për shumë aktivistë dhe aktiviste: ndër të tjera, që njerëzit që ata i konsideronin të afërt nuk do t'i kuption dhe nuk do t'i mbështesnin. Disa madje u larguan ngajeta e tyre sepse nuk mund të kuption se përfshirë luftonte Nisma, ose nuk ndanin të njëjtat vlera.

Në të njëjtën kohë, Maja thotë se për shkak të Nismës, në jetën e tyre erdhën disa njerëz të rinj me të cilët kuptoheshin "pa folur", me të cilët ndanë luftën për diçka më të rëndësishme se vetja dhe të cilët vetë i zgjodhën, të jenë më shumë se miq, të jenë një familje.

MASHA GJURIQ

# NISMA ËSHTË RINIA & GUXIMI, ME KOKËN NËPËR MUR



**Në maj 2008, Masha ishte 17 vjeçare dhe ishte aktive në Partinë Liberale Demokratike (LDP, shqip – PLD). Ndonëse nuk kishte ambicie politike, PLD ishte një vend për njerëzit që ndanin ide dhe vlera të rëndësishme për të: pajtimi në rajon, liria dhe barazia para ligjit për të gjithë dhe Serbia në Evropë.**

## Masha Gjuriq

aktiviste 2008-2013, komunitet/menaxher marketingu (2013-2016), sot merret me marketingun dixhital në kompaninë e saj.

"Idetë dhe rruga për të cilat duhet të luftojmë dhe bindim ende sot, ndoshta edhe më shumë se atëherë". Deri në atë maj 2008, për Mashën, PLD ishte i vetmi vend për të cilin dinte. Dhe më pas, rastësisht, gjatë fushatës së atij viti, në vend të stendës së PLD-së, ajo shkoi në stendën e Nismës, ku ishte atëherë Lëvizja Nisma Ime, e cila ishte në fushatën GOTV Të rëndësishëm jemi NE.

"Më vjen mirë që profesorët më kanë drejtuar në një fare mënyre drejt Nismës dhe PLD-së. Profesori i skulpturës që më takoi në konferencën finale të PLD-së (në të cilën më çoi nëna ime) më vonë më ftoi të bashkohesha me partinë, të vija në mbledhjet e bordit etj., dhe profesoresha e edukimit qytetar na ftoi të merrnim pjesë në veprimin flash mob Serbia u ndal.

Dhe mendoj se kjo e pëershruan më së miri klimën politike: sado e papërshtatshme ishte që profesorët të të "rekrutonin" në aktivizëm, përmua ishte normale dhe e pranueshme, ashtu siç ishte edhe për nënën time. Ne ishim në anën e duhur. Dhe se kufiri ishte shumë i quartë atëherë".

Pas këtyre viteve aktiviste, në vitin 2012, Masha gjeti punën e vërtetë, por jo te Nisma, sepse ishte e paimagjinueshme të punonte atje; Për të, nisma ka qenë gjithmonë "një hobi dhe ajo që bëj për dashuri; një vend ku mblidhem me ata me të cilët ndaj jo vetëm idetë, por edhe vlerat. "

Mirëpo, ajo filloi punën në Nismë me ftesë të drejtoreshës së atëherëshe Maja Miqiq. Gjatë tre viteve të ardhshme, nga 2013-2016, ajo ka punuar si menaxhere marketingu dhe komuniteti, por është marrë edhe me projekte të ndryshme dhe komunikim dhe produksion në YIHR në kuptimin më të gjerë të fjalës. E pyetur se cilat janë iniciativat e saj të preferuara të Nismës në të cilat ka marrë pjesë, Masha thotë:

"E gjithë kjo kërkonte kurajo shtesë, por do të veçoja dy: Krenaria e mesnatës 2013, dita kur pushtuam rrugët e Beogradit, kur thamë mjaft, kur pushuam së frikësuari dhe ditën pas së cilës nuk kishte më kthim. Ajo fjalë e vështirë e huaj gjenocid, kur dolëm e shkruam para Kuvendit".

Masha u ndikua më së shumti nga vitet që kaloi në Nismën time 2008-2013, para së gjithash sepse, siç thotë ajo, Nisma ishte një dritare drejt rajonit në një kohë kur rajoni në Serbi shmangej dhe kur kishim dritare drejt botës dhe Evropës. Kështu, Masha ishte ndër të parët e gjeneratës së saj që vizitoi Sarajevën, Zagrebin dhe Prishtinën - përvoja që e ndryshuan atë përgjithmonë dhe lindën miqësi që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Disa muaj para se të punësohej në Nisma, ishte në një program vizitor në Sarajevë, në Festivalin e Filmit në Sarajevë.

"Aty (më mirë) u njoha me Ivanin, bashkëshortin tim dhe babanë e vajzës sime, me të cilin më vonë punova në Nismë.

Kjo përcaktoi jetën time, jo vetëm privatisht, por edhe profesionalist – sepse aty mësova shumë gjëra, duke përfshirë edhe pse nuk duhet të punosh kurrë me njerëzit që do".

Ajo u largua nga Nisma në fillim të vitit 2016, për arsyen personale dhe profesionale: "Njohuritë dhe interesat e mia i kaluan nevojat e organizatës dhe në të njëjtën kohë, marrëdhëniet e mia personale u përkeqësuan". Ishin vite shumë emocionale dhe të vështira. Për fat të mirë, ne dolëm më të mençur dhe tanë e kujtojmë të gjithë periudhën për të bukurën".

AZRA JASEVIQ

# NISMA ËSHTË ZËRI I ARSYES NË NJË KOHË ÇMENDURIE



Azra Jasević

koordinatorka programa za pružanje besplatne pravne pomoći od 2008. do 2012. godine, YIHR Crna Gora, advokatkinja u svojoj kancelariji u Podgorici.

**Azra Jaseviq iu bashkua Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Mal të Zi në vitin 2008. Me profesion avokate, dëshironte të kontribuonte në forcimin e shoqërisë civile, sundimin e ligjit, si dhe anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian. Në atë kohë, Mali i Zi zyrtar nuk kishte fuqi të përballej me rolin e tij famëkeq në ngjarjet e luftës në territorin e ish-Jugosllavisë gjatë viteve të nëntëdhjeta. Nxiste një politikë mosndëshkimi për krimet e luftës, prokuroria ishte joefektive dhe gjyqësori ishte i kontrolluar politikisht, kështu që sektori joqeveritar i kishte duart plot me punë, kujton Azra.**

Ajo edhe sot beson se Nisma "punon në shërbim të qëllimeve të saj, dhe jo granteve" dhe është mirënlohëse për mundësinë e jashtëzakonshme për të bashkëpunuar me njerëz me të cilët ndan të njëtin sistem vlerash.

"Përmes veprimeve të përbashkëta u zhvendosën kufijtë e respektimit të të drejtave të njeriut në Mal të Zi, sepse pas rasteve të fituara në gjykatën e Strasburgut, të cilat i drejtova si avokate kundër shtetit të Malit të Zi në lidhje me rastet e torturës dhe diskriminimit policor, Mali i Zi zyrtar mësoi mësimet e para nga sundimi i ligjit."

Në atë kohë, Nisma e të Rinjve në Mal të Zi ofronte ndihmë juridike falas në rastet e shkeljeve drastike të të drejtave të njeriut para gjykatave vendase. Azra përfaqësoi qytetaretët dhe qytetaretët në ato procese:

"Meqenëse Nisma në Mal të Zi promovoi lidhjen dhe bashkëpunimin pas konfliktit të të rinjve që u përkasin komuniteteve të ndryshme në territorin e ish RSFJ-së (që në atë kohë më dukej një mision i rëndësishëm dhe i vështirë), unë me kënaqësi vendosa potencialet e mia personale dhe profesionale në shërbim të kësaj organizate.

Me projektet e Nismës që i drejtova si avokate, u hodhën themelët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pas së cilës nuk pati më misione të pamundura në atë fushë në Mal të Zi".

Disa nga viktimat e përfaqësuara nga Azra ishin Dalibor Nikeziq dhe Igor Miliq – një rast i torturës së rëndë në burg. Meqenëse humbën të gjitha procedurat para gjykatave malazeze, Azra filloi procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, e cila në vitin 2015 vendosi në favor të Nikeziqit dhe Miliqit.

"I njëjti skenar është përsëritur edhe në rastin e Riza Alkoviqit, i cili si pjesëtar i popullatës rome është

diskriminuar në baza fetare dhe kombëtare. Gjykatat vendase nuk patën kuptim për shkeljen e të drejtave të tij dhe ai u kënaq me angazhimin e zyrës sime të avokatisë në vitin 2017 para gjykatës në Strasburg.

Këto vendime të karakterit pionier, më vonë shërbyen si shembuj shembullor për institucionet malazeze se si nuk duhet të veprojnë më në çështjen e të drejtave të njeriut".

Në rastin e Prela Gjokiqit, një shtetas malazez me kombësi shqiptare, i cili u rrah nga një polic, Azra arriti të marrë një dënim me 3 muaj burgim efektiv në gjykatat vendase. Ky ishte një nga vendimet e para me një dënim efektiv me burg për një rast të torturës policore në Mal të Zi.

Azra thekson se puna në Nismë drejtoi rrugën e saj profesionale. Gjyqësori dhe prokuroria e kontrolluar rreptësisht politikisht ishin "të pjkur për ndryshim". Ajo ka qenë aktive në Nisma deri në vitin 2012, kur edhe hyri në politikë. Në periudhën 2012-2017 Azra ka qenë deputete në Parlamentin e Malit të Zi dhe nënkyetare e Qeverisë së Trustit Zgjedhor, si dhe nënkyetare e partisë politike Mali i Zi Positiv pas themelimit të saj nga viti 2012 deri në vitin 2017.

Në këtë këndvështrim, Nisma ishte për Azrën një "kapsull fillestare për realizimin e mundësive personale dhe profesionale". Në nivelin profesional, ajo hodhi dritë mbi "thellësinë e humnerës në të cilën gjendej drejtësia në Mal të Zi në fillim të viteve 2000", e cila e çoi atë në ujërat politike dhe forcoi ambicjen e saj për të krijuar një shoqëri më të drejtë dhe demokratike.

"Që nga viti 2012 nuk kam asnjë pozitë në Nismë, por ndjek dhe përkrah një numër të madh aktivitetesh".

„Od 2012. godine, nemam nikaku poziciju u Inicijativi, ali pratim i podržavam veliki broj aktivnosti.“


## **LUFTA PËRMES INSTITUCIONEVE: RASTI ALKOVIQ KUNDËR MALIT TË ZI**

Lufta kundër diskriminimit dhe dhunës është një nga luftimet më të rëndësishme, sepse luftohet kur themi qartë dhe publikisht se nuk pajtohem me të. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Mal të Zi i ofroi ndihmë juridike falas Riz Alkoviqit, një mysliman rom, për shkak të një sërë sulmesh të motivuara etnikisht dhe fetarisht nga fqinjët e tij. Rizo Alkoviq e paditi Malin e Zi para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të së drejtës për shtëpi dhe ndalimit të diskriminimit. Ai e dorëzoi petition në Gjykatën Evropiane pasi u largua nga Mali i Zi me familjen e tij dhe mori azil në vend tjetër. Gjykata dalloi këtu dy sulme. I pari, që ndodhi në maj 2009, kur fqinji i tij nxori pistoletën nga makina dhe qëlloi me dhjetra plumba drejt tarracës së tij. Dhe i dyti, nga shtatori i po atij viti kur Alkoviqi festonte Bajramin me familjen e tij. Atëherë në derën e banesës së tij ishte vizatuar një kryq ku ishte shkruajtur: „Shpërnguluni ose do të pendoheni thelli“

Kjo çështje është përfunduar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg duke vendosur në favor të Riza Alkoviqit.



# YIHR-A KA BËRË ATË QË DUHET



**Viti 2008 kishte shënuar kohën kur i riu nga Kosova, Dardan Zhegrova, kishte filluar të interesohej për një përfshirje më aktive në çështjen e të drejtave të njeriut dhe mundësinë për këtë angazhim e kishte gjetur tek YIHR-a.**

"Jam përfshirë në YIHR për arsyet e interesimit në aktivizëm dhe të drejta të njeriut. Përveç pjesëmarrjes në disa ngjarje dhe aksione rrujore që janë realizuar nga "Nisma ime" që nga viti 2008, fillimi i përfshirjes time më seriozisht si aktivist në YIHR ka qenë që nga Human Rights School në vitin 2009", thotë Zhegrova.

Si pjesëmarrës në aksione të organizatës që nga ajo kohë, Zhegrova thotë se YIHR-a e ka kryer pjesën e vet të punës.

"YIHR-a si organizatë ka bërë atë është është dashtë të bëjë, atë që ka marrë për të bërë. Çka mund të jetë e veçantë është se disa individë kanë shtyrë përpëra aspekte që kanë rëndësi, mirëpo si organizatë ka bërë atë për çfarë është financuar", thotë ai.

Ai thotë se janë shumë projekte dhe aktivitete që YIHR-a i ka zhvilluar gjatë veprimitarës së vet.

"Mendoj që ka shumë projekte dhe aktivitete që kanë qenë tejet të rëndësishme për kohën dhe situatën në të cilën janë realizuar, mirëpo për mua personalisht më të rëndësishmet kanë qenë aksionet rrujore dhe programet e shkëmbimit me Serbinë", thotë ai.

Zhegrova thotë se është mjaftuar me kontributin që ka dhënë në projekte të tillë si aktivist dhe gjithë kohën ka punuar për ato që mendon e beson.

"Roli im "zyrtar" ka qenë aktivist/vullnetar, mirëpo mendoj që kontributi është çka ka rëndësi dhe jo roli", nënvizon Zhegrova.

Ai thotë se aksionet rrujore dhe projektet e shkëmbimit kanë qenë mundësi e mirë për të që ta praktikojë aktivizmin dhe për të përdorur kreativitetin.

"Bashkëpunimi me aktivistët e tjere krijonte një ndjenjë të fuqisë që mendoj ka ndikuar që bëj edhe sot. Të qenit

i vetëdijshëm për të drejtat që kemi është shtytësi kryesor për të kërkuar ato. Mendoj që gjithmonë kam qenë i vetëdijshëm për atë që më takon, mirëpo YIHR-a/Nisma Ime, e më specifisht Besart Lumi, Besa Luci, Sarah Maliqi, Raba Gjoshi, Marigona Shabiu, Andrej Nosov, e shumë të tjerrë kanë qenë pjesë e rëndësishme në fryshtë e historisë time personale në YIHR-a/Nisma Ime", thotë ai.

Parë në perspektivë, Dardan Zhegrova thotë se pavarësisht ndryshimeve që janë bërë përgjatë viteve, çështja e të drejtave të njeriut ende nuk është në nivelin që duhet të jenë.

"Sado që kanë ndodhur ndryshime, ende nuk kanë ndodhur ato ndryshime që unë dua të ndodhin", thotë Dardan Zhegrova.

"Si aktivist i të drejtave të njeriut ende kam shumë punë për të bërë, ende nuk kemi të drejta të barabarta dhe ende nuk ka ndodhur ndryshimi që duhet të ndodhë", shton ai.

Madje, sipas tij, shkelja e të drejtave të njeriut ndodh edhe në vendin ku do të duhej të mbroheshin ato.

"Ende kemi deputetë të Kuvendit që shprehin lirshëm homofobinë dhe seksizmin e tyre, ende kemi deputetë që vitin e kaluar si përfaqësues të të drejtave të njeriut nuk kanë mbështetur projekt ligjin që do të mundësonte një hap drejt të drejtave të barabarta për qytetarët", thotë ai duke aluduar në Kodin Civil i cili këtë vit nuk mori votat e mjaftueshme në Kuvend për shkak të kundërshtimeve të deputetëve nga të gjitha partitë politike rrëth çështjes së martesave mes gjinisë së njëjtë.

"Kështu nuk mund të them se ka ndryshime që mund të vlerësohen përderisa nuk kemi të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët", shton ai.

BOJAN STANKOVIQ

# MARATONA FILLON ME NJË HAP, POR PËRKUSHTIMI ËSHTË AI QË TË ÇON NË VIJËN E FINISHIT. KJO ËSHTË NISMA PËR MUA.



Bojan Stankoviq

asistent finansiar i YIHR-ës 2008-2010,  
koordinator finansiar i YIHR-ës 2010-2018.  
Drejtore i YIHR-ës që nga viti 2018.

**Pas diplomimit në Fakultetin Ekonomik në Nish në vitin 2008, Bojani dëshironte të transferohet në Beograd. Ai kërkonte punë në ekonomi dhe përmes Infostudit aplikoi në shumë konkurse, duke përfshirë edhe pozicionin e asistentit finanziar në Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut. I zhgënjiyer për shkak se nuk gjeti punë në profesion, pothuajse hoqi dorë nga ideja për t'u shpërngulur në Beograd. Ai do të kishte hequr dorë nga intervista për punë në Nisma nëse nëna e tij nuk do ta kishte bindur të shkonte gjithsesi. Pas kthimit nga Beogradi, në trenin për në Nish, ai merr një telefonatë nga themeluesi i Nismës, Andrej Nosovi: dakordohen që ai të fillojë punën të hënën e ardhshme. Brenda dy ditësh, Bojani u zhvendos në Beograd duke menduar se do të ishte vetëm një "punë e përkohshme". Në "punën e përkohshme" është 15 vjetë.**

"Unë nuk kam ardhur si aktivist, edhe pse kam marrë pjesë në protestat e studentëve në Nish në vitet nëntëdhjetë dhe më 5 tetor 2000 kam qenë një nga të shumtët që e ndryshuan Serbinë për mirë. Përsëri isha dikush që nuk dinte gjë për p.sh. Rrethimin e Sarajevës ose për një varr masiv në periferi të Beogradit. Kisha dëshirë që në vendin tim të ishte më mirë."

Kur erdhi në Nismë, filloi të njihej me njerëz që e ndryshuan dhe i thyen paragjykimet. Dhe nga fakti se ai vetëm "deshi të merrte rrogë", Nisma dhe temat që trajtonte dalëngadalë u bënë tema qendrore në jetën e tij private.

"Më kanë ndryshuar më së shumti takimet e para zyrtare, e më pas miqësore me njerëz nga rajoni. Historitë e tyre të jetës, përvojat, jetët. Dhe kështu nga raportet financiare dhe buxhetimi, gjëj mënyra për të siguruar më shumë ekipin përmes mbështetjes administrative dhe financiare, në mënyrë që koleget/ët të mund të punojnë më lehtë dhe të kapërcejnë pengesa të ndryshme. Fillova të dëshiroj të marr pjesë në takimet e programit, por edhe të jem pjesë e aksioneve në rrugë, gjë që atëherë vërtet nuk ishte e dëshiruar, dhe jo vetëm të ulem para kompjuterit dhe të punoj me buxhetet dhe raportet".

Pas pozitës së asistentit finanziar, ai u bë koordinator finanziar në vitin 2010, ndërsa nga viti 2018 është drejtore i Nismës. Gjatë gjithë asaj kohe, Nisma u shndërrua në një organizatë të respektuar rajonale të njohur përtëj kufijve të Ballkanit, gjë që u konfirmua me nga një prej çmimive më prestigjioze për të drejtat e njeriut në Evropë – Vaclav Havel – dhënë nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. "Ajo që më plotëson dhe më jep forcë të jem këtu edhe në moshën 46-vjeçare janë të rinjtë dhe kur shoh tek ata dëshirën e singertë për të ndryshuar botën. Sa herë që mendoj se lufta jonë është e kotë, ata më mohojnë çdo ditë dhe nuk më lënë të rri, të bëhem apatik, të pushoj së luftuar për një rajon më të mirë".

Bojani mendon se qasja rajonale e Nismës për zgjidhjen e problemeve dhe mënyra se si veprojnë aktivistet dhe aktivistët e saj me trashëgiminë e luftës, si dhe paqen e qëndrueshme, si synimi përfundimtar që është i bazuar në çdo projekt të organizatës dhe që nuk mund të arrihet përmes reformave vetëm në një shoqëri, janë karakteristikë e Nismës, por ekskluzivisht duke reformuar rajonin në tërësi.

"Nisma është një nga pionieret e shoqërisë civile në rajon, e cila i hapi rrugë shumë organizatave të tjera. Dhe kjo do të thotë se përmes të gjitha ndryshimeve politike dhe sociale në periudhën e tranzicionit të shoqërisë serbe, me punën time në Nismë, kam gjetur modalitetet, së bashku me kolegët e mi, për t'iu përgjigjur sfidave të dhëna. Nuk mendoj se pas Nismës do të shkoja të punoja në bankë, por jam i sigurt se njohuritë dhe aftësitë që marr nga Nisma janë pasuria ime më e madhe në rrugën time të mëtejshme profesionale, cilado qoftë ajo".

Bojani beson se "Ditët e Sarajevës" së Nismës kontribuan në rrëzimin e paragjykimeve duke përdorur një kulturë që ndihmon pranimin e diversitetit dhe tolerancës dhe ndikon në shkatërrimin e paragjykimeve. Ai e konsideron gjithashtu të rëndësishme nismën "Programi rajonal i shkëmbimit të të rinjve", i cili ekziston që nga themelimi i saj. Ai beson se shkëmbimi i ndërsjellë mes të rinjve është çelësi për të kapërcyer paragjykimet dhe për të zgjuar empatinë.

"Nisma është e para që i realizoi këto programe me shumë vështirësi dhe tregues se sa e rëndësishme është situata edhe 20 vjet më vonë, kur është pothuajse e pamundur të organizohen të rinj nga Bosnja dhe Kosova që të takohen në njërin apo tjetrin vend. Ne kemi ende shumë punë përpara për të siguruar paqen afatgjatë në rajon dhe zbatimi i programeve të tillë si "Programi rajonal i shkëmbimit rinor" është një mënyrë e sigurt për ta bërë këtë."

JASMINA LAZOVIQ

# NISMA ËSHTË HALLKA MË E RËNDËSISHME NË PROCESET E SOCIALIZIMIT DHE PJEKURISË SIME PROFESIONALE



Jasmina Lazović

koordinatore e ekipit mediatik, koordinatore e programit të drejtësisë tranzicionale, koordinatore e programit rajonal. Sot, koordinatorja e programit të shkëmbimit në Heartefact.

**Kontakti i parë i Jasminës me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi u bë në verën e vitit 2007. Ajo ishte 23 vjeçë, studioi gazetari në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd dhe aplikoi për tre nga programet e Nismës: Programin Visiting, Shkollën e Politikës së Re dhe praktikën në ekipin e medias. Ajo që ndoshta nuk mund ta merrte me mend atëherë është se nga ajo verë e deri më sot ajo do të mbetej pjesë e Nismës, herë formalisht, herë jo formalisht.**

Si pjesë e programit Visiting, ajo vizitoi Kosovën në shtator 2007; edhe pse ajo duhej të qëndronte tre ditë, ajo qëndroi më gjatë sepse i pëlqeu "gjithçka që ndodhi rreth YIHR dhe vetë organizata". Jasmina fillimisht ishte aktiviste, më pas praktikante e Nismës në Tribunalin e Hagës në 2008 dhe 2009. Ajo iu bashkua zyrtarish ekipit mediatik të YIHR-së në tetor 2009, dhe vitin e ardhshëm u transferua në programe, ku qëndroi deri në shkurt 2017. Ajo ka qenë në Bordin e Drejtoreve në dy raste dhe është ende anëtare e Asamblesë së YIHR.

Në kohën kur Jasmina iu bashkua Nismës, Kosova ende nuk e kishte shpallur pavarësinë, marrëdhëniet në rajon ishin të acaruar, por kishte shumë më tepër entuziazëm sesa sot, para së gjithash për shkak se në zonën e ish-Jugosllavisë, individët dhe organizatat e shoqërisë civile kishin filluar të punonin së bashku për disa çështje, për herë të parë që nga përfundimi i luftërave në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë.

"Kishte një ndjenjë se kishte hapësirë që gjérat të ndryshon. Nisma punoi në projekte të ndryshme rajonale që krijuan lidhje mes njerëzve në mbarë rajonin dhe, megjithëse ishim të sulmuar për këtë, në të njëjtën kohë vazhdimisht pamë përparim në thellimin e bashkëpunimit rajonal, kryesisht në nivelin personal, por edhe përmes bashkëpunimit kulturor, ekonomik të të rinje dhe të ngjashme".

Në vitit pas vitit 2007, Jasmina punoi në disa nga nismat dhe fushatat më të rëndësishme rajonale në rajon. Nisma i mundësoi asaj të organizonte parada krenarie, "kur ato ishin të ndaluar, të marr pjesë në Krenarinë ilegale të mesnatës, të udhëtoj nëpër vend, rajon dhe botë duke takuar njerëz frymëzues dhe interesantë, kryesisht aktivistë të profileve të ndryshme, që në kuadër të samitit të të rinjve anembanë rajonit të organizoj tubime të aktivistëve të rinj nga e gjithë bota".

Nga të gjitha iniciativat e Nismës në të cilat mori pjesë, ajo theksон veçanërisht themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim e të rinjve (RYCO), programin Visiting dhe praktikën në Tribunalin e Hagës. Sa i përket RYCO-s, me avokimin e kësaj iniciative është marrë që nga viti 2009 dhe sot e konsideron ekzistencën e kësaj zyre si një nga kontributet më të mëdha të saj dhe të Nismës për paqen dhe bashkëpunimin rajonal.

"Në të njëjtën rrugë – emocionalisht, gjëja më e rëndësishme për mua ishte programi Visiting – programi i shkëmbimit të të rinjve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëpër të cilin kaluan qindra të rinj gjatë angazhimit tim në YIHR. Ky program, të cilin zakonisht e quanim "përralla treditore", u mundësoi të rinjve të thyenë shpejt shumicën e paragjykimeve që kanë për Kosovën/Serbinë dhe në rethanat e trazirave të vazdueshme ndërmjet

Beogradit dhe Prishtinës të krijojnë disa përvoja të ndryshme personale për marrëdhëniet midis dy shoqërive. Ky ishte një nga programet ku ndryshimi mund të shihet menjëherë – pas 15 minutave të para të kaluara në Beograd, përkatësisht në Prishtinë, të rintjtë serbë dhe shqiptarë humbën ndjenjën e ngërçit që pashmangshëm e kishin të gjithë gjatë udhëtimit të tyre të parë në qytetet e përmendura.

Ajo që do theksoja në veçanti, janë të gjitha mundësítë që më ka dhënë YIHR, edhe pse mund të mos jem në lartësinë e tyre profesionale. Që më mundësoi të punoja dhe mësoja, të mësoja duke punuar".

Jasmina zyrtarish u largua nga Nisma në vitin 2017, por vazhdoi të merret me drejtësinë tranzicionale, pajtimin në rajon dhe ballafaqimin me të kaluarën. E pyetur nëse rruga e saj profesionale u përcaktua nga vitet e kaluara në Nisma, Jasmina thotë:

„Patjetër. Nuk do të mund të vazhdoja t'i trajtoja këto tema në mënyrën se si e bëj sot, nëse nuk do të ishin të gjitha kontaktet, njohjet, përvojat dhe mundësítë që pata gjatë punës në Nismë. Për më tepër, motivimin dhe dëshirën për t'u marrë me këto tema ende e kam nga ajo periudhë kur sapo kisha filluar të merresha me aktivizëm në këtë fushë. Kur ndjej se sot vjen "ngopja" dhe e kam të vështirë të gjej motivim, medoemos mendoj që nëse unë, me gjithë këtë përvojë që kam dhe vitet e punës të investuara në këto tema përmes YIHR-së, nuk mund të merrem me këto tema dhe heq dorë, si të pres atëherë që dikush tjetër, që nuk ka përvojë të ngjashme me timen, do të dëshirojë të merret me këtë.“

Falë Nismës, Jasmina është kjo që është sot, dhe thotë se i detyrohet shumë viteve të kaluara në këtë organizatë – si personalisht ashtu edhe profesionalisht. Në këtë e ka ndihmuar më shumë se çdo institucion zyrtar apo mjedis informal në të cilin është rritur dhe pjekur:

„Marrëdhënia që kam me vendet dhe njerëzit në rajon ka rezultuar drejtpërdrejt nga përfshirja ime në YIHR.

Fakti që unë i njoh shumë mirë shumë vende në Kroaci, BiH dhe Kosovë dhe mund të gjej rrugën time rreth tyre po aq mirë si në Beograd, është pasojë e drejtpërdrejtë e një dekade pune në dhe rreth Nismës. Së bashku me këtë vijnë qindra njerëz që kam takuar, me të cilët kam bashkëpunuar, jam shqëruar, ndonjëherë kam debatuar, por sigurisht që i kam përdorur të gjitha këto rrethana për të ndërtuar një marrëdhënie me rajonin si një hapësirë ku jetojnë disa njerëz, një hapësirë që falë angazhimit në YIHR nuk i përfjetoj si territorë imaginare, jopersonale, por si vende ku jetojnë njerëz që njoh“.

# YIHR-A, ZËRI I ATYRE QË KANË MË PAK ZË



**Arbër Selmani ishte pjesë e aktiviteteve për 12 gushtin, Ditën Ndërkombe të Rinisë dhe më pas pjesë e disa aktiviteteve të YIHR-së gjatë viteve 2008-2009. Në atë kohë, në të 20-tat, duke parë misionin dhe angazhimin e YIHR-së në rajon Selmani vendosi t'i bashkohej Nismës. Që nga ajo kohë ai ka qenë pjesë e YIHR-së në periudha të ndryshme, por jo aktivisht. Për një kohë, ai ishte edhe kryetar i Bordit ndërsa tani është kryesues i Kuvendit të YIHR-së në Kosovë.**

Koha kur Selmani iu bashkua YIHR-së ishte periudha kur Kosova shpalli pavarësinë dhe tensionet ndëretnike dhe politike po vazhdonin në vend, ndërkohë Kosova përpiquej të vazhdonte ndërtimin e shtetit. "Ishte gjithashtu një periudhë e turbulencave politike dhe vendi ishte në kërkim të një identiteti edhe politik, edhe shoqëror".

Ai thotë se në kohën kur YIHR-a po mundohej të krijonte një urë komunikimi ndëretnike dhe një aktivizimi më dinamik në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut, vendi ndodhej në një lloj "apatie dhe mungese të vullnetit politik për t'u ballafaquar me çështjet kyçë që ndërlidhen me të drejtat e njeriut".

Duke qenë aktiv nga jashtë më shume sesa nga brenda, Selmani dëshiron ta identifikojë veten me një nga projektet e zhvilluara në kohën e pandemisë në vend të quajtur "Personalja" ku ai ka punuar në terren me komunitet e marginalizuara.

Duke qenë një kohë të gjatë në rrugëtim me YIHR-në, Selmani thotë se duke qenë një organizatë rajonale që ndan preokupime dhe fushëveprime në disa shtete të dala nga ish RFJ-ja që ishin në raporte skajshmërisht të këqija pas luftës dhe ndarjeve të thella ndëretnike, YIHR-a kishte një peshë në jetën publike. Ndër vite ai vëren se shumë gjëra kanë ndryshuar dhe roli i shoqërisë civile gjithashtu, por në kontekstin kohor kur është themeluar dhe ka vepruar shumë gjëra që i ka realizuar YIHR-a nuk do të mund të bëheshin nga të tjerat. Duke qenë një organizatë rajonale ai thotë se YIHR ka qenë shpesh etakuar në baza etnike, dhe ka vazduar edhe kur ka qenë e kërcënuar apo etiketuar.

"Në atë kohë, përvèç komunikimit mes të rinjve, organizatat e tjera nuk kishin mundësi të bashkoheshin me komunitet e tjera më të ceneshe si LGBT, viktimat e dhunës në familje apo personat me aftësi të kufizuara", thotë Selmani.

Ai shton se YIHR-a ka qenë një prej platformave që i ka shtyrë të rinjtë e komuniteteve të komunikojnë dhe të flasin përluftë dhe pasojat e saj. "Tani të rinjtë nuk flasin shumë

përluftë dhe në projksionin e tyre. Shpesh duket se lufta dhe pasojat e saj kanë qenë më pak serioze sesa janë në të vërtetë kur flitet përluftë. Tani flitet më shumë vetëm kur kemi të bëjmë me zhvillime politike".

Në një përpjekje për të rivendosur komunikimin mes të rinjve, që ishin fëmijë të luftës, Selmani thotë se YIHR-a e ndihmoi të ndjejë dhe krijojë miqësi të reja me të rinj serbë që ndoshta më herët nuk do t'i kishte imaginuar.

"Për një kohë pas luftës jo shumë njerëz kishin guximin të hynin në aktivitete. YIHR-a e ka krijuar një gjeneratë të aktivistëve të shqar të të drejtave të njeriut dhe avokuesve të vlerave njerëzore", thotë Selmani.

Më shumë se një dekadë pas, Selmani thotë se YIHR-a e ka ndihmuar të kërkojë dhe gjejë shtigje të ndryshme, shpesh jo të lehta. Në frymën e një historie personale ai thotë se YIHR-a e ka ndihmuar ta kuptojë veten dhe të tjerët më shumë.

"Më ka ndihmuar të njoh, korrigoj dhe luftoj standartet e mia, shpesh të dyfishta. Mbi të gjitha më ka dhënë më shumë empati për çështje të ndryshme që më kanë shtyrë në aktivitete dhe protesta që në kushte normale ndoshta nuk do të dilja. Ka thyer kornizat që shpesh shoqëria t'i vë krejtësisht pa vend".

Ai thotë se për të YIHR-ën është një lloj pike reference për të drejtat e njeriut kudo në rajon dhe se kjo organizatë ka mbledhur shumë njerëz që kanë ndihmuar në transformimin e saj.

"YIHR-a është një zë i atyre që kanë më pak zë dhe zë një vend të rëndësishëm në pasazhin e organizatave që mbrojnë të drejtat e njeriut", thotë Selmani.

Duke u përpjekur për ta pëershkuar me një fjali, Selmani thotë se YIHR-a edukon gjenerata që janë larg propagandës dhe që besojnë se është e mundur paqja dhe pajtimi mes të rinjve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, pas luftërave të përgjakshme dhe viteve të rënda që kanë kaluar.

# INICIATIVA ËSHTË NJË VEND I SIGURT PËR TË GJITHË INDIVIDËT ME MENDIM TË LIRË



Danko Runiq

mik i YIHR që nga viti 2005, tani menaxher projekti i Këshillit të Evropës në Strasburg.

**Në kohën kur u themelua Nisma, Danko jetonte prej shumë vitesh jashtë vendit. Në ato kohë të paqëndrueshme dhe të trazuara pas vrasjes së kryeministrit të parë të Serbisë të zgjedhur në mënyrë demokratike, Nisma shfaqet si zë i arsyes, thotë Danko.**

**“Më kujtohet shumë mirë mosbesimi dhe tronditja tekxa lexoja një nga publikimet e shumta mediatike të Nismës dhe mendoja me vete “ata kanë guxim”.**

Guximi dhe energjia e Andrej Nosovit dhe aktivistëve dhe aktivisteve të tjera ndikuan dukshëm në vendimin e tij për t'u kthyer në Serbi në vitin 2005, pas përfundimit të masterit në Universitetin e Bolonjës.

“Ndjeva se kisha aleatë”.

Rugët e tyre u kryqëzuan shpejt. Brenda Partisë Liberale Demokratike të sapothemeluar, Danko punoi përvendosjen e një dialogu me shoqerinë civile dhe ekipi i Nismës është bërë partneri dhe fryshtimi i tyre. Që nga viti 2008, ai drejton Departamentin e Administratës së Qytetit të Beogradit, i cili përfshinte bashkëpunimin me shoqerinë civile.

“Në ato vite, ambasada amerikane u dogj, kriminelët e luftës fshiheshin në Serbi, u vra Bris Taton, huliganët tërboheshin nëpër stadiume dhe shkatërronin qytetin sa herë që kishte përpjekje për të organizuar një Paradë Krenarie”.

Në atë atmosferë, së bashku me ekipin e Nismës të udhëhequr nga Maja Miqiq në atë kohë, ata projektuan fushatën Beogradit pa dhunë, e cila filloj të zbatohet në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, fushata ishte jetëshkurtër.

“Po të kishim qenë më këmbëngulës, ndoshta sot as nuk do të ishte e nevojshme fushata aktuale me një emër të ngashëm”, shton Danko duke iu referuar situatës aktuale në Serbi.

“Megjithatë, ne i hapëm dyert e institucioneve të Beogradit për organizatat që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.”

Në vitin 2009, ai punoi me YIHR në përgatitjen e Samitit të Rinjeve, një ngjarje që mbodhi së bashku qindra

të rinj nga i gjithë rajoni në Beograd për të diskutuar një të ardhme më të mirë.

Në vitet që pasuan, Nisma vendosi kontakte dhe bashkëpunim me përfaqësuesit e qytetit të Sarajevës, të cilët ishin myafirë të festivalit të Nismës Ditet e Sarajevës në Beograd. Përvjetori i rënies së Vukovarit, “një nga tragjeditë më të pakuptimta të luftërave të viteve të 1990-ta”, u përkujtua edhe në Kuvendin e Qytetit të Beogradit në ato vite.

Në vitin 2016, Danko mori pjesë në krijimin e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit të të Rinjeve (RYCO), duke i dhënë mbështetje Nismës në këtë proces.

“Falë përpjekjeve të drejtoreshës së atëhershme Anita Mitiq dhe aktivistëve të shumtë të Nismës, çështja e ballafaqimit me të kaluarën u vendos lart në agjendën politike.

Një nga momentet e tij të preferuara në karrierën e tij profesionale ishte marja e çmimit Miqtë e Nismës, i cili iu dorëzua në ditëlindjen e shtatë të YIHR.

“Përmes bashkëpunimit me Nismën fitova miq për jetë, bashkëluftëtarë në përpjekjet për ta bërë Serbinë një vend të denjë.

Puna e Dankos në fushën e të drejtave të njeriut vazhdoi dhe gjatë gjithë këtyre viteve ai qëndroi pranë Nismës. Runiq punon për Këshillin e Evropës për shumë vite dhe të drejtat e njeriut janë ende fokusi i tij.

“Isha jashtëzakonisht krenar kur, në vitin 2019, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës vendosi t'i jepte Nismës çmimin Vaclav Havel, i cili u jepet organizatave që shquhen veçanërisht në luftën për të drejtat e njeriut. Kjo është një mirënjoye e madhe për ekipin e njerëzve të mbledhur në Nismë nga drejtori aktual Bojan Stankoviq”.

# YIHR ËSHTË ZEMRA E KËTIJ RAJONI



Anita Mitiq

aktiviste 2009-2014, koordinatore e programit global 2014, drejtoreshë 2014-2018.

**Deri në mars të vitit 2009, Anita nuk ishte në asnjë vend të ish-Jugosllavisë, përveç në Mal të Zi në det, dhe një herë në Kroaci, në Zagreb, përtë vizituar të afërmit. Vetëm pasi lexoi "Në urën e Drinës" të Andriqit, ajo dëshiroi të kuptonte më mirë Serbinë, rajonin – dhe të shihte urën në Vishegrad. Atë vit ajo mbushi 18 vjeç, u bë e rritur dhe ndjeu se mund të kontribuojë në ndonjë ndryshim, por nuk ishte e sigurt se si. Në të njëjtën kohë, Serbia ishte në një lloj udhëkryqi politik: Kosova kishte shpallur pavarësinë një vit më parë, gjë që çoi në protesta masive kur qyteti "thyhej" dhe Evropa dukej më larg se kurrë. E gjithë Serbia ishte në sloganin *Kosova është zemra e Serbisë*. Këtu nuk kishte vend përmua".**

Në atë moment, kujton Anita, Nisma kishte një fushatë *Unë jam zemra e Serbisë*: "Dhe një ditë kur më erdhi ajo fletëpalosje – ma ndryshoi jetën".

Gjatë gati një dekade në Nismë në pozita të ndryshme, Anita mori pjesë në iniciativa, projekte dhe fushata të panumërtë. E pyetur se cilat ishin më të rëndësishmet përtë, Anita përgjigjet:

"Të gjitha veprimet – nga përkujtimi i gjenocidit në Srebrenicë deri te protesta kundër promovimit të librit të kriminelit të luftës në Beshka. Shumë njerëz fjalë përfjalë rrezikan shëndetin dhe jetën e tyre përfshak të disa prej atyre veprimeve, pësuan ofendime dhe sulme, patën probleme në familje, me miqtë, në universitetë sepse morën pjesë në ato veprime. Shumë lot u derdhën në zyrë nga stresi dhe dhimbjet, por edhe nga lodhja. Kërcënimet me vdekje u bënë një dukuri e përditshme. Edhe kallëzimet përkundervajtje ishin gjithashtu të zakonshme.

Pavarësish të gjithave, aktivistet dhe aktivistët dilnin në rrugë përtë luftuar kundër padrejtësisë, përtë ndezur një qiri përviktimat e gjenocidit, përtë tërhequr vëmendjen përtë një problem, përtë luftuar përtë drejtat e dikujt. Të palodhur edhe në diell edhe në shi, këta njerëz, pavarësish gjithçkaje, kuptuan se guximi nuk është mungesa e frikës, por ideja se diçka është më e rëndësishme se frika".

Në veçanti, përmend themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) dhe festivalin Mirëdita, dobar dan, "sepse pak gjëra ishin më të rëndësishme dhe më të vështira përtu bërë".

Nisma i ka sjellë shumë Anitës si në aspektin personal ashtu edhe në atë profesional, edhe pse edhe ajo vetë është e vetëdijshme se këto dy plane janë të ndërthurura shumë shpesh në Nismë. "A i kultivojmë këto vlera sepse

kemi punuar në Nismë apo kemi punuar në Nismë sepse kemi kultivuar këto vlera".

Në të njëjtën kohë, asnjëherë nuk e kemi parë njëri-tjetrin vetëm si kolegë, por si miq. Kishte shumë darka dhe takime pune, por edhe shumë festa ditëlindjesh dhe pas festës. Pasi shumica e njerëzve kalojnë nëpër nismë në të njëzetat e tyre, e bën pothuajse të pamundur vendosjen e një kufiri të qartë midis personales dhe të biznesit. Kishte shumë dashuri, por edhe heartbreak-ë".

Në moshën 18-vjeçare, Anita ka parë vetëm Malin e Zi dhe Zagrebin; sot, 14 vjet më vonë, disa nga njerëzit më të rëndësishëm në jetën e saj janë nga Prishtina, Sarajevo dhe Zagrebi. "Nisma më dha mundësinë të eci lirshëm dhe e lumtur rrugëve të këtij rajoni, të kem gjithmonë dikë me të cilin do të pi kafe apo të telefonoj nëse kam nevojë përndihmë".

Rreptësish profesionale, YIHR i hapi shumë dyer, e njoju me njerëz nga e gjithë bota dhe i hapi rrugën e mëtejshme. Ajo u largua në vitin 2018, para së gjithash sepse, siç thotë ajo, ishte djegur. Sulmet e ndryshme ndaj saj dhe YIHR-së ishin shumë të shpeshta dhe patën ndikimin e tyre. Vetëm vite më vonë, kur ajo u shërua vërtet nga gjithçka, si mendërisht ashtu edhe fizikisht, e kuptoi se sa e vështirë dhe stresuese është jeta e aktivisteve dhe aktivistëve dhe cili është çmimi që paguajnë ata për idealet përtë cilat luftojnë. Pas Nismës, ajo kaloi disa kohë duke jetuar dhe punuar në Sarajevë, dhe më pas mori një bursë Fulbright falë së cilës përfundoi studimet master në Tekkas, ku u mor me tema të ngjashme – por nga këndvështrimi akademik.

"Aty kuptova se sa e rëndësishme ishte përvaja praktike që kisha dhe sa shumë ndikoi në zhvillimin tim akademik. Vitet që kalova në Nismë përcaktuan padyshim rrugën time profesionale, si dhe të gjitha interesat e mia profesionale".

**BORIS RAONIQ**

# NISMA ËSHTË NJË FORCË SHTYTËSE QË ANGAZHON TË RINJTË TË AVOKOJNË PËR NJË SHOQËRI PA PARAGJYKIME DHE URREJTJE



**Boris Raonić**

drejtor programi, YIHR Mali i Zi, 2010-2012,  
tani drejtor i përgjithshëm i Radio Televizionit  
të Malit të Zi.

**Para se të merrte postin e Drejtorit  
të Përgjithshëm të Radios dhe  
Televizonit të Malit të Zi, Boris kishte  
përvojë shumëvjeçare në luftën për të  
drejtat e njeriut. Një nga ato përvoja  
ai e fitoi si drejtor programi i zyrës së  
YIHR në Mal të Zi.**

Arsyeja kryesore për t’iu bashkuar Nismës ishte qëndrimi i tij personal ndaj të drejtave të njeriut, demokracisë dhe kërkimit të ndryshimeve në shoqërinë në tranzicion pas luftërave. Në kohën e themelimit të YIHR, rajoni po përballej me sfida të shumta: krime lufte të kryera, refugjatë dhe persona të zhvendosur, të cilat kishin pasoja edhe për Malin e Zi. Problemi ishte veçanërisht ideologjia nacionaliste dhe konfliktet në një shoqëri të polarizuar, thotë Boris.

“Në këtë drejtim, anëtarësimi në Iniciativë ishte një reagim ndaj nevojës për ndryshimin e klimës ekzistuese socio-politike në Mal të Zi.

“Aty kuptova nevojën për ndryshime dhe përmirësim të shoqërisë përmes avokimit aktiv të këtyre vlerave”.

Në nivel personal, Boris e sheh YIHR si një grup të rinjsh të përkushtuar ndaj të njëjtit qëllim – mbrojtjen e të drejtave të çdo individi dhe ndërtimin e një shoqërie më të mirë përmes edukimit dhe aktivizmit. Thekson se Nisma është një vend ku të rinjtë lidhen dhe mësojnë nga bashkëmoshatarët e tyre.

Megjithatë, në planin e biznesit, ai e sheh Nismën si një organizatë serioze joqeveritare me ndikim rajonal. Si një organizatë që merret me kërkime, por edhe me ofrimin e asistencës ligjore duke nxituar bashkëpunimin në rajon.

Zyra e YIHR në Mal të Zi u themelua në vitin 2006 dhe katër vjet më vonë Borisi u bë anëtar i saj. Në atë kohë, puna e Nismës ishte e fokusuar në ballafaqimin me të kaluarën, kërkimin dhe edukimin. Përveç kësaj, ata ishin të angazhuar në monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke ofruar mbështetje për viktimat e dhunës dhe duke zhvilluar fushata të ndryshme.

Ajo që Boris thekson si të rëndësishme është puna e drejtpërdrejtë me njerëzit që kanë pësuar padrejtësi, si dhe ofrimi i ndihmës juridike falas.

Jo më pak të rëndësishme janë shkëmbimet rimore rajonale që krijuan shumë miqësi dhe në të njëjtën kohë theyn paragjykimet e shumta që ekzistonin mes tyre.

Hulumtimet dhe raportet që tregojnë raste të veçanta të shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë çuar në zbardhjen e problemit dhe, siç shprehet Boris, edhe në presion ndaj institucioneve kompetente. Puna e YIHR iu kushtua kryesisht bashkëpunimit aktiv me përfaqësuesit e Qeverisë së Malit të Zi, partitë politike dhe mediat. Ishte gjithashtu një nga mënyrat për të lobuar për ndryshime në legjislacion me qëllim përmirësimin e shoqërisë. Boris nënvizon gjithashtu fushatat publike për ta bërë shoqërinë më të vetëdijshme për çështje të caktuara, si krimet e luftës, por edhe të drejtat e pakicave dhe kategorive të tjera të cenueshme.

“Në fund, dëshiroj të them se çdo aktivitet ynë ka pasur kontekstin dhe synimin e vet social, i cili si i tillë ka pasur ndikim të fortë në promovimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike.

Angazhimi aktivist i Borisit ka ekzistuar edhe para Nismës dhe thekson se do të vazhdojë edhe në funksionet e tjera që do të kryejë. Ai shton se puna në YIHR i mundësoi të zhvillojë aftësi që janë ende të dobishme për të përmes punës me njerëz nga sektorë të ndryshëm. I mundësoi gjithashtu edhe zgjerimin e rrjetit të kontakteve, që e ka ndihmuar në rrugën e tij profesionale.

“Sigurisht, puna për çështjet e të drejtave të njeriut kërkon gjithashtu aftësinë për të analizuar dhe kuptuar thellësisht sfidat komplekse sociale dhe ligjore, gjë që është e dobishme për mua edhe në situatat aktuale në punën time aktuale.”

Ai u largua nga Nisma në vitin 2012 dhe vazhdoi punën e tij si drejtor programi i Aleancës Qytetare. YIHR është themelues i kësaj organizate dhe Borisi aty vazhdoi parimin e punës së nisur në Nismë.

# THEMELIMI I QENDRËS SË INFORMACIONIT DHE DOKUMENTACIONIT NË MAL TË ZI

Në vitin 2020, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut themeloi Qendrën e Informacionit dhe Dokumentacionit, e vjetmja e këtij lloji në Mal të Zi, e cila mbledh dhe paraqet fakte për krimet e luftës të kryera në territorin tonë gjatë viteve të nëntëdhjeta, si dhe në rajon. Nëpërmjet punës së qendrës janë organizuar ligjérata të shumta për studentët e shkencave juridike dhe politike, takime me përfaqësues të gjyqësorit dhe prokurorisë dhe institucioneve të tjera relevante, të gjitha me qëllim të forcimit të vetëdijes përrëndësinë e ballafaqimit adekuat me të kaluarën e luftës të Malit të Zi dhe sqarimin e fakteve nga ajo periudhë.



IVAN NOVOSEL

# NISMA JANË VENDET, NJERËZIT DHE SITUATA QË E KANË PASURUAR NDJESHËM JETËN TIME



Ivan Novosel

koordinator i programit YIHR Kroaci 2010-2015, tani drejtor programi i Shtëpisë së të Drejtave të Njeriut në Zagreb dhe kryetar i Bordit të Drejtorëve të Nismës në Serbi.

**Ivan u bë pjesë e Nismës në Kroaci shumë shpejt pas themelimit të saj, në fillim të vitit 2010. Në atë kohë, Kroacia ishte në proces të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe publiku ende fliste për krimet e luftës të kryera, shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë viteve të nëntëdhjeta dhe punohej edhe për përmirësimin e tyre. Një nga aktivitetet e para në të cilën mori pjesë Ivan, 22-vjeçari i atëhershëm, ishte një tryezë e rrumbullakët mbi krimet e kryera në Medaçki Xhep në vitin 1993.**

"Në atë kohë Nisma ishte shumë aktive në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe balafaqimit me të kaluarën. Nisma ishte një organizatë në të cilën doja të isha pjesë, sepse mbloodi njerëz me të cilët pashë mundësinë për të punuar së bashku për të përmirësuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut".

Ivani ka një kujtesë veçanërisht të dashur për Nismën për krijimin e Political Youth Network-a (PYN), pasi ishte një nga projektet e para në të cilat ai mori pjesë aktive. Puna me të rinjtë e partive politike e fokusuar në ballafaqimin me të kaluarën, drejtësinë tranzicionale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut ishte në fillim në atë kohë, kështu që shumë organizata të shoqërisë civile në Kroaci e kishin të vështirë të ndërmerrreshin një ndërmarrje të tillë, kujton Ivani.

"Vlera kryesore e PYN-së atëherë dhe ende sot është se ajo ndërton ura midis politikanëve të ndryshëm të rinj nga opsiione të ndryshme politike në mënyrë që të kuptojnë më mirë të kaluarën dhe të parandalojnë përsëritjen e luftërave."

Në detin e aksioneve dhe projekteve të tjera që ai udhëhoqi apo në të cilat ai mori pjesë aktive, Ivani veçon fushatën "NE TË GJITHË – për Kroacinë e të gjithëve neve", e cila u ngrit kundër mbajtjes së një referendumi që synonte ndalimin e përdorimit publik të alfabetit cirilik në Kroaci.

Më shumë se trembëdhjetë vjet pasi u bë pjesë e Nismës, Ivani thotë se ishte një pjesë e rëndësishme e rritjes të tij, se ajo përcaktoi rrugën e tij profesionale dhe se i la njerëz për tërë jetën.

"Nisma është familje. Nisma janë njerëzit me të cilët jam rritur. Nisma janë miqësítë për jetën. Nisma është një

periudhë formuese që, për nga vlerat, ndoshta më la gjurmët më të thella. Në Nismë kuptova se rrugën time profesionale e shoh në punën për të drejtat e njeriut dhe në Nismë mora mbështetje për të vazhduar ecjen në këtë rrugë."

Ivan zyrtarisht u largua nga Nisma në vitin 2015. Ai vazhdoi karrierën e tij si drejtor programi në Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut në Zagreb, por ai kurrë nuk u largua nga Nisma: ai ishte kryetar i Bordit të Drejtorëve të YIHR-së Serbi për dy mandate, dhe në atë pozicion ishte deri në mesin e vitit 2023.

**SVEN MILEKIQ**

# NISMA ËSHTË LUFTË KUNDËR SISTEMIT



**Sven Milekic**

Koordinator/ Drejtues i Programit të Drejtësisë Tranzicionale, YIHR Kroaci, 2011-2014.

**Kur 27-vjeçari i atëhershëm Sven vendosi të bëhej pjesë e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Kroacia po luftonte me probleme të shumta socio-politike: recessionin, politikat shtrënguese neolibrale, korruptionin. Situata u trondit më tej nga vendimi i shkallës së parë kundër gjeneralëve Ante Gotovina dhe Mlladen Markaç, me të cilin ata u dënuan me 24 dhe 18 vjet për krime lufte të kryera gjatë operacionit Stuhia (Oluja).**

Në rethana të tilla, vullnetarët dhe koordinatorët e Nismës – të cilëve së shpejti do t'u bashkohet edhe Sveni – u përpqën që KOMRA ta prezantojnë sa më mirë para qytetarëve të Kroacisë dhe të mbledhin nënshkrime për themelimin e saj.

Ishte fundi i prillit – fillimi i majit 2011.

"Duke pasur parasysh se ata kanë qënë për të njëjtat gjëra në të cilat kam besuar më parë – drejtësinë dhe vërtetimin e fakteve për luftën kundër etno-nacionalizmit – u bashkova fillimisht si vullnetar, e më vonë si koordinator lokal në Zagreb. Mendova se Nisma ishte vendi i duhur për të rinjtë që duan të paktën të përpilen të ndikojnë në politikën mainstream".

Në fund të atij viti, Zagrebi nënshkroi Marrëveshjen për anëtarësim në Bashkimin Evropian, kështu që interesni i Kroacisë dhe komunitetit ndërkombëtar për çështjet e drejtësisë tranzicionale dhe ballafaqimit me të kaluarën pushoi: "Si një çimentim shtesë i atyre marrëdhënieve, gjeneralët Gotovina dhe Markaç u liruan në nëntor të vitit 2012, kështu që elitat politike, mediat kryesore (me përgashtim të disave) dhe një pjesë e mirë e popullatës e paraqitën atë si një triumf të drejtësisë dhe konkluzionin se nuk kishte krim në Oluja – gjë që nuk korrespondon me faktet e vërtetuara para Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë", thotë Sveni.

Në vitet që pasuan, Sveni ishte pjesë e nismave të ndryshme të Nismës në të gjithë rajonin. Mirëpo, ai thotë se dy janë më të rëndësishmet për të – KOMRA dhe Nisma për të emërtuar një park të Zagrebit me emrin e familjes Zec, e cila u vra nga policia kroate natën e 8 dhjetorit 1991. "KOMRA" është një projekt kapital dhe deri diku utopik që guxon ta shikojë rajonin post-jugosllav si një hapësirë e lidhur ngushtë me përvojat e luftës. Ndryshtës nga shumica e projekteve të ngjashme që fokusohen në shtetet kombëtare dhe popujt e paracaktuar si viktima, kundër të tjerëve që janë autorë, ky projekt guxoi të fokusohet tek viktimat në tërësi, duke respektuar fakte të tjera dhe pa ambicie për të shtyrë disa opsione politike.

Kur bëhet fjalë për Nismën për të emërtuar një park në Zagreb sipas familjes Zec dhe për të emërtuar një vendbanim kujtimor me emër të njerëzve të tjerë moritorë,

pata mundësinë të punoj për diçka që e konsideroj të rëndësishme për politikën lokale të kujtesës në vendlindjen time. Aty pata sërisht rastin t'i shtyja viktimat në ballë, të bashkëpunoja me Oliver Fërliqin dhe të shihja se sa e ndarë është shoqëria midis atyre që mbështetën nismën tonë dhe atyre që dhanë një sëré argumentesh me orientim nationalist pse familja Zec dhe Aleksandra Zec nuk duhet të përkujtohet".

Për Svenin, Nisma përfaqëson një grup të rinjsh që vëzgojnë nga një distancë kritike gjithçka që ndodhi gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, duke përfshirë "matricat autoritare të shoqërive tona post-jugosllave" të cilat herë drejtohen kundër njëra-tjetrës, herë kundër komunitetit LGBT, dhe nganjëherë refugjatëve dhe migrantëve.

"YIHR përfaqëson, në pjesën më të madhe, individë të pakompromis që mbrojnë me besnikëri dhe përkushtim idelet, në kurriz të problemeve dhe pengesave që hasin". Pas disa viteve të kaluara në Nismë, Sveni filloi të punojë për Rrjetin Rajonal të Kërkimeve Ballkanike, BIRN, si gazetar që mbulon drejtësinë tranzicionale në Kroaci dhe rajon. "Puna në BIRN ishte kryesish një vazhdimësi e trajtimit të të njëjtave tema të drejtësisë tranzicionale dhe ballafaqimit me të kaluarën, tashmë përmes objektivit të një gazetari. Më dha mundësinë t'i shikoj problemet nga një këndvështrim edhe më i gjërë social-politik". Ai është veçanërisht mirënjoës për BIRN dhe YIHR, siç thotë ai, sepse i hapën horizontet dhe i dhanë mundësi për t'u përmirësuar më tej në shkollat verore, programet studentore dhe seminaret. "Më dha njohuri dhe aftësi, përforcoi interesat e mia për karrierën time të ardhshme." Sveni gjatë këtyre viteve mbeti pjesë e Nismës dhe KOMRA-s, edhe pse joformalish. Aktualisht ai është duke përfunduar studimet e doktoraturës në Universitetin Maynooth (Maynooth University) në Irlandë, të cilat ishin vetëm një vazhdim logjik i karrierës dhe zhvillimit të tij personal dhe profesional:

"Sa i përket studimet tim për doktoraturë, sigurisht që nuk do të kishte ndodhur pa vitet e punës në YIHR dhe BIRN, sepse tema e disertacionit tim – rrëfimi dominues për luftën e viteve të 90-ta – është pjesërisht i lidhur me gjithçka që kam bërë dhe kam mbrojtur prej vitesh në organizatat e përmendura".

NINA SHEREMET

# NISMA ËSHTË GUXIM



Nina Sheremet

koordinatore e programit, YIHR Bosnie dhe Hercegovinë, 2012-2014, tani këshilltare ligjore në Misionin e OSBE-së në Bosnie dhe Hercegovinë.

**Si një nga fansat e Nismës, Nina iu bashkua kësaj organizate në Bosnjë dhe Hercegovinë në verën e vitis 2012. Deri atëherë, ajo kishte mbështetur prej kohësh projektin e YIHR-së, Të rinjtë për drejtësi; ishte nervoze kur në emër të Nismës foli Nedim Jahiq para Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe ditët e pushimit i kurseu për majin, kur do të mbaheshin Ditët e Sarajevës në Beograd.**

"Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Nisma arriti në komunitete të ndara, zona rurale dhe të izoluara, ajo u bë qendra e gravitetit rrëth së cilës u mblohdën të rinjtë, të cilët – po të mos ishte Nisma – nuk do të ishin në të njëjtin vend në të njëjtën kohë."

Ajo ishte e kënaqur që kjo organizatë inkurajoi të menduarit kritik të të rinjeve. Nina shton se Nisma ka bërë "pyetje delikate", ato që nuk janë pyetur, por pa ofruar apo imponuar përgjigje.

"Megjithëse klima politike dhe sociale nuk është përmirësuar ndjeshëm që nga përfundimi i konflikteve të armatosura, unë pohoj se me Nismën ka ndryshuar jeta e të rinjeve.

Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, Nina e zëvendësoi punën e saj në Institucionin e Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë me punën e koordinatores në Nismë. Aq e admironte Nina guximin e aktivistëve të Nismës, saqë ajo vetë ishte mjaft e guximshme për ta zëvendësuar punën e saj në një institucion shtetëror me një punë në sektorin joqeveritar. "Kisha ndjesinë se Nisma do të më jepet krahë për të fluturuar, por edhe se mund të isha një "erë në shpinë" e të rinjeve brenda/rreth Nismës".

Nina e ka të vështirë të veçojë vetëm disa projekte apo fushata të preferuara në të cilat ka marrë pjesë si pjesë e kësaj organizate, sepse Nisma ka qenë dhe mbetet një pjesë e rëndësishme e jetës së saj. Megjithatë, disa prej tyre i sheh çdo ditë – si "Trëndafilat e Sarajevës".

"Më 6 prill do të piktonim me entuziazëm gjurmët e dukshme të predhave të gjuajtura në Sarajevë gjatë rrëthimit katërvjeçar, të ashtuquajturit "Trëndafilat e Sarajevës", që po zhdukeshin në mënyrë të pakthyeshme nga rrugët e Sarajevës".

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që të rrëmbenin nga harresa monumentet autentike të rrëthimit të Sarajevës.

"Më kujtohet qartë lufta në BeH, për shembull që nuk arrita të mbaroj klasën e parë të shkollës fillore në bankat e shkollës për shkak të rrëthimit të Sarajevës dhe se një ide si Nisma ishte e nevojshme menjëherë pas luftës."

I kujtohet edhe kur aktivistët dhe aktivistet protestuan dhe paralajmëruan publikun dhe politikanët në Bosnje dhe Hercegovinë ndërsa vendosnin lule dhe bënин homazhe me rastin e Ditës së Shtetit, se mosbatimi i vendimeve të gjykatës është vepër penale. Ky "aksion gueril" nisi narrativën e përgjegjësisë penale në këtë vend për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, përfshirë rastin e Sejdiqit dhe Fincit.

"Ndërsa flitet çdo ditë për këtë, kjo më kujton atë mëngjes nëntori dhe të rinjtë me pankarta që rrinë ulur në betonin e ftohtë ku duhet të kalojnë politikanët, duke tërhequr vëmendjen e mediave të pranishme dhe madje edhe simpatinë e politikanëve.

"Të jesh vazhdimisht me aktivistë/aktiviste ishte një përvojë e jashtëzakonshme, kështu që nuk mund të shihja objektivisht se sa të mëdhenj janë në të vërtetë të gjithë hapat e vegjël."

Nina veçon edhe vizitën trejavore në Francën Lindore, ku mblohti fonde me organizatën joqeveritare CCFD, duke prezantuar aktivitetet e Nismës. Ajo shton se vetëm përmes reagimeve në Francë e kuptoi se gjetën "formulën unike" për pajtim, ballafaqim me të kaluarën dhe luftën për të drejtat e njeriut.

Puna në Nismë i mundësoi asaj të zhvillohej si personalisht ashtu edhe profesionalisht. Derisa punonte në këtë organizatë, Nina dha provimin e jurisprudencës dhe vazhdoi karrierën e saj në drejtësi. Që nga viti 2017, ajo është këshilltare ligjore në Misionin e OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë.

"Me krenari ndjek të rinjtë që ishin brenda dhe rreth YIHR-së, si dhe se sa ajo përvojë dhe ideja e aktivizmit qytetar përcaktoi rrugën e tyre të mëtejshme profesionale".

Nina thekson se koha tregoi që Nisma është bërë edhe më e nevojshme për gjeneratat e lindura pas luftës, sepse paqja nuk është thjesht mungesë lufte, por një proces afatgjatë në të cilin secili duhet të jap kontributin e vet.

"Ashtu si e vërteta, drejtësia, përgjegjësia, barazia, liria, demokracia dhe paqja nuk kushtëzohen dhe nuk mund të kushtëzohen", përfundon Nina.

GJORGJE BOJOVIQ

# KUDO TË NISEM, TY TË KTHEHEM PËRSËRI



Gjorgje Bojoviq

koordinator i projektit dhe programit, sekretar 2013-2016, anëtar aktual i Bordit Mbikëqyrës dhe këshilltar për Ballkanin Perëndimor, grupi i Aleancës së Lirë Evropiane të Gjelbër, Parlamenti Evropian.

**Gjorgje ishte student i vtit të parë në Fakultetin Juridik në Beograd kur pa në Infostud se Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut po shpallte një thirrje për juriste dhe jurist të rinj që ishin të interesuar për gjykimet e krimeve të luftës dhe të cilët, si pjesë e projektit të Nismës, do të shkonin në Hagë. Duke qenë se këto tema e kanë interesuar gjithmonë, aplikimi në projekt ishte renditja më logjike e mundshme e ngjarjeve.**

"Duke qenë se gjithmonë më ka interesuar shthurrja e Jugosllavisë dhe thjesht kam gëlltit gjithçka që lidhet me të – ky ishte momenti kur ëndrrat e fëmijërisë bëhen realitet. Kështu që në pranverën e viti 2012 kontaktin e parë me Nismën e pata përmes një projekti me njerëz nga Kroacia, Franca dhe Gjermania".

Në kohën kur u bë pjesë e Nismës, atë pranverë të vitit 2012, situata në Serbi, siç thotë ai, ishte kritike.

Në zgjedhjet e atij viti, SNS erdhë në pushtet, dhe publiku serb debatoi fushatën Preokret-LDP, votat e bardha dhe "nëse SNS do të jetë ajo që ishte HDZ në Kroaci – dikush që do të japë përgjigje dhe rezultate për temat e vështira", nga Kosova në Hagë".

Një vit pasi u takua me Nismën për herë të parë, Gjorgje filloi të punojë si coordinator projekti dhe më pas edhe programi. Ai ka qenë edhe sekretar i Nismës dhe sot është në Këshillin Mbikëqyrës. Dëshira për ndryshim është ajo që e shtyu atë të bëhej anëtar i saj:

"Nisma ishte ideale deri në atë masë që nuk është një parti politike që domosdo duhet të bëjë një lloj kompromisi, por të merret me çështjet më politike në vend. Duke u marrë me shpërbërjen e Jugosllavisë, e dija se Serbia nuk do të mund të ecë përpara as si shoqëri e as si vend derisa të ndahet me të kaluarën e saj dhe të bëhet një vend i plotë – të dijë se ku janë kufijtë e saj, cila është historia e saj, cila është e ardhma e saj."

Gjatë viteve kur iu bashkua Nismës, ai mori pjesë dhe drejtoi disa nisma, fushata dhe projekte. Megjithatë, njëra veçohet si veçanërisht e rëndësishme – Programi i Vizitave me Kosovën.

"Nuk ka kontribut më domethënës për normalitetin e Serbisë sesa të marrësh mijëra të rinj në Prishtinë, Mitrovicë apo kudo në Kosovë dhe të shkëmbesh me bashkëmoshatarë, politikanë, aktivistë, artistë andej. Hendeku që ekziston mes shoqërisë serbe dhe asaj kosovare është aq i thellë dhe plot keqkuptime saqë nuk kushtëzohet vetëm nga bariera gjuhësore, saqë çdo program që lidh dy shoqëritë – programet e shkëmbimit, festivali Mirëdita, dobar dan! apo diçka tjetër – për mua është gjëja më e madhe që bëri Nisma gjatë 20 viteve të para".

Për Gjorgjen, Nisma ka qenë gjithmonë një "hapësirë lirie", një vend ku shoqëria, shteti, e kaluara dhe ardhmja reflektohen në mënyrë kritike dhe pa kompromis. Nisma është një "ide e panjollosur" se aktivizmi mund të ndryshojë botën, si dhe një "protestë e rinisë" që mban mbi supe barrën e rëndë të së kaluarës për të cilën nuk është përgjegjëse dhe që përcakton universin e saj politik dhe mendor.

Nga Nisma u largua në shtator 2016. Sot ai është anëtar i Bordit Mbikëqyrës dhe dikush që i qëndroi besnik ideve, parimeve dhe vlerave të saj deri në fund. Nisma ndikoi fuqishëm në rrugën profesionale të Gjorges, zhvillimin formues dhe ishte shtesa më delikate e arsimt dhe edukimit formal.

Po të mos ishte Nisma (si kosmodisk), sot nuk do të merresha ende me Kosovën, rajonin, pajtimin, integrimin në BE, demokracinë."

JOSIP IVANOVIQ

# NISMA E TË RINJVE – NISMA PËR TË GJITHË



Josip Ivanovic

Koordinator i Programit Rajonal për Mobilitet dhe Bashkëpunim YIHR Kroaci, 2012-2016, aktualisht Këshilltar për Komunitetet në Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë.

**Pas përfundimit të studimeve bazë për filozofji në vitin 2010, Josip Ivanovic filloi të punojë vullnetar në Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut në Zagreb. Nëpërmjet udhëtimeve studimore dhe pjesëmarrjes në aksione dhe projekte që përkujtojnë krimet masive të kryera ndërmjet viteve 1941 dhe 1995, Josipi kuption se procesi i ballafaqimit kolektiv me të kaluarën është "i penguar sistematikisht nga retorika dominuese e elitës politike". Ai iu bashkua nismës në pranverën e vitit 2012, e cila në Kroaci u shënua nga gjyqi i gjeneralëve Ante Gotovina dhe Mladen Markaç para Tribunalit të Hagës. Në nëntor të të njëjtit vit, të dy u liruan.**

"Rezultati i atij gjyqi dha një erë të fortë pas "triumfalizmit drithëskurtër" kroat, siç e quajti Zoran Pusiç, kështu që më në fund u bë e qartë përmua se, pa angazhimin aktiv të atyre që kujdesen për pluralizmin social dhe drejtësinë, gjendja nuk mund të ecë përpëra përmë mirë. Së bashku me cëshirën përtë qenë pjesë e ndryshimit që dua të shoh në shoqëri, nevoja përtu rethuar nga njerëz me bindje politike komplementare ishte motivi kryesor përtiu bashkuan Nismës".

Në atë kohë, ekipi i Nismës në Zagreb përbëhej kryesisht nga studentë të shkencave politike. Për Josipin, ishte shumë i dukshëm dallimi mes "aktivistëve të rinj të orientuar drejt pragmatikës dhe të ndërlidhur nga Fakulteti i Shkencave Politike në Zagreb". Siç thotë ai, deri atëherë drejtësisë dhe veprimit shoqëror i ka qasur kryesisht nga këndvështrimi teoriko-historik.

Periudha e përshtatjes dhe njohjes me ekipin e YIHR-së pati një rëndësi formuese për identitetin e tij profesional dhe privat.

"Ju bashkova nismës si pjesë e një programi praktike gjashëmujore që pranoi një grup praktikantësh. Në të njëjtin vit, regjistrova studimet e doktoraturës në filozofi dhe shkrova tekste akademike për egalitarizmin liberal dhe qëndrueshmërinë e rendit demokratik, të cilat më ushqen dyshime për përshtatshmërinë e çdo lloj veprimi shoqëror, përfshirë edhe atë të drejtuar nga Nisma. Unë kam qenë prej kohësh i prekuar me këtë hendek të perceptuar midis teorisë dhe praktikës së ndryshimit shoqëror, pasi kam qenë njëkohësisht aktiv në të dyja fushat me të njëjtin entuziazëm. Në retrospektivë, ajo mospërputhje e perceptuar midis punës kërkimore dhe aktiviste nuk ishte një tregues i një problemi thelbësor, por një kusht për zhvillim të mëtejshëm në nivel profesional dhe personal".

Nisma më e rendësishme në kuptimin politik që e udhëhoqi ai ishte Rrjeti i Organizatave të Partive të Rinjve në vitin 2014, kur rreth dyzet degë rinore të partive politike kryesisht parlamentare nga Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Kroacia dhe Serbia u mblohdën rreth një platforme të përbashkët me qëllim të arritjes së një konsensusi mbi parimet politike mbi të cilat duhet të bazohen pajtimi rajonal, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe forcimi i bashkëpunimit të ndërsjellë të partive politike.

Rrjeti u themelua në një konferencë rajonale, kur 19 degë rinore nga këto pesë vende nënshkruan Deklaratën e Mbështetjes së

Rrjetit të Organizatave të Partive të Rinjve. Pas largimit të Josipit nga Nisma, Rrjeti vazhdoi të rritet dhe pranoi anëtarë të tjera nga Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut.

Një nismë tjetër rajonale që ai e konsideron shumë të rendësishme është Nisma e Kujtesës së të Rinjve, e cila trajtonte mënyrën se si të rinxjtë i perceptojnë vendet e shënuara dhe të pashënuara të kujtimit. Projekti mblohdhi rreth dhjetë vullnetarë nga Bosnja, Mali i Zi, Kosova, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, të cilët publikuan reflektimet e tyre ose reflektimet e dëshmitarëve-viktimate përvende të ndryshme kujtimi në të gjithë ish-Jugosllavinë.

Qëllimi i projektit ishte të rriste ndërgjegjësimin përrëndësinë e kulturës së përkujtimit dhe të inkurajojë të rinxjtë të krijojnë pikëpamjet e tyre të pavurura mbi vuajtjet dhe dhunën politike në këto hapësira gjatë shekullit të 20-të.

Në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, ata patën një projekt që përbëhej nga një sërë takimesh mes nxënësve të shkollave të mesme të Zagrebit dhe ambasadorëve të vendeve evropiane, ku u diskutuan çështjet socio-politike dhe sfidat specifike me të cilat përballeshin demokracitë evropiane në fund të shekullit të 20-të dhe në fillim të shekullit të 21-të.

Punën katërvjeçare në Nismë e filloi në vitin 2012 si vullnetar dhe e përfundoi në vitin 2016 si drejtues i Programit Rajonal për Mobilitet dhe Bashkëpunim. Nisma i dha mundësi të shumta për zhvillim të mëtejshëm dhe luajti një rol kyç në karrierën e tij profesionale.

"Që në vitin 2013, falë angazhimit tim në Nismë, më është ofruar një angazhim shështë nga Rrjeti Ballkanik i Kërkimeve (BIRN), në projektin e Drejtësisë Tranzicionale Ballkanike, në të cilin kam punuar si gazetar dhe bashkëpunëtor deri në vitin 2014.

Nga Nisma iku në fillim të verës së vitit 2016 kur u shpërngul jashtë vendit me synimin përtu regjistruar në studimet postdoktorale dhe falë përvjës së mëparshme të punës në Nismë, mori një ofertë biznesi në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që në vitin 2017.

Gjithçka që mësova dhe ndërtova gjatë punës sime në Nismë është pjesë përbërëse e aktiviteteve të mia profesionale edhe sot".

# NISMA ËSHTË SHPRESA SE SHOQËRITË TONA MUND DHE DUHET TË BËJNË MË MIRË



Edin Kolenoviq

koordinator i programit, Nisma e të Rinjeve për të Drejtat e Njeriut Mali i Zi 2012-2017, sot drejtor i zyrës së RYCO-s në Podgoricë.

**Edini gjithmonë ka dashur të punojë në sektorin civil. Që gjatë studimeve në Fakultetin e Shkencave Politike në Podgoricë, ai u përfshi në organizata të ndryshme studentore. Në të njëjtën kohë kur ai po mbaronte studimet, në Mal të Zi u themelua Aleanca Qytetare me ndihmën e madhe të Nismës së të Rinjeve për të Drejtat e Njeriut, dhe ato dy organizata filluan të tërheqin vëmendjen e tij, kujton Edini.**

"Megjithatë, kontakti i parë ndodhi krejt rastësish në një trajnim dhe kështu filloj karriera ime profesionale. Duke ditur se me se merren organizatat dhe cili është mandati dhe misioni i tyre, angazhimi im filloj si vullnetar, dhe shumë shpejt u shndërrua në një angazhim profesional që do të ketë një ndikim vendimtar në zhvillimin tim profesional dhe personal".

Në periudhën 2012-2017, Edini ka qenë aktiv në të dyja organizatat: në Aleancën Qytetare si koordinator për qeverisjen e mirë dhe në Nismën e të Rinjeve si koordinator programi.

Nga të gjitha projektet që ka udhëhequr dhe ka marrë pjesë, ai veçon nismën për themelin e Zyrës Rajonale për bashkëpunimin e të rinjve – RYCO. Nisma është një nga avokuesit kryesorë të kësaj ideje si dikush që "beson gjithmonë dhe i realizon ndryshimet në të cilat beson".

"Praktikisht në ato vite, dhe do të rezultojë pothuajse vizionar, rrjeti rajonal i YIHR-së filloj një projekt të madh të avokimit dhe tërheqjes së të gjithë aktorëve të rëndësishëm, sepse e dinte se sa i rëndësishëm është një mekanizëm i tillë për rajonin. Më duhet të them se në atë kohë shumë nuk e dinin se përfshin, dhe ata që e dinin, më shpesh nuk e besonin se një gjë e tillë ishte e mundur".

Si anëtar i Nismës së të rinjeve për të drejtat e njeriut në Mal të Zi, Edini ishte pjesë e një vizite studimore në Berlin gjatë së cilës u diskutuan hapat e ardhshëm drejt krijimit të një zyre rajonale. Në gusht të vitit 2014, procesi i Berlinit fillon zyrtarisht, ideja e krijimit të RYCO-s bëhet pjesë e procesit dhe më në fund qeveritë në rajon marrin iniciativën dhe ofrojnë mbështetje. Gjatë viteve 2014 dhe 2015, Edini ishte anëtar i grupit të punës për themelin e RYCO-s, i cili kishte përditësuar përgatitjen e dokumenteve themeluese.

Procesi i themelimit u përfundua zyrtarisht me nënshkrimin e Marrëveshjes për Themelinin e RYCO-s në Pallatin Elysee gjatë Samitit për Ballkanin Perëndimor në Paris në vitin 2015.

Për Edinin, puna për themelin e RYCO-s, ku punon sot, është një nga momentet kyçë në karrierën e tij profesionale.

"Projekti i avokimit për ngritjen e një strukturë rajonale që do të punojë për të lidhur të rinjtë dhe për të mbështetur programet e lëvizshmërisë në rajon është diçka që më ka lënë përshtypjen më të madhe personalisht. Përvaja e këtij procesi, puna e vazhdueshme me kolegët dhe së fundi kënaqësia përmes krijimit të suksesshëm të një strukturë të tillë mbart një bukur të veçantë".

I pyetur se çfarë përfaqëson Nisma për të në nivelin personal dhe çfarë në nivelin profesional, Edini thotë:

"Në nivelin personal, YIHR-a përfaqëson një familje dhe një sistem vlerash. Një grup njerëzish me të cilët dini se ndani të njëjtin vizion për të ardhmen e këtij rajoni. Kudo që takoheni dhe sa herë që takoheni, ndjenja e veçantësë dhe përkatesisë është një vlerë e pabesueshme që YIHR mbart me vete.

Në aspektin profesional, YIHR-a ishte hapi më i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm profesional. Një mundësi përmirësim profesional, përmes punës në programe në të cilat besoni vërtet. Mësimi, njohja e të tjera e njerevëzës së ndryshëm, si dhe e gjithë rajonit. Një mundësi për të marrë pjesë në programe të shumta dhe në të njëjtën kohë një mundësi për të arritur ndryshime konkrete për komunitetet dhe shoqërinë në terren dhe në shembuj konkrete".

RASIM IBRAHIMAGIQ

# NISMA MË BËRI NJERI TË TILLË SIC JAM SOT



Rasim Ibrahimagiq

vullnetar, bashkëpunëtor projekti, koordinator i projektit dhe programit, drejtor programi, 2014-2018, YIHR-a Bosnie dhe Hercegovinë, tanë studiues në zyrën e Fondacionit Fridrik Ebert në Bosnie dhe Hercegovinë.

**Rasimi e ka hasur rastësisht Nismën. Në vitin 2011, në tabelën e shpalljeve të Fakultetit Juridik në Tuzlla u postua një ftesë për të marrë pjesë në një punëtori kundër diskriminimit. Në atë kohë në universitet nuk kishte shumë aktivitete të ngjashme, kështu që Rasimi dhe disa kolegë të tij aplikuan.**

"Ishte interesante, mësuam diçka të re dhe mendova se ishte ajo. Megjithatë, unë përfundova në një listë postare të YIHR-së, dhe mund të thuhet, të asaj "one thing led to another".

Në fillim, Nisma për Rasimin ishte vetëm një mundësi për t'u përmirësuar në fusha të caktuara të drejtësisë që nuk ishin pjesë e arsimit formal. Megjithatë, shpejt ai filloj t'i vëzhgonte ngjarjet shoqërore dhe politike nga një prizëm tjeter dhe "çdo gjë mori një dimension të ri". Në atë kohë ai ishte pjesë e Partisë Socialdemokrate në Bosnie dhe Hercegovinë.

"Fatkeqësisht, qeveria nuk ishte ajo që kisha shpresuar dhe Nisma u dha të rinjve nga e gjithë Bosnia dhe Hercegovina mundësinë për të diskutuar problemet, shkëmbyer ide dhe për të ndërmarrë veprime konkrete.

Është shumë e vështirë për Rasimin që të veçojë projektet e tij të preferuara që i ka udhëhequr apo ka marrë pjesë në kuadër të Nismës në Bosnjë. Megjithatë, disi bie në sy udhëtimi në "Ditët e Sarajevës" në Beograd në vitin 2012. Aty kuptoi se "Nisma është shumë më tepër se sa punëtori me temën e diskriminimit dhe njohjen e kolegëve të ardhshëm jurist nga qytete të tjera".

Kishte ardhur shpesh në Beograd edhe më parë, ndaj nuk kishte pritshmëri të mëdha. Mirëpo, kur mbërriti atëherë në Beograd, e kuptoi se çfarë po ndodhë në të vërtetë.

"Një grup i të rinjve nga Serbia organizon një festival ku flitet për luftën në BeH!?"

Pikërisht atëherë ai mësoi për herë të parë se Bashkisë së Sarajevës iu vu zjarri gjatë luftës, sepse Nisma organizoi një eksposítë për të në Kalemeđan. Ai gjithashtu kujton se ishte "turpëruar" sepse i hodhi poshtë temat e luftës dhe ballafaqimit me të kaluarën, duke konsideruar se nuk kishte të drejtë të fliste për të.

"Nga kjo distancë kohore, në fakt e kuptoj se si dikush që kam qenë në Gjermani gjatë luftës, më është hedhur një lloj stigje, e cila më ka dekuruar të merrem me atë temë.

Pas atyre Ditëve të Sarajevës, ballafaqimi me të kaluarën u bë tema ime kryesore".

Sidoqoftë, ai e konsideron "Shkollën e Kujtimeve të ndryshme" si "foshnjën" e tij dhe projektin më domethënës në YIHR.

Nedim Jahiq atëherë "ndoshta i dha vetes detyrën e hartimit të një metodologjje dhe programi" dhe e ftoi Rasimin që t'i bashkohej dhe Alma Mashiq ua la dorën e lirë. Idea ishte që të silleshin të rinxjtë që nuk kujtojnë luftën në komunitetet ku ndodhën krimet gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe luftërave të viteve të nëntëdhjeta.

"Ishte një përvjetorë krejtësisht e re për ne dhe ishte veçanërisht e rendësishme për ne që të thyenim akullin në disa komunitete, ku njerëzit fillimisht nuk e kuptonin se kush jemi, pse jemi të interesuar për vuajtjet e tyre dhe çfarë duam prej tyre.

Ai veçon si "gjë të buruk" protestat me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut në vitin 2013. Atë mëngjes, ai mblodhi skuadren në Zhivinice, u dha bilbila dhe shenja dhe u sugjeroi që të interpretoton se si Rasimi erdhi vetëm. Plani ishte që të tjerët t'i bashkoheshin "spontanisht", sepse protesta nuk ishte paralajmëruar më parë. Menjëherë pas kësaj, në të gjitha portalet dhe rrjetet sociale filloj t'i qarkullojë një foto e Rasimit i ulur i vetëm para Komunës dhe duke protestuar.

"Dhe për ta bërë edhe më simpatike, rastësishët erdhi edhe mamaja ime që më pyeti pse jam ulur në betonin e ftohtë, do më ftohen veshkat".

Edhe pse kadia vite nuk punon në YIHR, ai është i rrethuar nga Nisma në mënyra të ndryshme. Aty u takua me miqtë e tij më të mirë dhe me kumbarin e tij në dasmë, Nedim Jahiqin, i cili e "futi" në Nismë.

"Dhe puna ime e parë e vërtetë ishte për Nismën, e kuptova se kur Nina Sheremet më mësoi se ndonjëherë duhet të bëj kafe për kolegët e mi".

Në Nismë, ai mësoi gjithçka që mundi dhe gjithçka që dinte ua transmetoi njerëzve të tjerë. Siç thotë ai, YIHR-ja definitivisht përcaktroi rrugën e tij profesionale. Aktualisht punon në Fondacionin Friedrich Ebert dhe aty mundohet të gjejë hapësirë për t'u marrë me tema të ngjashme. Kështu, në bashkëpunim me YIHR-ën, ata rivendosën ardhjen e të rinjve nga Beogradit në përkujtimin e masakrës në Portën e Tuzllës.

"Këto janë tema dhe gjëra nga të cilat sigurisht nuk do të mund të heq dorë kurrë dhe të cilave do t'u jem gjithmonë i përkushtuar".

## **ATY KU FILLON HESHTJA, NE FILLOJMË BISEDIMIN: KRIMI NË KAZANI**

Kazani është emri i një grope që ndodhet në zonën e qytetit të vjetër në Sarajevë. Nga mesi i vitit 1992 deri në gjysmën e dytë të vitit 1993, në Kazani u kryen vrasje të civilëve kryesisht serbë, trupat e të cilëve më pas u hodhën në atë gropë. Këto krimet luftë janë kryer nga Mushan Topalloviq Caco dhe anëtarët e Brigadës së 10-të Malore të Ushtrisë së RBeH-së. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë është një nga organizatat e para që foli publikisht për këtë krim dhe organizoi vizita në këtë vend të vuajtjes duke treguar përgjegjësinë.

Pas luftës, eshtrat e 23 viktimateve, nga të cilat 15 janë identifikuar, u zhvarrosën nga gropa gjatë një sërë gërmimesh. Kanë kaluar 25 vite nga krimi në Kazani, ndërsa viktimat ende nuk janë nderuar në mënyrë dinjitoze dhe shumë qytetarë/të kryeqytetit të vendit tonë nuk janë njojur me krimin në Kazani. Kjo ishte edhe arsyaja pse, së bashku me aktivistë/të YIHR-së së BeH filloj mbledhja e nënshkrimeve për një peticion që i bënte thirrje Këshillit Bashkiak të Sarajevës të ngrinte një monument për të nderuar viktimat e krimeve të luftës në Kazani.



IVAN GJURIQ

# NISMA ËSHTË NJË KUJTESË E ASAJ QË DUHET TË BËJMË NËSE DUAM TË JEMI NJË SHOQËRI MODERNE DEMOKRATIKE EVROPIANE



Ivan Gjuriq

koordinator programi nga viti 2013 deri  
në vitin 2017, kur merr postin e drejtitorit të  
programit deri në vitin 2022.

**Ivan filloi zyrtarisht të punojë në Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi në vitin 2013. Para kësaj ka qenë pjesëmarrës në disa nga programet e Nismës, vullnetar dhe aktivist. Prandaj, punësimi i plotë në organizatë ishte rendi më normal i gjërave.**

"Kjo ishte e vetmja gjë logjike në atë kohë dhe kjo ishte gjithçka që doja në jetë."

Në momentin kur Ivani u bë pjesë e organizatës, Serbia ishte shumë më e hapur ndaj çështjeve me të cilat merret Nisma, të cilat sot janë shtyrë në prapavijë. Në vitin 2013, idetë rreth të cilave ata u mblohdën në Nismë u bënë erë në shpinë, thotë Ivani. Momenti i tyre dukej se kishte ardhur.

"Në atë kohë u nënshkrua Marrëveshja e Brukselit, u hapën negociatat me Bashkimin Evropian, KOMRA lëvizni nga pikë fillestare. Në Beograd ka pasur një ekspozitë për Bogujevcët me Saranda Bogujevcin dhe kryeministrin Ivica Daçiç. Dukej sikur të gjitha temat dhe vlerat tona kishin gjetur rrugën dhe se kjo është rruga nëpër të cilën Serbia do të vazhdojë rrugëtimin".

Megjithatë, një dekadë më vonë, "nuk ka mbetur asnjë gjurmë: as integrimi evropian, as, mos e dhëntë Zoti, pajtimi – kjo nuk është në radarin e askujt, bile edhe marrëveshja e Brukselit është çmontuar."

Gjatë gati dhjetë viteve që Ivani kaloi në Nismë, pati shumë projekte dhe nisma me të cilat ai është shumë krenar edhe sot. Në vitin 2013 iu dha detyra për të ringjallur dhe zgjeruar grupin e aktivistëve të Nismës, kështu që në vitet në vijim erdhën shumë njerëz përmes programeve dhe projekteve të ndryshme; disa prej tyre sot drejtож organizațien, disa kanë marrë poste të rëndësishme në shoqëri pas Nismës.

"Formimi i gjeneratës së pestë të aktivistëve në të cilin u përfshiva dhe drejtova është diçka për të cilën jam shumë krenar".

"Jam shumë krenare edhe për faktin që përfaqësova Nismën në nivel rajonal kur morëm çmimin Vaclav Havel në Këshillin e Evropës. Shpesh kam pasur rastin të përfaqësosoj Nismën si drejtësi programi dhe ndjenja e përfaqësimit të të gjithë njerëzve që janë këtu tanë, që ishin këtu dhe që do të vijnë nesër, është shumë e bukur."

Një tjetër projekt i rëndësishëm në të cilin mori pjesë si pjesë e Nismës ishte themelimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, RYCO.

Ashtu si shumë që kaluan nëpër Nismën e të Rinjve, ose janë ende në të, ishte gjithmonë shumë e vështirë për Ivanin të bënte dallimin midis personales dhe profesionales. Kur u pyet pse është kështu, Ivani thotë:

"Është kështu sepse ne të gjithë kemi dhënë komplet veten në të dhe kjo është vlera e Nismës. Dhe pastaj, këtu fiton diçka, humbet diçka, por ne të gjithë kemi dhënë të gjithë veten tonë. Ky është dallimi midis Nismës dhe punëve të tjera që kemi pasur ose do të kemi. Me këtë, për shumicën e njerëzve Nisma ishte puna e tyre e parë, jo për mua konkretisht, por për shumicën e njerëzve ishte".

Gjatë dekadës së tij në Nismë, Ivani bëri shumë miq dhe pati mundësinë të bënte atë që dëshironë gjithmonë: të udhëtonte dhe të takonte njerëz nga i gjithë rajoni.

"Në nivel profesional, më dha mundësinë të mblidhesha me njerëz me të cilët ndaja të njëjtat vlera, na dha hapësirë të flasim publikisht dhe që dikush ta dëgjojë këtë. Kjo është gjithçka për mua, gjithçka që kam dashur dhe kam nevojë. Kjo është highlight. Të jemi përfaqësues të ndonjë shkolle mendimi, i ndonjë sistemi vlerash, sido që ta quash".

VENERA ÇOÇAJ

# YIHR-A ËSHTË OPOZITË NDAJ POLITIKËS KRYESORE RAJONALE



**Venera Çoçaj sa kishte mbushur 18 vjeç në vitin 2012 dhe mbaronte shkollën e mesme në vendin e lindjes në Porec të Kroacisë, ku dekada më herët kishin emigruar prindërit e saj, në një sistem arsimor të ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit, që për të nuk ofronte aq shumë njojuri për kapitullin e shpërbërjes së përgjakshme të ish-Jugosllavisë.**

Ajo donte të dinte më shumë e të gërmonte më thellë dhe një moment i tillë për të erdhi kur YIHR-a ofroi programin e shkëmbimit të të rinjve në ballafaqim me të kaluarën. Për të, aty ishte pragu i parë i një mundësie që ajo donte ta shfrytëzonte për të mësuar më shumë. "Ishte një platformë e aktivizmit riror dhe më pas më motivoi t'i bashkohem rrjetit të YIHR-së, për të rritur ndërgjegjësimin për ndryshime sociale", thotë Çoçaj.

Kjo bëri që ajo të transferohej në Prishtinë për të vazhduar studimet dhe të punonte me zyrën e YIHR-së.

Ajo kujton se në vend dhe në rajon, në tërësi, ishte një klimë e krizave të ricikluara politike dhe etnike që kërcënoin paqen dhe sigurinë, shumë nga të cilat, thotë ajo, vazhdojnë të jenë të pandryshueshme. Më brengosëse ishte çështja e personave të zhdukur gjatë luftës apo liria e lëvizjes.

"Duket se kemi ngecur në "status quo", thotë ajo, duke kujtar se organizatat si YIHR-a ofrojnë një hapësirë alternative ndaj këtyre realiteteve të vështira të së kaluarës.

"Brezi im është një brez tipik i paslufës, vazhdimisht i prekuipuar me etnonacionalizmin e përditshëm" shton ajo.

Ndonëse kanë kaluar shumë vite nga lufta, ajo tregon se kujtimet i ka tejet të freskëta. "Meqenëse diskutimet dhe të mësuarit për të kaluarën e afërt nuk ndodhën në orët e historisë, jashtë shkollës mësuam një version të saj".

Më shumë se një dekadë pasi është larguar nga YIHR-a, Çoçaj përmend dy gjëra që e bëjnë YIHR-ën të dallohet nga të tjerat: faktin e të qenit një organizatë e udhëhequr nga të rinjtë që u jep mundësi të rinjve të mësojnë mbi ballafaqimin me të kaluarën, LGBT dhe të drejtat e njeriut dhe karakterin rajonal të rrjetit.

"YIHR vazhdoi të shfaqë potencialin e të rinjve si faktorë kyç në ndërtimin e paqes dhe pajtimit dhe shkoi përtej, duke përfshirë dimensionin rajonal. Në atë kohë, kjo ishte unike, ishte vizioni dhe misioni i organizatës".

Çoçaj përmend disa nga iniciativat ku ajo kishte rol organizues si shënimin e Ditës Ndërkombëtare për

Personat e Zhdukur, Projektin rajonal Youth Memories, që përfshinte vendosjen e pllakave memorialuese në vendë që bartin histori të vështira të së kaluarës. Ndër to ishin si "Staro Sajmiste" në Beograd, një kamp përqendrimi në Luftën e Dytë Botërore apo shtëpia e shndërruar në shkolë e familjes Hertica në Prishtinë, ku bëhej mësimin paralel, që u bë simbol i rezistencës paqësore në Kosovë, si dhe bashkëorganizimin e parë të marshit "Marshojmë, s'festojmë" në vitin 2016, duke krijuar një platformë që e shndërroi shënimin e 8 Marsit në Prishtinë në protestë feministe.

Gjithashtu ajo thotë se gjatë kësaj kohe i kishte për zemër organizimet që bënte në debate dhe programe edukative rinore, si dhe netët javore të shfaqjes së filmave me tema mbi të drejtat e njeriut, drejtësinë sociale, dhunën seksuale dhe aktivizimin ndaj grupeve LGBT.

Në dimensionin e një historie personale, Çoçaj, tani një kandidate për doktoratë në Univeristin London School of Economics and Politics në Londër tregon se për të YIHR-në ishte domethënëse, ngase ofronte një platformë për të vepruar e menduar. "Është opozitë ndaj politikës kryesore rajonale, e cila nuk është e prirur të investojë në paqen e qëndrueshme". Ajo thotë se organizatat si YIHR-a ofrojnë një hapësirë alternative ndaj realiteteve të ashpra dhe nxisin të menduarit kritik, që është i gdhendur në parimet e të drejtave të njeriut.


Sidoqoftë ajo thotë se ende mezi gjen ndonjë ndryshim thelbësor në raportet mes vendeve të ish-federatës jugosllave. "Kontributi kryesor i YIHR-së është vazhdimi i diskutimit mbi paqen dhe pajtimin në gjithë Ballkanin Perëndimor".

Gati dy dekada, YIHR-a ka bërë bashkë të rinjë që mblidhen dhe shprehen publikisht për çështje të ndryshme, duke kontribuuar "në krijimin e hapësirave që bashkojnë qytetarët për të menduar dhe vepruar në mënyrë kritike".

Çoçaj e përshkruan YIHR-në si strehë të një grupi të rinjsh që po përpilen të kuptojnë të kaluarën e tyre traumatike sociale në mënyrë që të kenë një të ardhme më paqësore dhe më të begatë.

**NIKOLA PUHARIQ**

# **NISMA ËSHTË NJË PËRQAFIM I MADH RINOR RAJONAL NË NJË LUFTË TË PËRKUSHTUAR DHE SISTEMATIKE KUNDËR NACIONALIZMIT TË TË GJITHA LLOJEVE**



**Nikola Puhariq**

Deri në vitin 2019, Nikolla ishte drejtor programi i Nismës në Kroaci, ndërsa tani është në Bordin e Drejtoreve të saj. Nga viti 2019 e deri më sot ka punuar si studiues në sektorin joqeveritar, ka zhvilluar dhe zbatuar projekte të ndryshme të BE-së, ndërsa vitin e fundit është në departamentin e kulturës në Këshillin Kombëtar Serb në Zagreb. Siç thotë edhe vetë, "fatkeqësisht apo përfat" ende merret me tema si në fillim të karrierës së tij profesionale, në Nismë – ballafaqimin me të kaluarën, memorializimin, realizimin e të drejtave për viktimat etj. Për këtë arsyre ai thotë se puna në YIHR përcaktoi plotësisht rrugën e tij të jetës.

**Nikola Puhariq ishte më pak se 24 vjeç kur iu bashkua Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci. Ai ishte i motivuar në radhë të parë nga dëshira për të qenë pjesë e sektorit joqeveritar dhe në këtë mënyrë për të ndryshuar shoqërinë për të mirë. Ai ishte marrë edhe më parë me ballafaqimin me të kaluarën, ndaj këto tema nuk ishin të panjohura për të. Gjatë viteve të kaluara në Nismë, ai ka qenë asistent programi dhe është marrë me zbatimin e dokumenteve ndërkombëtare në legjislacionin vendas dhe praktikat politike me qëllim të mbrojtjes së pakicave vulnerabël. Pak më vonë filloi të merrej më intensivisht me ballafaqimin me të kaluarën.**

I pyetur se si ishte situata socio-politike në Kroaci në vitin 2014, kur ai iu bashkua Nismës, Nikolla thotë:

"Më duhet të pranoj se klima politike në Kroaci në atë kohë ishte mjaft e trazuar dhe skizofrenike, duke pasur parasysh se vendi sapo ishte bërë pjesë e Bashkimit Evropian, gjë që solli njëfarë optimizmi. Në të njëjtën kohë, po forcohen lëvizjet dhe organizatat, qëllimi i të cilave ishte heqja ose kufizimi i të drejtave të personave LGBTIQ, pakicave dhe grave, gjë që tregoi një pasqyrë të realitetit në të cilin anëtarësimi në BE nuk i zgjidh problemet e të drejtave të njeriut.

Sfidat janë në ritje edhe për sa i përket bashkëpunimit rajonal, sepse Kroacia po largohet në mënyrë deklarative nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Sido ta shikoni, momenti për t'iu bashkuar Nismës ishte interesant".

Gjatë gjysmë dekadës së kaluar në Nismë, Nikolla mori pjesë në shumë programe, fushata dhe nisma. Ai thotë se kujtimet më të mira i ka nga shkëmbimet rinore si dhe nga udhëtimet studimore në vendet e ish-Jugosllavisë – sepse ato ishin momentet e daljes nga zona e komfortit të hapësirave tona të zakonshme mendore dhe fizike. Më pas, të rinjtë patën mundësinë të bisedojnë me njerëz që kaluan periudhën e shtetit të përbashkët, periudhën e luftërave dhe më pas periudhën e demokratizimit. Kjo është ajo që e bëri të njohur Nismën edhe sot e kësaj dite:

"Të rinj nga vende të ndryshme patën rastin të bisedojnë për tema të përditshme, por shumë të vështira dhe sfiduese. Nisma është vërtetë një pioniere në organizimin e takimeve të të rinjve dhe ideve të tyre me theks në procesin gjithëpërfshirës të ballafaqimit me të kaluarën dhe deri më sot ka një qasje unike".

Deri në vitin 2019, Nikolla ishte drejtor programi i Nismës në Kroaci, ndërsa tani është në Bordin e Drejtoreve të saj. Nga viti 2019 e deri më sot ka punuar si studiues në sektorin joqeveritar, ka zhvilluar dhe zbatuar projekte të ndryshme të BE-së, ndërsa vitin e fundit është në departamentin e kulturës në Këshillin Kombëtar Serb në Zagreb. Siç thotë edhe vetë, "fatkeqësisht apo përfat" ende merret me tema si në fillim të karrierës së tij profesionale, në Nismë – ballafaqimin me të kaluarën, memorializimin, realizimin e të drejtave për viktimat etj. Për këtë arsyre ai thotë se puna në YIHR përcaktoi plotësisht rrugën e tij të jetës.

"Do ta kujtoj periudhën e punës në këtë organizatë si atë në të cilën pata mundësinë të punoj me njerëz shumë të rinj, por më të guximshëm nga i gjithë rajoni, ndaj më pëlqen të besoj se kam marrë të paktën një pjesë të vogël të atyre cilësive dhe i kam marr me vete në luftën me sfidat e reja."

Në YIHR kam bërë miq dhe shokë nga Kroacia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi të cilët u bënë dhe mbeten pjesë e rendësishme e jetës sime, dhe pasi mbaroi pjesëmarrja ime aktive në punën e organizatës, jam krenar që isha në gjendje të ndajë me ta angazhimin profesional dhe aktivist".

**BRANKA VIERDA**

# NISMA NA JEP NDJESINË SE JEMI NË ANËN E DUHUR TË HISTORISË



**Branka Vierda**

pravnica i programska direktorka YIHR Hrvatska od 2022. godine.

**Branka Vierda filloj të merret me aktivizmin dhe të drejtat e njeriut në shkollën e mesme. Në Dokumenti – një qendër për ballafaqimin me të kaluarën – ajo ka punuar si vullnetare kryesisht në programet që kanë të bëjnë me monitorimin dhe gjykimet për krimet e luftës. Më pas, në vitin 2017, ajo iu bashkua Nismës së të rinje për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, si koordinatore e programit të drejtësisë dhe më pas të programit të pajtimit. Sot ajo është drejtore programi dhe drejton një ekip prej katër personash, ndaj nuk ka “ndarje të repte të punës”. Në Nismë, ajo i është përkushtuar më së shumti punës kërkimore, punës me të rinjtë, krijimit të një kulture gjithëpërfshirëse të kujtesës dhe konsiderimit se si politikat e kujtesës ndikojnë në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërshtetërore në të tashmen dhe të ardhmen.**

“Në kohën kur studioja kam qenë aktive përmes partisë politike dhe aktivizmit rino, më vonë jam përfshirë përmes shoqërisë civile. E dija që si juriste nuk do të bëja një punë burokratike që nuk ka perspektivë vizionare dhe sociale. Puna në Nismë më mundësoi të kontribuoj seriozisht dhe me përkushtim në programet tona të edukimit joformal të të rinjve përmes përmirësimit të vazhdueshëm, pikërisht sepse në fushën me të cilën merret Nisma, në arsimin formal, është tërësisht e anashkaluar”.

Programi “Narrativat e përbashkëta” i nisur nga themeluesi i Nismës në Kroaci, Mario Mazhiq, i cili rezultoi në një libër me të njëtin titull të shkruar nga mbi 180 të rinj nga rajoni, shënoi punën e saj dhe ia bëri identitetin rajonal shumë të afërt.

“Është e rëndësishme të shkosh në vendet e vuajtjes në vitet 1990 dhe të krijosh mundësi që të rinjtë të bisedojnë me familjet e viktimate, me banorët, gazetarët, aktivistët, të vizitosh nëse ka ndonjë formë të ruajtjes dhe kujtimit – muzeumet dhe ekspositat, të mendosh për marrëdhënien e asaj që na thotë spektri kryesor politik, ajo që shkruhet dhe lexohet. Është e rëndësishme të punohet me të rinjtë duke thyer këto mite kombëtare”.

Pjesëmarrësit e programeve të Nismës vazhdojnë të merren me këto tema edhe pas kësaj, qoftë përmes punës akademike në fakultete, aktivizmit në komunitetet lokale, apo përmes angazhimit në organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut.

“Mendoj se këta janë të rinj që e kanë kuptuar rëndësinë e përgjegjësisë së tyre për krijimin e ndryshimeve pozitive sociale. Të punosh me të rinjtë është e rëndësishme dhe jashtëzakonisht e përgjegjshme, aq më tepër sepse ndonjëherë bëhet fjalë për kalimin e vetëm një javë me ta. Reagimet dhe ndërveprimet e tyre që ne dëshmojmë dhe shohim janë, besoj, pafundësish të vlefshme dhe një frymëzim për të ecur më tej.

“Eshtë një privilegji i madh të shohësh rezultatet konkrete të njojurive të tyre të reja, hapjen e temave tmerrësish të vështira dhe që thyejnë perceptimin e tyre për vlerat e gdhendura në identitetin kombëtar. Guximi i tyre për t'u angazhuar më tej dhe për ta çuar me guxim këtë njojuri përpëra është një potencial i madh i shoqërive tona.”

Branka thotë se Nisma pati një ndikim të madh në jetën e saj private, ndaj njerëzit më të afërt në jetën e saj janë ata që ka takuar në këtë organizatë. Nga ana profesionale – sërisht njerëzit, të cilët, thotë, janë “frymëzimi i vazhdueshëm për t'u marrë me këtë punë”.

Branka flet edhe për sulmet dhe presionet me të cilat përballet Nisma e të Rinjve pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, por më së shumti në Serbi. Ndonëse aktivistët dhe aktivistet nuk e kanë të lehtë kur kërcënohen apo kur qeveritë i etiketojnë si tradhtarë, thotë se të gjithë këto janë shumë pak në krahasim me atë që kanë kaluar dhe kanë mbijetuar njerëzit të cilëve Nisma u jep zë.

“Personalisht mendoj se është pjesë përbërëse e punës në të cilën rivlerëson atë që sot shihet si themeli i vendeve tona. Është një proces afatgjatë dhe ndryshimet që advokojmë vijnë shumë ngadalë. Është e rëndësishme që të mbetemi të motivuar në vazhdimësi dhe ta bëjmë këtë punë, vokacionin e punës për brezat e rindërtimit “tërheqëse”, si dhe të ndërgjegjësojmë nevojën e një kontributi të tillë. Thjesht, normalizon dhe përvetëson se je në trazira për një kohë të tërë. Ndryshimi potentialisht nuk do të jetë i dukshëm në jetën tonë, gjë që është mjaft e vështirë, ndoshta edhe më e vështirë se kërcënimet”.

Branka thotë se të punosh në Nismë është diçka e dukshme në planin afatgjatë dhe se “të mbrosh veten do të thotë të kontribuosh në atë proces”. Beson se ajo që e bën Nismën specifike është identiteti i saj rajonal dhe se ajo është një formë e komunitetit.

“Nuk është familja, nuk janë vetëm miqtë dhe kolegët, është një formë bashkëpunimi, ndjeshmërie dhe pune sociale. Dhe në cilëndo zyrë të Nismës të vish, do kesh ndjenjën e përkushtimit të jashtëzakonshëm”.

Branka është personi i parë nga Kroacia që fiton çmimin “Ordinary Hero” për vitin 2022, i cili ndahet nga Qendra për Kërkime pas Konfliktit me qendër në Sarajevë. Çmimi jepet për guximin e njerëzve që punojnë aktivisht për promovimin e vlerave të drejtësisë, paqes dhe pajtimit.

## FUSHATA #FALJE DHE MEMORIALIZIMI

Në vitin 2016, YIHR-a e Kroacisë filloi fushatën #FALJE, duke i bërë thirrje Qeverisë së Republikës së Kroacisë që t'u kérkojë falje të gjitha viktimate dhe familjeve të viktimate të krimave të luftës dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut që ndodhën gjatë dhe menjëherë pas operacionit ushtarako-politicor „Stuhia“ në gusht të vitit 1995.

Fushata zgjati disa vite dhe përfshinte një peticion, shpërndarje publike të përbajtjes përmes medias sociale duke përdorur hashtag #FALJE bilborda, manualin për politikanët „Si t'u kérkojmë falje për krimet“ dhe paraqitje publike. YIHR-a u dorëzoi peticion dhe nënshkrimë përfaqësuesve të shoqatave të viktimate të shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë dhe pas Operacionit „Stuhia“, të cilët ende presin drejtësinë për krimet.

Pas dhjetë vitesh avokimi me autoritetet lokale për të emërtuar një hapësirë publike me emrin Aleksandra Zec – një vajzë dympëdhjetë vjeçare, pjesëtare e pakicës kombëtare serbe, e cila u vra në vitin 1991 në Zagreb, në janar të vitit 2022, Fondi i emrave për caktimin e emrave të Komisionit të Kuvendit të qytetit miratoi emrin Aleksandra Zec. Meqenëse ai emër aktualisht është i shënuar në Fond, ne vazhdimisht avokohemi që të ngrihet një memorial ose të emërhohet një vend publik me emrin Aleksandra Zec.



**ANTE PEREZA**

# NISMA ËSHTË NJË GRUP I VOGËL INDIVIDËSH QË KRIJOJNË NJË MJEDIS MË TË MIRË PËR TË GJITHË NE



**Ante Pereza**

Bordi Drejtues i YIHR-së Kroaci që nga viti 2019. Punon si konservator-restaurues arti.

**Pas pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Ante Pereza kuptoi se ndajnë të njëjtat vlera dhe synime dhe në vitin 2018 u bë anëtar. Pesë vite dhe shumë projekte e aksione më vonë, Ante thotë se disa ndryshime në shoqëri janë të dukshme, por se është shumë e vështirë të flitet objektivisht për këtë.**

"Besoj se shoqëria po bëhet më e hapur ndaj temave "të ndjeshme" të luftës dhe më e gatshme për të pranuar kritikat, por e gjithë kjo po ndodh me një hap shumë të ngadaltë."

Për Anten, Nisma përfaqëson një rreth njerëzish të ngushtë që luftojnë për një shoqëri më të hapur dhe më të drejtë. Konsideron se qasja individuale ndaj individëve është një avantazh i madh, sepse janë këta individë që do të vazhdojnë të punojnë në zhvillimin e shoqërisë në komunitetet e tyre. Njerëzit të cilët i takoi dhe me të cilët punoi, dhe projektet në të cilat mori pjesë, janë një gjurmë të madhe personale dhe profesionale tek ai:

"Njohja dhe bashkëpunimi me një numër të madh njerëzish nga vende të ndryshme, të cilët nuk kanë domosdoshmërisht të njëjtat qëndrime dhe pikëpamje, projekte në të gjithë razonin dhe një qasje kërkimore dhe e paanshme ndaj ngjarjeve të luftës, ndikuan që të kuptoj më mirë shkaqet, rrjedhën dhe pasojat e konflikteve të viteve të nëntëdhjeta në këto hapësira, por edhe të zhvilloj një nivel autokritik në dashurinë për vendin tim".

Nga të gjitha nismat e Nismës në të cilat ka marrë pjesë, Ante veçon botimin "Narrativat e përbashkëta", autorë të të cilat janë të rinj të kombësive, qëndrimeve dhe profesioneve të ndryshme. Ata u mblohdhën për të shkruar për të kaluarën e tyre të përbashkët dhe tema të tjera që i bashkojnë ose i ndajnë, dhe secili grup përbëhej nga pjesëmarrës nga vendet që ishin në konflikt me njëri-tjetrin.

Kështu, të rinjtë nga Serbia dhe Kroacia duhej të pajtoheshin për ngjarjet në Vukovar dhe "Olujën" (Shqip: "Stuhia"), ndërsa një grup nga Serbia dhe Bosna e Hercegovina hetuan rrethimin e Sarajevës.

"Kam moderuar grupin kroato-malazez që hetonte bombardimin e Dubrovnikut, pushtimin e zonës së Dubrovnikut, kampin Morinj dhe çështjen e kufirit në Prevllakë. Me këtë projekt kemi dëshmuar se me ndihmën e fakteve dhe duke u udhëhequr nga parimi i drejtësisë mund të gjendet një gjuhë e përbashkët edhe me temat më të ndjeshme".

Gjithashtu veçon edhe konkursin për krijimin e një zgjidhjeje artistike për përkujtimin e viktimate civile të luftës, e cila do të vendosej në vendet e pashënuara të vuajtjeve civile gjatë luftërave të viteve të nëntëdhjeta në territorin e Kroacisë.

"Duke pasur parasysh edukimin tim artistik, kam qenë pjesë e jurisë që ka vlerësuar punimet e paraqitura. Zgjidhja e përzgjedhur fituese përfaqëson një vepër arti të jashtëzakonshme me një mesazh të fortë që besojmë thellësish se do të gjejë vendin e saj në hapësirën publike".

Ante është ende pjesë e Nismës duke marrë pjesë në menaxhimin e organizatës.

"Pjesëmarrja në aktivitetet e Nismës më mundësoi zhvillimin në kuptimin personal të njohjes me pjesët e së kaluarës që i njihja pak ose aspak, ndërtimin e një opinion autokritik ndaj historisë, njohjen me shumë njerëz përmes punës dhe bashkëpunimit, përvojës së organizatës dhe shumë më tepër."

**SENAD SHABOVIQ**

# YIHR, A FEW GOOD MEN AND WOMEN



**Është një titull filmi që Senad Shaboviq e kujton kur i kërkohet ta përshkruajë Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), me pak fjalë.**

**Titulli i filmit të vitit 1992 "A few good men" e adaption në mënyrën se si organizata ka nisur dhe ka vazhduar punën në një rajon të trazuar.**

"Fatkeqësish, në klimën aktuale, YIHR-në do ta përshkruaja me titullin e filmit "A Few Good Men", kuptohet, të adaptuar si "A Few Good Men and Women", thotë Shaboviq teksa kujton momentet e para në fillim të viteve 2000.

Shaboviqi është njohur me punën e YIHR-ës që nga themelimi i saj.

Duke qenë pjesë e skenës rjonale të shoqërisë civile, ai ka punuar në shumë organizata që kanë pasur fokus të njëjtë. "Admiroja YIHR-në, udhëheqjen dhe vizionin e saj. Gjithmonë kam pasur përkushtimin e madh të mbështes organizatat me një agjendë progresive dhe isha i lumtur kur u ftova në Bordin e organizatës", thotë ai. Shaboviq gjatë kësaj periudhe ka bërë disa lëvizje në karrierë, në pozita të ndryshme në organizata ndërkombëtare dhe institute në Prishtinë, por thotë se gjatë gjithë kohës ka qënë në kontakt me YIHR-ën, duke bashkëpunuar në aktivitete të ndryshme.

Ai thotë se është vet emërtimi i organizatës që e bën atë të veçantë.

"YIHR-a vuri fokusin te të rinjtë. Në këtë aspekt, organizata ishte një lloj avangarde që punonte në këtë front shumë kohë përpara prirjes së përgjithshme ndërkombëtare të "youth mainstreaming". Njerëzit që krijuan organizatën, si Andrej Nosovi, kanë vlerësuar saktësisht që të rinjtë e këtij rajoni kanë nevojë për vëmendje, se duhet punuar me ta për t'u bërë agjentë të ndryshimeve pozitive, brezi që na përcjell nga e kaluara negative në një të ardhme të dëshiruar," thotë ai.

Kjo, në sytë e Shaboviqit, i ngjan asaj që bëri brezi i pasluftës pas Luftës së Dytë Botërore në Gjermaninë Perëndimore.

"Ajo që pamë atëherë dhe ajo që shohim për fat të keq sot është se një pjesë e madhe e të rinjve bien në grackën të vetëizolimit dhe nacionalizmit," thotë Shaboviq. Një gjë tjetër për të cilën Shaboviq ia krediton suksesin YIHR-së, është aktiviteti në rrugë në çështje të avokimit për pajtim, diçka për të cilën thotë se kjo organizatë ka qenë pioniere në rajon.

"YIHR-a punoi me të rinjtë për t'i orientuar ata drejt gjëra të mira, drejt daljes nga "kurthi ballkanik", drejt një sistemi vërtet progresiv, një lloj evropianizmi të vërtet të rajonit. Më pëlqeu gjithashtu që YIHR-a ishte e zëshme përmes aksioneve të shumta në rrugë dhe formave të tjera të shfaqjeve publike," shton ai.

"Kjo ishte freskuese, duke marrë parasysh numrin e madh të organizatave të tjera, posaçërisht ato ndërkombëtare, të cilët favorizonin "avokimin" dhe "fushatat publike" përmes seminareve nëpër hotele të bukura ose billboardave të siguruara përmes kompanive të marrëdhënieve me publikun, që shpesh njëkohësisht punonin me yjet e skenës së muzikës që po përhapnin mesazhin e kundërt," thotë ai.

Situata ka mundur të ndryshojë gjatë viteve por Shaboviq thotë se në shumë mënyra, rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk ka arritur ende aty ku do të duhej të ishte tani, më shumë se dy dekada pas përfundimit të luftërave të përgjakshme.

"Disa nga çështjet themelore janë ende të pranishme. Ballafaqimi me të kaluarën ishte gjysëm i përfunduar dhe më pas është fshehur kryesisht nën qilim, nuk janë vendosur as pajtimi po as marrëdhënie funksionale, dhe progresi i përgjithshëm socio-ekonomik është ende peng i çështjeve të pazgjithdhura dhe etno-nacionalizmit të vazhdueshëm dhe, në fakt, është në rilulëzim," nënvizon Shaboviq.

"Koha kur punoja më intensivisht me YIHR-ën ishte në fakt një kohë e mirë, në pjesën më të madhe. Duke parë nga perspektiva aktuale – ku shihet regresi i madh – periudha e reth dhjetë viteve më parë ishte premtuese. Gjërat shkonin në drejtimin e duhur. Në atë kohë, kam pasur përshtypje se njerëzit dhe qeveritë po shkëputeshin nga trashëgimia e luftërave dhe bashkëpunimi rajonal ishte në kulmin e tij", thotë Senad Shaboviq.

Sipas tij, programi i shkëmbimit ronor Kosovë – Serbi, bashkë me shumë programe të tjera, kanë pasur një efekt të rëndësishëm në fushën e ballafaqimit me të kaluarën. "Sa i përket YIHR-së, unë vazhdoj të admiroj organizatën dhe të gjithë njerëzit e përfshirë. Është e qartë se ka shumë punë përpëra dhe shpresoj që palët e interesuara dhe donatorët do të vazhdojnë ta kuptojnë këtë", përfundoi ai.

**NE  
KUJTIM**

---

JASNA BOGOJEVIQ

# GRUAJA QË NUK DORËZOHET



Jasna Bogojeviq  
(1946-2015)

anëtare e Kuvendit dhe Këshillit Mbikëqyrës,  
2004-2015, YIHR Serbi, aktiviste antifashiste  
dhe kundër luftës.

**Në vitin 1991, Mensura Lula Mikijel ishte sekretare e regjisë ndërsa punonte për filmin e Goran Markoviqit "Tito dhe unë". Rreth asaj kohe, ajo dëgjoi për fushatën kundër luftës "Ndezja e qirinjve" si një nderim për viktimat e luftës dhe një shprehje solidariteti me të gjithë ata që u rebeluan në atë kohë. Shumë shpejt ajo iu bashkua asaj dhe pa shumë të njojur të saj në tubime, por edhe shumë njerëz që nuk i njihte.**

"Vërej një grua të burkur dhe të vrenjtur që kritikon me zë të lartë se ka pak njerëz".

Lula më vonë e pa të njëjtën grua në fushatën "Crni flor" (Shiriti i zi). Ajo ende nuk e di se kush është ajo.

"Rrethi i Beogradit, seancat të shtunave." I pyes njerëzit a e njohin atë grua dhe më thonë se quhet Jasna, se punon në televizion. Njihemi dhe pas një bisede të shkurtër, kuptojmë se jemi në të njëjtën anë, në anën kundër luftës, kundër krimít".

Lula thotë se më pas u bënë "shoqe të ngushta, të pandashme të bashkëvujtura", dhe së shpejti me to u bashkua edhe Branka Paniq, mësuese e anglishtes. "Jasna ishte një grua që disi shkoi së bashku me dy shoqet e tjera të saj – Brankën dhe Lulën, dhe është e pamundur të mendosh për Jasnën pa ato të dyja, ose për ato të dyja pa Jasnën", shpjegon Milosh Uroshevi1, aktivist i Grave me të zeza.

Që të treja ndiqnin ngjarjet kundër luftës dhe natën ishin në kontakt telefonik duke ndjekur të gjitha lajmet. Lula thotë se u pëlqente të shikonin tenis – Jasna e adhuronte Federerin dhe brohoriste për të.

"Jasna Bogojeviq ishte një grua "e rëndë" dhe pesha e një gruaje "të rëndë" karakterizohet nga mospërkatësia dhe mospërshtatja", shton Milloshi.

Ai thotë se Jasna e "urrente" përkatësinë e çdo grupi, pra se ajo ishte sipër tij, "si një zog që i ndërtón foletë në vende të paarritshme".

Janë të paktë ata që nuk kanë munguar asnjë mbrëmje të "Ndezjes së qirinjve" nga 8 tetori 1991 deri më 8 shkurt 1992. Milloshi thotë se Jasna Bogojeviq ishte një prej tyre. "Edhe pse nuk ma tha kurrë këtë, jam i sigurt se ka marrë pjesë në të gjitha seancat e Rrethit të Beogradit –Serbisë së Dytë – "asaj që nuk u pajtua krimin".

Ajo ka mbledhur nënshkrime kundër luftës në Qendrën Kulturore Studentore, ka qenë pjesë e aksioneve kundër luftës "Shiriti i verdhë" dhe "Kambana e fundit". Ajo gjithashtu qëndronte në errësirë dhe heshtje, së bashku me Gratë me të Zeza, çdo të mërkurë në Sheshin e Republikës në Beograd për pesë vjet nga ora 15:30 deri në 16:30. Lula tregon se ndalesat e të mërkurave ishin të detyrueshme për ta, sikurse edhe seancat e Rrethit të Beogradit të shtunave.

Jasna ishte një nga ato gra që bërtiste: Beograd, zgjohu! Beograd, turp të kesh!", kujton Miloshi.

